



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**  
**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**RAPORT**  
**I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**  
**MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT**  
**PËR VITIN 2020**

**Prill 2021**

**I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,**

**Të nderuar zonja e zotërinj Deputetë,**

Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 148/b shkronja “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 104 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.3, datë 20.01.2020 “Për miratimin e kalendarit të paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, dërguar me shkresën tuaj nr.276, datë 22.01.2021, ju parashtroj Raportin Vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara, për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në vend, për efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe veprimtari të tjera thelbësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, përgjatë vitit 2020, dhe objektivat prioritare për vitin 2021.

Viti që kaluam ishte mjaft i vështirë për shkak të pandemisë, e cila krijoi probleme edhe në funksionimin e sistemit të prokurorisë. Megjithatë, prokurorët dhe strukturat administrative e mbështetëse të saj e përballuan më së miri.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe planit të veprimit ICRG/FATF<sup>1</sup> për vitin 2020, si dhe prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Për të garantuar, si rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën e përbashkët kundër krimit, forcimin e rendit juridik dhe shtetin e së drejtës, ashtu dhe mbrojtjen e lirive personale dhe të drejtave e interesave të ligjshme të shtetit, ka ende shumë për të bërë, dhe për këtë nevojitet vijimi i masave për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në sistemin e prokurorisë, përmirësimi i mëtejshëm i efikasitetit të bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë penale dhe i strukturave shtetërore, vijimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe integritetit në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë penale.

Duke ju siguruar se organi i prokurorisë do të intensifikojë masat në luftën efektive kundër kriminalitetit, ju paraqesim raportin për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020.

---

<sup>1</sup> ICRG/FATF-Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar.

**PËRMBAJTJA E LËNDËS**

<b>I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit .....</b>	<b>5</b>
Drejtimit prioritare, rekomandimet, aktivitetet dhe treguesit.....	5
Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Bashkimit Evropian.....	6
Zbatimi i Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”.....	35
Aktet normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre .....	45
Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave.....	50
Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq.....	52
<b>II. Analiza e treguesve të kriminalitetit.....</b>	<b>56</b>
2.1 Volumi i punës në hetim .....	56
2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.....	57
2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë në pesë vitet e fundit .....	57
2.4 Procedime penale të regjistruara sipas prokurorive.....	66
2.5 Koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë.....	68
2.6 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.....	70
2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	71
2.8 Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal.....	72
2.9 Analiza e veprave penale sipas strukturës së kodit penal.....	76
Krime kundër njerëzimit.....	76
Krime kundër jetës të kryera me dashje.....	76
Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi.....	81
Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje.....	81
Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia.....	85
Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës.....	86
Krime seksuale.....	89
Vepra penale kundër lirisë së personit.....	93
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.....	97
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.....	101
Vepra penale kundër lirisë së besimit.....	106
Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.....	106
Mashtrimet.....	111
Shkatërrimi i pronës.....	116
Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.....	120
Vepra penale në veprimtaritë bankare dhe financiare.....	123
Krime në fushën e doganave.....	124
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet.....	128
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë.....	132
Falsifikimi i dokumenteve.....	136
Vepra penale në fushën e falimentimit.....	140
Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit.....	140

Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës.....	143
Vepra penale kundër mjedisit.....	147
Krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera.....	151
Vepra me qëllime terroriste.....	152
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur,organizata kriminale.....	152
Krime kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.....	152
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik.....	157
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike.....	161
Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave.....	166
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë.....	171
Vepra penale kundër drejtësisë.....	174
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.....	179
Veprat penale të korrupsionit.....	179
Krimi kibernetik.....	179
Trafiqet e paligjshme.....	183
Veprat penale që lidhen me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve.....	188
2.10 Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite.....	193
2.11 Të dhëna për të pandehurit .....	199
<b>III. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.....</b>	<b>207</b>
Ekstradimet.....	207
Letërporositë.....	212
Njohjet e vendimeve penale.....	218
Transferimet e procedimeve penale.....	221
Transferimet e personave të dënuar.....	222
Urdhrat e arrestit ndërkombëtar.....	223
<b>IV Garantimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike .....</b>	<b>225</b>
<b>V. Ngarkesa e punës së prokurorive për vitin 2020.....</b>	<b>229</b>
<b>VI. Përmbledhje e analizës financiare.....</b>	<b>255</b>
<b>VII. Objektiva prioritarë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021.....</b>	<b>258</b>
<b>Aneksi 1 Tabelat me të dhëna e tregues statistikorë të veprave penale.....</b>	<b>265</b>
<b>Aneksi 2 Të dhëna pasuritë e sekuestruara dhe kërkesave për konfiskimi.....</b>	<b>290</b>

## I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2020

Prokuroria është organ i pavarur kushtetues, që ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Prokuroria për vitin 2020, përbëhet nga<sup>2</sup>:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në prokuroritë sipas niveleve më sipër funksionet ushtrohen nga prokurorët pranë tyre.

Zhvillimet kryesore, gjatë vitit 2020 në luftën kundër kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, në mënyrë sintetike, kanë qenë<sup>3</sup>:

### I. Drejtimit prioritarë, rekomandimet, aktivitetet dhe treguesit

Drejtimit kryesore të luftës kundër kriminalitetit për vitin 2020, të formalizuara, si në politikat dhe objektivat prioritarë institucionale të parashtruara në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm dërguar Kuvendit të Shqipërisë “Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2019” në mars 2020, ashtu dhe në kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritarë të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komitetit të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri dhe në planin e veprimit të ICRG/FATF<sup>4</sup> për Shqipërinë, kanë qenë në fokusin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2020, të cilët janë ndjekur me përparësi, si nëpërmjet masave administrative dhe procedurale institucionale siç janë miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjes së zbatimit tyre me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit bazuar në një kuadër normativ të unifikuar, konsoliduar dhe sa më eficient në veprimtarinë institucionale, ashtu dhe nëpërmjet akteve të përbashkëta me disa institucione dhe agjenci ligjzbatuese ndërvepruese për të rritur kapacitetet ndërinstitucionale e profesionale dhe eficienten e bashkëpunimit ndërinstitucional.

<sup>2</sup> Bashkëlidhur struktura dhe organika e prokurorisë, miratuar me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.29, datë 03.2.2020 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme”.

<sup>3</sup> Renditur sipas kërkesave të Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020

<sup>4</sup> ICRG/FATF-Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar.

## 1. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe i rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE-së).

Prokuroria e Përgjithshme, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në vendimin e Kuvendit nr.49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe në vendimin e Kuvendit nr.134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, ndërmori masat e nevojshme për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 dhe mbikëqyrjen e zbatimit të saj, si vijojnë:

Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr.103 datë 17.07.2020 miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 dhe ka ngritur Grupin e Punës për monitorimin e zbatimit të masave të planit të veprimit, në të cilin janë përcaktuar masat/aktivitetet, strukturat përgjegjëse, fondi i nevojshëm, afatet kohore dhe treguesit e zbatimit për secilën kërkesë të Rezolutës. Ky akt normativ me shkresën nr.943/4, datë 17.07.2020 i është dërguar për njoftim Kuvendit të Shqipërisë, dhe ndërkohë, me shkresën nr.943/3 prot., datë 17.07.2020 plani i veprimit i është dërguar për njoftje dhe zbatim të gjithë prokurorive me juridiksionit të përgjithshëm.

Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të objektivave të Planin e Veprimit dhe kërkesave të Rezolutës, (të cilët kërkojnë kohë dhe kapacitete njerëzore dhe profesionale), jemi të ndërgjegjshëm se realizimi i tyre është vështirësuar për arsyet objektive, së pari, në të gjithë nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm ka e po krijohen në vazhdimësi vakanca të përkohshme e të përhershme, për shkak të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, si dhe së dyti, për shkak të pandemisë Covid-19 që po kalon i gjithë vendi, duke filluar nga data 10 mars 2020.

Në mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave të rezolutës, evidentohen zhvillimet më të rëndësishme të përditësuara mbi ecurinë e zbatimit të saj, angazhimet dhe progresi lidhur me masat, aktivitetet, rezultatet e arritura dhe problematikat në zbatimin e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, për secilën kërkesë.

**1.1** Në zbatim të kërkesës së Rezolutës të Kuvendit për **“Rritjen e mëtëjshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale”**, kërkesë e cila përkon, dhe me, - **rekomandimet e Këshillit të Ministrave “Lufta kundër korrupsionit”, “Lufta kundër krimit të organizuar” e “Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional”**, gjatë vitit 2020, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet, si më poshtë:

1.1.1 Në kuadrin e masave për rritjen e mëtëjshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, Prokurori

i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr.11, datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, në të cilin janë përcaktuar masat për rritjen e efikasitetit, si kryerja e hetimeve proaktive efektive, kryerja e hetimeve të plota e të gjithanshme, përdorimi i mjeteve të posaçme/speciale të hetimit dhe kryerja e hetimeve financiare dhe pasurore, me qëllim vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale dhe sekuestrimin e konfiskimit të pasurive të ardhura nga veprimtaria kriminale, për parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të kriminalitetit sipas fushave.

i) Në zbatim të kësaj kërkesë të rezolutës, përgjatë vitit 2020, sipas kërkesave dhe procedurave ligjore, prokuroria në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit ka kryer hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 630 procedimeve për veprat penale kundër trafikëve të paligjshme të narkotikëve, personave e armëve/municioneve, përfshi dhe veprat penale kundër narkotikëve, pastrimit të parave dhe krimeve të rënda të tjera të lidhura me to, në kompetencë lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm. Prokurorët kanë patur rol aktiv, si në regjistrimin e procedimeve, dhënien e autorizimeve ose mbi kërkesën e tyre me vendime gjyqësore është autorizuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes për zbatimin e tyre. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 709 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

ii) Në mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm (nr.11/2020), sipas të dhënave statistikore dhe informacionit të disa prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm rezultojnë se, në Prokurorinë e Posaçme janë transferuar 130<sup>5</sup> procedime/referime penale, kryesisht për krimet kundër jetës, kalimit të paligjshëm të kufirit, trafikimit të narkotikëve dhe vepra penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të asaj prokurorie, disa raste nga të cilët, kryerja e hetimeve proaktive ka çuar në zbulimin e ekzistencës së elementëve të bashkëpunimit të veçantë, për kryerjen e hetimeve të mëtejshme në kuadrin e veprimtarisë kriminale të organizuar.

1.1.2 Në lidhje me këtë rekomandim për luftën kundër krimet të organizuar dhe korrupsionit, referuar kompetencës lëndore që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, evidentojmë se, për vitin 2020 lufta kundër krimet të organizuar dhe korrupsionit që përfshin këto grup veprash, janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme, në bashkëpunim, si me institucionet e reja të luftës kundër krimet të organizuar (SPAK), ashtu dhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit.

---

<sup>5</sup> Sipas të dhënave statistikore në Raportin Vjetor të Prokurorisë së Posaçme për vitin 2020 nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë transferuar për kompetencë lëndore 130 procedime penale në Prokurorinë e Posaçme.

***Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional***

i) Për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit, në këndvështrimin e Prokurorisë së Përgjithshme është konsideruar domosdoshmëri një qasje e përbashkët dhe e unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese. Për këtë qëllim, gjatë kësaj periudhe, Prokurori i Përgjithshëm një vëmendje të veçantë i ka kushtuar, si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, ashtu dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror. Në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe është synuar jo shprehja formale e vullnetit, por marrja e masave konkrete për rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe/ose referimeve në prokurori, inicimi i rasteve për kryerjen e hetimeve proaktive, nxjerrja e metodikave hetimore, vendosja e kontakteve dhe zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve profesionale, masa që çojmë se do të japin rezultate të prekshme në arritjen e objektivave të përbashkëta ndërinstitucionale.

ii) Në kuadrin e masave për forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe për rritjen e cilësisë së hetimeve e ndjekjes penale, në datë 15.12.2020, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nënshkruan Aktin e Koordinimit Institucional “Për rritjen e efikasitetit nëpërmjet bashkëpunimit të Prokurorisë së Përgjithshme, (ku përfshihen dhe prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm), me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj”, nëpërmjet komunikimeve të drejtpërdrejta në nivel qendror dhe në nivel lokal ndërmjet drejtuesve të prokurorive përkatëse sipas objektivave të përcaktuar në aktin e koordinimit dy palësh.

iii) Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me Kontrollin e Lartë të Shtetit, me Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me Ministrin e Brendshëm dhe Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, ku përfshihen dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, për rritjen e efektivitetit në hetimet e veprave penale në fushat përkatëse në kompetencë juridiksionale të këtyre institucioneve, të cilat do të trajtohen dhe më poshtë.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të kërkesës së rezolutës për ***forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme***, e konsiderojmë të realizuar këtë tregues, për faktin se me aktin e koordinimit ndërinstitucional dhe me marrëveshjet/memorandumet e bashkëpunimit (dy e shumë palëshe) është institucionalizuar bashkëpunimi dhe koordinimi me Prokurorinë e Posaçme dhe me MB, MFE, KLSH, ILDKPKI, DPPSH në nivel qendror dhe vendor, si dhe përgjithësisht është rritur efektshmëria në zbulimin, goditjen dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në fushat



përkatëse të veprimtarive ndërinstitucionale, duke inkurajuar vijimin e përmirësimit të mëtejshëm, si për rritjen e cilësisë, ashtu dhe në rritjen e efektivitetit së këtij bashkërendimi e koordinimi ndërinstitucional në të ardhmen.

1.1.3 Në kuadrin e zbatimit të kësaj kërkesë të rezolutës, gjatë vitit 2020 në luftën kundër veprave penale të trafikimeve të paligjshme, narkotikëve, veprave me qëllime terroriste, evidentohen politikat institucionale dhe ndërinstitucionale, masat administrative dhe procedurale, arritjet dhe gjendja e treguesve statistikorë, si vijojnë:

### ***Lufta kundër trafiqeve të paligjshme***

i) Treguesit për veprat penale **kundër trafiqeve të paligjshme** në vitin 2020 evidentohen me një ulje prej 12,54 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra në krahasim me vitin 2019. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është ulur 28,57 %, krahasuar me vitin 2019. Ndërsa në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale vërehet një ulje prej 10,53 % e të pandehurve të regjistruar, ulje e numrit të pandehurve të dërguar në gjykatë prej 20 %, dhe ulje e numrit të pandehurve të dënuar nga gjykata me 54,69 %, krahasuar me vitin 2019.

ii) Lidhur me **trafikimin e personave të rritur**, të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” në vitin 2020 është 8,91 %. Nga të dhënat statistikore për këtë vepër penale vërehet një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara prej 21,05 % në krahasim me vitin 2019.

-Në vitin 2020, për këtë vepër penale janë regjistruar 23 procedime penale dhe 1 procedim me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim.

iii) Për veprën penale “**Trafikimi i të miturve**” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” në vitin 2020 është 1,94 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 2,03 %.

-Në vitin 2020 për këtë vepër penale janë regjistruar 5 procedime ose me ulje në shifra 1 procedim krahasuar me vitin 2019, dhe është dërguar për gjykim 1 procedim me 11 të pandehur ose me rritje rreth 5 herë të numrit të personave të dërguar për gjykim, krahasuar me vitin 2019.

iv) Lidhur me **trafikimin e armëve dhe municionit** të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 2,71 %. Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale, është ulur nga 10 procedime penale të regjistruara në vitin 2019, në 7 procedime penale të regjistruara në vitin 2020.

-Në vitin 2020 për këtë vepër penale janë dërguar për gjykim 6 procedime penale me 9 të pandehur, ose me rritje 1 herë të numrit të procedimeve dhe rritje 2 herë të numrit të pandehurve dërguar për gjykim, krahasuar me vitin 2019.

### ***Lufta kundër trafikimit dhe kultivimit të narkotikëve***

i) Treguesit për veprat penale **kundër narkotikëve** në vitin 2020 evidentojnë se pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 6,18 %, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 4,76 %, ku vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

ii) Lidhur me luftën kundër **trafikimit të narkotikëve** parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikeve të paligjshme” në vitin 2020 është 28,68 %, ndërkohë që në vitin 2019 ky tregues ka qenë 29,49 % ose me ulje 0,81 %. Nga të dhënat statistikore për këtë vepër penale vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara prej 14,94 % në krahasim me vitin 2019.

-Në vitin 2020, për këtë vepër penale janë regjistruar 74 procedime, prej të cilëve 24 procedime me 54 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2019 me ulje 36 % të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim dhe me ulje 27.02 % të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim.

iii) Për veprën penale “**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup është 48,46 % për vitin 2020, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 57,02 % ose me ulje 8,96 %. Nga të dhënat statistikore vihet re se për këtë vepër penale, numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2020 është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2019.

Në vitin 2020, janë regjistruar 834 procedime me 875 të pandehur, dhe janë dërguar për gjykim 328 procedime me 473 të pandehur ose krahasuar me vitin 2019 me rritje 1 (një) procedim të regjistruar dhe me ulje 14, 6 % të numrit të procedimeve dhe 8,5 % të numrit të pandehurve të dërguar për gjykim.

iv) Për veprën penale “**Kultivimi i bimëve narkotikëve**” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup është 51,42 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 42,98 % ose me rritje 8,44 %. Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje prej 40,92 % e procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2019.

-Në vitin 2020, janë regjistruar 885 procedime me 357 të pandehur, dhe 145 procedime me 262 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2019 me rritje 40,9 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me rritje 119 % të numrit të procedimeve dhe rritje 165 % të numrit të pandehurve, të dërguar për gjykim.

v) Lidhur me politikën penale të ndjekur për këtë grup veprash, gjatë vitit 2020 prokuroria ka ndjekur një politikë të ashpër penale për të pandehurit që kanë kryer këtë grup veprash dhe kjo pasqyrohet në të dhënat konkrete lidhur me kërkesat si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe me kërkesat për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, të cilat janë si vijon:

- Për nenin 283/a të Kodit Penal të gjitha kërkesat (100 %) janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori që lidhen me caktimin e dënimit me burg janë në masat si vijon: 4 % e kërkesave

për caktimin e dënimit në minimum, 40 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 36 % në maksimumin e dënimit, ndërsa në 20 % të kërkesave është kërkuar aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal;

-Për nenin 283 të Kodit Penal, 62 % e kërkesave janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa kërkesat për llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezultojnë se: në 37 % të kërkesave është kërkuar aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, 19 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burgim në minimum dhe 44 % në marzhin mesatar të dënimit me burgim të parashikuar nga dispozita.

-Për nenin 284 të Kodit Penal, 91,4 % e kërkesave janë për caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërsa në kërkesat lidhur me llojin dhe masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezultojnë se: në 30 % të kërkesave është kërkuar aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, 8 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burgim në minimum dhe 62 % në marzhin mesatar të dënimit me burgim të parashikuar nga dispozita.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar rekomandimin e rezolutës për faktin se, si në uljen në tërësi të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikimit dhe shitjes së narkotikëve, ashtu dhe në rritjen e numrit të procedimeve dhe pandehurve të regjistruara dhe të dërguara gjyqit për kultivim të bimëve narkotike, kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel qendror dhe vendor në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, ashtu dhe efektet parandaluese, si nga sekuestrimi i sasive të konsiderueshme të drogës së kultivuar dhe të kapur gjatë vitit 2020, ashtu dhe goditja e vazhdueshme e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

✚ Me gjithë arritjet, referuar raporteve ndërkombëtare për këtë grup veprash penale në Shqipëri dhe rekomandimeve të KSA-së BE-Shqipëri, në vështrimin institucional, kërkohet dhe synohet vijimi i rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, për intensifikimin e hetimeve proaktive dhe përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit në funksion të zbulimit dhe goditjes të veprimtarisë, si të grupeve kriminale që udhëheqin dhe financojnë kultivimin e kanabisit dhe tranzitimin e kokainës brenda vendit dhe lidhjeve të tyre jashtë vendit, ashtu dhe sekuestrimin e konfiskimin e pasurive dhe produkteve të kësaj veprimtarie kriminale të tyre.

### ***Lufta kundër terrorizmit***

i) Të dhënat statistikore në kuadrin e luftës kundër terrorizmit gjatë vitit 2020, evidentojnë se janë regjistruar 12 procedime penale nga 10 procedime të regjistruar në vitin 2019. Konkretisht, gjatë vitit 2020 janë regjistruar: -2 procedime për nenin 230/a të Kodit Penal “Financimi i Terrorizmit”, -3 procedime për nenin 230 “Vepra me qëllime terroriste”, -1 procedim për nenin 231 “Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit”, -6 procedime për nenin 232/a “Nxitja, thirrja

publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”, -1 procedim për nenin 232/b “Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”.

-Ndërkohë, për nenin 232/a të Kodit Penal “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 2 të pandehur dhe 1 person është dënuar për këtë vepër penale.

### ***Bashkëpunimi ndërkombëtar***

i) Prokurori i Përgjithshëm, në përmbushje të rekomandimit të BE-së “*Shqipëria është e ftuar të sigurojë caktim të shpejtë të një prokurori ndërlidhës shqiptar në selinë e Eurojust për të lehtësuar më tej bashkëpunimin Shqipëri-Eurojust*” mori një rol aktiv në procesin përzgjedhjes për caktimin e prokurorit ndërlidhës në Eurojust. Në këtë kuadër, pas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është zhvilluar procedura e komandimit të një prokurori në pozicion e prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust. Prokurori i Përgjithshëm përzgjodhi për pozicionin e prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust znj.Fatjona Memçaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

-Në datën 17 dhjetor 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbi bazën e propozimit të bërë, vendosi komandimin e prokurores znj.Fatjona Memçaj në Eurojust. Prokurori ndërlidhës do t’i ushtrojë funksionet në zyrën e Eurojust në Hagë për një periudhë prej 2 vjet e 6 muaj.

-Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit, koordinimit të hetimeve dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me autoritet gjyqësore të vendeve evropiane.

ii) Gjatë vitit 2020 të dhënat statistikore në kuadër të letërkërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike, rezultojnë si më poshtë:

- 119 ekstradime nga jashtë;
- 114 ekstradime për jashtë;
- 550 letërporosi nga jashtë;
- 620 letërporosi për jashtë.
- 35 transferime të dënuarish nga jashtë;
- 5 transferime të dënuarish për jashtë;
- 34 transferime procedimi nga jashtë;
- 15 transferime procedimi për jashtë;
- 54 njohje vendime penale nga jashtë;
- 12 njohje vendime penale për jashtë;

iii) Janë trajtuar 308 praktika në kuadër të strukturës policore Operacioni Forca e Ligjit (OFL), nëpërmjet të cilave është kërkuar verifikimi dhe përcjellja e dokumentacionit për 951 shtetas shqiptarë.

iv) Janë trajtuar 28 praktika, (kërkesa për asistencë), në bashkëpunim me Eurojust, nga të cilat 21 kërkesa janë dërguar nga prokurorët e vendeve të BE-së të atashuar në Eurojust, ndërsa 7 kërkesa janë përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme në Eurojust, me qëllim lehtësimin e dhënies së ndihmës juridike në kohë reale.

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar kërkesën e rezolutës dhe rekomandimin e KSA-së BE-Shqipëri nëntor 2019, për faktin se, u mundësua komandimi i prokurorit ndërlidhës shqiptar në Eurojust. Gjithashtu, të dhënat dhe angazhimet institucionale të prokurorisë, evidentojnë tregues në rritje të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja në të gjithë fushat e bashkëpunimit ndërgjyqësor dhe forcimin e besimit ndaj institucionit të prokurorisë nga partnerët në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

✚ Me gjithë arritjet, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shqipëri-Eurojust, me komandimin e prokurorit ndërlidhës shqiptar në Eurojust, në vështrimin institucional kërkohet dhe synohet, rritja e efikasitetit, intensifikimi dhe lehtësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore të vendeve anëtare dhe me vendet e treta, përfshi vendet e rajonit, si për të shkëmbyer informacion të ndërsjellë në kohë reale lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale brenda vendit që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së grupeve kriminale brenda dhe jashtë vendit.

**1.2** Në zbatim të kërkesës së Rezolutës *“Të rrisë efektivitetin e bashkëpunimit ndërinstytucional me agjencitë e tjera për luftimin e pastrimit të produkteve dhe krimin financiar, të forcojë kapacitetet profesionale për hetimet pasurore, hetimet proaktive të pastrimit të parave, sekuestrimit dhe konfiskimit të tyre me qëllim zbulimin, identifikimin dhe sekuestrimin/konfiskimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, si dhe për një politikë penale efektive në këtë fushë”*, kërkes e cila përkon, si me, -rekomandimet e Këshillit të Ministrave *“Lufta kundër krimin të organizuar”* e *“Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional”*, ashtu dhe me, -rekomandimet e KSA-së e FATF, dhe Planit Veprimit të ICRG/FATF *“Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit parave...”* për Shqipërinë, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.2.1 Në kuadrin e masave në zbatim të kësaj kërkesë të rezolutës dhe të rekomandimeve të KSA-së e FATF, si dhe të Planit Veprimit të ICRG/FATF, në datë 15 korrik 2020, Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Financave e Ekonomisë dhe Ministri i Brendshëm, nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit *“Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve me origjinë kriminale”*. Përmes këtij memorandumi palët kanë institucionalizuar bashkëpunimin në nivel qendror dhe vendor për kryerjen e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe agjencive përkatëse të zbatimit të ligjit, sipas fazave të gjurmimit, hetimit dhe ndjekjes penale, dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta trajnuese për forcimin e kapaciteteve profesionale.

1.2.2 Në vijim të kësaj marrëveshje, më datë 17.07.2020 Prokurori i Përgjithshëm nxorri udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efikasitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit, si dhe për hetimin e pasurisë dhe sekuestrimin/konfiskimin e produkteve kriminale, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, i cili ka për qëllim, ndër të tjera, të normojë dhe unifikojë masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, për rritjen e efektivitetit në hetimet pasurore dhe financiare, për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkti i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Ky udhëzim synon të forcojë luftën kundër pastrimit të produkteve të veprave penale të rënda dhe ato që përftojnë asete kriminale, kryerjen e hetimeve (paralele) financiare në të gjitha procedimet penale të regjistruara, duke goditur këto veprimtari, si nëpërmjet dënimit penal, ashtu edhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkti i veprës penale dhe/ose aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe/ose vlerën ekuivalente.

i) Këto akte të politikave institucionale dhe ndërinstitutionale evidentojnë progresin në krijimin e një bazë solide për rritjen e efikasitetit në kryerjen e gjurmimit, hetimit dhe ndjekjes penale të këtyre veprave, pasi këto akte krijuan korniza për ngritjen e seksioneve të veçanta në prokuroritë vendore, rritjen e kapaciteteve në seksionet e veçanta të drejtorive të policisë vendore, forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, të cilëve u janë besuar trajtimi i rasteve të luftës kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, si dhe përmirësimi i efikasitetit së bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel vendor dhe qendror.

ii) Udhëzimi i përgjithshëm nr.10/2020 plotësoi dispozitat e Memorandunit të Bashkëpunimit dhe është një instrument në përdorim nga prokurorët dhe policia gjyqësore, i cili përcakton: -seksionet e veçanta përbëhen nga prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore që hetojnë çështjet e pastrimit të parave; -nevojat për trajnim të prokurorëve, policisë gjyqësore dhe agjencive ligjzbatuese të përfshira; -kornizën për shkëmbimin e informacionit; -kompetencat e prokurorëve; dhe -hetimet paralele financiare dhe pasurore për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

1.2.3 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi (datë 1 shtator 2020) u krijuan seksionet e posaçme për hetimin e pastrimit të parave, krimit financiar dhe hetimet pasurore në 7 (shtatë) prokurori të juridiksionit të përgjithshëm me përbërje, drejtues seksioni, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, ndërsa në 15 prokurori u caktua nga një prokuror në secilën prej tyre për ndjekjen e këtyre çështjeve. Në total, 41 prokurorë janë ngarkuar me ndjekjen penale të pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe kryerjen e hetimeve pasurore në zbatim të ligjit procedural penal dhe ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

-Të gjitha prokuroritë kanë ose seksion të veçantë ose prokuror të caktuar për ndjekjen penale të këtyre veprave penale. Prokurorët e caktuar kanë një përvojë minimale prej katër vitesh në hetimin e krimeve financiare dhe ata po punojnë në bashkërendim me oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve në strukturat e posaçme të Policisë së Shtetit.

1.2.4 Prokuroria e Përgjithshme, në kuadrin e masave për forcimin e kapaciteteve profesionale të të gjithë aktorëve të përfshirë, në memorandumin e bashkëpunimit me MB e MFE, marrëveshjet e bashkëpunimit me KLSH e ILDKPKI dhe në udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020, me synim për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e unifikuar të ligjit, si dhe rritjen e efektivitetit në gjurmimin, hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të autorëve të veprës penale pastrimi i parave, ka shtuar përpjekjet në dy drejtime nëpërmjet masave, si më poshtë:

i) Ka vendosur kontakte zyrtare me projektin spanjoll FIIAPP, i cili ka shprehur interes për të bashkëpunuar dhe me partnerë ndërkombëtar të tjerë, për të asistuar Prokurorinë e Përgjithshme në “Përditësimin e manualit të Projektit të Binjakëzimit të BE “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri”, i vitit 2013, me standardet dhe praktikën e mira evropiane, praktikën shqiptare dhe ide novative mbi metodikën e hetimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, që synojmë të realizojmë, për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe rritjen e hetimeve pasurore dhe sekuestrimeve/konfiskimeve. Puna e këtij projekti me objekt “Luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri përmes hetimit penal dhe financiar” ka filluar me 1 mars 2021 sipas njoftimit zyrtar të Prokurorisë së Përgjithshme nga drejtuesit e projektit FIIAPP.

ii) Krahas masave për forcimin e kapaciteteve profesionale të të gjithë aktorëve të përfshirë në memorandumin e bashkëpunimit me MB e MFE, marrëveshjet e bashkëpunimit me KLSH e ILDKPKI dhe udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020, Prokuroria e Përgjithshme në muajin Korrik 2020 u është drejtuar prokurorive dhe ka kryer një vlerësim të situatës ku ka rezultuar se janë të nevojshëm trajnimet mbi pastrimin e parave, hetimin financiar e pasuror dhe mbi veprat penale që lidhen me detyrën<sup>6</sup>.

1.2.5 Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin PAMECA V, kanë organizuar trajnime të përbashkëta, për forcimin e kapaciteteve profesionale të aktorëve të përfshirë nga gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit (DPPPP, DPPSH, DPT, DPD, ILDKPKI, KLSH, etj) që kanë një rol thelbësor në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve që lidhen

<sup>6</sup> Sqarimim: Nga vlerësimi i situatës ku ka rezultuar se janë të nevojshëm trajnime lidhur me temat:

-“Kuptimi i pastrimit të parave në të drejtën ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor/normativ shqiptar; format dhe metodat/tipologjitë e pastrimit të parave; provat rrethore/tërthorta që provojnë dijeninë dhe qëllimin, roli i institucioneve financiare; roli i FIU;

-Analiza e riskut, gjurmimi dhe hetimi financiar: Llojet e të dhënave financiare në dispozicion të hetimit; ku ti gjejme dhe si ti përdorim; standardet dhe praktika evropiane;

-Metodika e hetimit të veprave penale në fushën e pastrimit të parave sipas tipologjive dhe krimit ekonomik, praktikat evropiane.”

-Përdorimi i mjeteve dhe metodave të posaçme/speciale të hetimit në hetimin financiar; standartet dhe praktikat evropiane;

-Bashkëpunimi ndërinstitucional kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar në pastrimin e parave;

-Korrupsioni dhe veprat e lidhura me detyrën si vepra mëmë të pastrimit të parave; hetimi pasuror e financiar në këto çështje;

-Provat e tërthorta në procesin e të provuarit;

-Subjekti aktiv i veprës penale të shpërdorimit të detyrës; identifikimi i pasojës në shpërdorimin e detyrës;

me detyrën, korrupsionit, krimin ekonomik e financiar, me synim rritjen e efikasitetit të hetimeve në fushën e pastrimit të parave, hetimeve financiare e pasurore, hetimeve të krimeve që lidhen me detyrën, krimin ekonomik dhe korrupsionit.

i) Organizimi i ciklit të trajnimeve online, është kryer sipas programit me temat e planifikuara në dy module “Mbi pastrimin e parave dhe hetimi financiar e pasuror” dhe “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën”, me ekspertë/lektorë të njohur ndërkombëtarë e shqiptarë dhe pjesëmarrjen e rreth 290 përfaqësuesve, prokurorë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe të Prokurorisë së Posaçme, oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të posaçëm në prokurori, oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve në strukturat e posaçme në Policisë Shtetit, punonjës të strukturave hetimore në DPT dhe DPD, punonjës të DPPPP, KLSH dhe ILDKPKI.

ii) Në dhjetor u zhvilluan trajnimet me temë “Pastrimi i parave dhe hetimi pasuror dhe financiar” me pjesëmarrës rreth 69 përfaqësues nga të gjithë institucionet ligjzbatuese që kanë rol të rëndësishëm në luftën kundër pastrimit të parave, dhe me temë “Mbi veprat penale që lidhen me detyrën” me pjesëmarrjen e rreth 79 përfaqësuesve të institucioneve ligjzbatuese. Këto dy module trajnimi sipas planifikimit u zhvilluan dhe në janar 2021 me grupet e dytë të përfaqësuesve të institucioneve më sipër që shprehën interesin dhe morën pjesë në këto trajnime.

1.2.6 Rezultat i këtyre masave është progresi i evidentuar me rritjen e efektivitetit në hetimet për veprat penale të pastrimit të parave të parashikuara nga nenet 287 e 287/b të Kodit Penal, pasi të dhënat statistikore tregojnë se për këto dy vepra në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka rritje 20.1 % të numrit të procedimeve dhe 102 % të numrit të pandehurve të regjistruar, ndërsa rritja 11 % e numrit të personave të dënuar i përket veprës penale të pastrimit të parave sipas nenit 287 të K.Penal.

-Në këtë vështrim, gjatë vitit 2020 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, janë regjistruar 279 procedime, me 65 të pandehur, prej të cilëve 17 procedime, me 30 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2019 me rritje 20,2 % të procedimeve dhe 103,1 % e të pandehurve të regjistruar. Në shifrat e ulëta, si të numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, ashtu dhe të numrit të gjykuarve, ka ndikuar dhe gjendja e pandemisë Covid-19.

- Veç sa më sipër, në treguesit në ulje të procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë veprë penale të krahasuar me vitin 2019 ndikojnë dhe mungesa e treguesve të Prokurorisë së Posaçme, të cilët (treguesit e ish-Prokurorisë për Krime të Rënda<sup>7</sup>) në vitin 2019 kanë qenë të përfshirë në të dhënat/treguesit e raportuara nga Prokuroria e Përgjithshme.

<sup>7</sup> Koment: Në vitin 2019 treguesit për këtë veprë të ish-Prokurorisë për Krime të Rënda kanë qenë të përfshirë në raportimin e Prokurorisë së Përgjithshme.



1.2.7 Përgjatë vitit 2020, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, në kuadrin e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” sipas nenit 287 të K.Penal dhe për vepra të tjera penale të lidhura me to, janë kryer sekuestrime pasurie mbi kërkesën e prokurorëve me vendimet gjyqësore, në kuadrin e 5 procedimeve penale, që përbën numër të ulët në raport me numrin e procedimeve të dërguara për gjykim. Pasuritë e sekuestruara sipas tipologjive të sekuestrimit preventiv në zbatim të nenit 36 të Kodit Penal dhe neneve 274 dhe/ose 210 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, të cilët janë në Aneksi 2 bashkëlidhur.

-Gjithashtu, në vitin 2020, prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të nenit 3/1 e vijues të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, në kuadrin e hetimeve pasurore, mbi kërkesën e prokurorëve të pranuar nga gjykata për 4 (katër) procedime është vendosur sekuestrimi i pasurive, të cilët janë në Aneksi 2 bashkëlidhur.

-Gjithashtu, lidhur me treguesit në ulje të sekuestrimeve pasurore në kuadrin e hetimeve pasurore në zbatim të ligjit nr.10192/2009 (i ndryshuar) të krahasuar me vitin 2019, vlerësojmë se, ndikon mungesa e treguesve të Prokurorisë së Posaçme, kjo për faktin se në vitin 2019 treguesit e ish-Prokurorisë për Krime të Rënda kanë qenë pjesë e treguesve të raportuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

1.2.8 Ndërkohë, përgjatë gjithë vitit 2020 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar në realizimin e masave të planit të veprimit ICRG/FATF ku përfshihet prokuroria dhe në përgatitjen e pjesëve të raportit të progresit dhe përgjigjeve për pyetjet e ekspertëve të ICRG e FATF në kuadër të raportimit periodik, ku janë administruar dhe analizuar përpjekjet e bëra për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për vitin 2020.

✚ Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë objektiv prioritar, kërkesën e rezolutës së Kuvendit dhe disa aktivitete të planit të veprimit të FATF/ICRG, për faktin se evidentohen arritje, si në realizimin e politikave dhe masat administrative e procedurale institucionale dhe ndërinstitutionale, ashtu dhe në rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitutional me institucionet dhe agjencitë e përfshira në këtë fushë (MB, MFE, DPPSH, AAPSK, DPPP, DPD, DPT), forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të tyre, dhe rritjen e numrit të hetimeve dhe të pandehurve të regjistruar për veprën penale të pastrimit të parave.

✚ Në vijim të zbatimit të objektivave prioritare dhe Planit të Veprimit ICRG/FATF, kërkohet dhe synohen, rritja më tej e efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitutional me institucionet dhe agjencitë e përfshira në këtë fushë, vijimi i punës së nisur për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre, për të rritur më tej efektivitetin e hetimeve dhe ndjekjes penale për veprat penale të pastrimit të parave, krimeve financiare dhe hetimet pasurore për

identifikimin dhe sekuestrimin/konfiskimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, veçanërisht të aseteve që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe vlerë ekuivalente, si dhe për vepra penale apo krimeve të rënda të tjera që gjenerojnë të ardhura nga veprimtaria kriminale.

1.3 Në zbatim të kërkesës së Rezolutës *“Të vijojë punën për rritjen e aksesit të përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, sidomos në atë të noterisë dhe të shërbimit të përmbartimit gjyqësor dhe të informojë Kuvendin në lidhje me përmbushjen e këtij rekomandimi dhe nevojat për adresimin e vështirësive të hasura, nëse do të ketë të tilla”*, e cila përkon me; **-rekomandimin e KM “Rritja e efektifitetit në luftën kundër korrupsionit ...”**, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.3.1 Prokuroria e Përgjithshme, në vijim të zbatimit të masave për lehtësimin e hyrjes dhe përdorimit të bazave të të dhënave shtetërore në funksion të hetimit dhe gjyqimit, në muajin prill 2020 u nënshkrua marrëveshja dy palëshe për aksesin në bazën e të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe arritur teknikisht aksesimi.

1.3.2 Në vijim, Prokuroria e Përgjithshme hartoi një plan masash, në të cilin përfshihen aktivitetet:

i) Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr.14, datë 21.09.2020 *“Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”*, i cili ju dërgua për zbatim prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

ii) Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar korrespondencën me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me realizimin e aksesit në Regjistrin Noterial Shqiptar. Ministria e Drejtësisë i është drejtuar AKSHI-t, me kërkesë krijimin e rolit *“Raportues”*, me të drejtë aksesit në RNSH, për të monitoruar apo për të raportuar mbi veprimet noteriale.

iii) Prokuroria e Përgjithshme i ka kërkuar në mënyrë të përsëritur Ministrisë së Drejtësisë, për ti vënë në dijeni mbi hapat e ndërmarrë lidhur me realizimin e aksesit në *“Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbartimit Gjyqësor”*, dhe nuk ka ende një përgjigje nga Ministria e Drejtësisë.

iv) Lidhur me aksesin në regjistrin elektronik të recetave të rimbursueshme, Ministria e Drejtësisë i ka parashtruar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, kërkesën për hartimin e një akti nënligjor për krijimin e aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave të regjistrit të recetave elektronike. Pas kërkesës sonë, me nr.3079/5 prot., datë 12.10.2020, Ministria e Shëndetësisë në referencë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, *(përfshirë edhe VKM nr/503, datë 24.06.2020)*, lidhur me mbrojtjen e informacionit shëndetësor, si e dhënë sensitive dhe aksesin e kufizuar vetëm për personin dhe profesionistët e shëndetësisë, ka ofruar bashkëpunimin sipas nevojave.

v) Me kërkesën drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe për dijeni Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, kemi iniciuar ushtrimin e nismës ligjore për shtesa dhe ndryshime të nevojshme në ligjet përkatëse, me qëllim që t’u lejohet prokurorive të

juridiksionit të përgjithshëm hyrja në bazat e të dhënave shtetërore dhe të çdo personi juridik privat që ushtron funksion publik, për lehtësimin e hyrjes dhe përdorimit të bazave të të dhënave në funksion të rritjes së efikasitetit të hetimit, ndjekjes penale dhe gjyqimit.

-Ministria e Drejtësisë ka pranuar kërkesën dhe ka përgatitur projektligjin për ndryshime e shtesa në ligjin nr.97/2017 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihet dhe neni shtesë 108/a “për të drejtën e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm që të kenë akses të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara, në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore”, i miratuar me ligjin nr.42/2021.

1.3.4 Në zbatim të kërkesës së rezolutës të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të KM, për forcimin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve gjatë fazës së procedimit penal dhe ekzekutimit të vendimeve penale, Prokuroria e Përgjithshme ka inicuar propozimin, është dakortësuar kërkesa për dhënie aksesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhe në dhjetor 2020 ka përgatitur e dërguar për nënshkrim projektmemorandumin e bashkëpunimit “Për dhënien e të drejtës së hyrjes/aksesit prokurorisë në bazën e të dhënave “Menaxhimi i Informacionit të Sistemit Penitenciar””, me qëllim, rritjen e shkallës së ndërveprimit për një funksionim efektiv të bashkëpunimit dhe përmirësimin e veprimtarisë ndër-institucionale. Ky memorandum bashkëpunimi u nënshkrua nga palët në shkurt 2021 dhe ju dërgua për zbatim gjithë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

1.3.5 Në kuadrin e dhënies së opinioneve për projektligjet e ardhura për mendim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me projektligjin “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” është kërkuar që të bëhen ndryshimet dhe shtesat e nevojshme me synim që prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të kenë akses elektronik të lirë, direkt dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistrit qendror të llogarive bankare, në përmbushje të funksioneve Kushtetuese dhe ligjore të tyre, për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të autorëve të dyshuar të veprave penale të pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit e krimeve të tjera të rënda dhe hetimin e pasurive/aseteve të dyshuara si të ardhura nga veprimtaria kriminale për sekuestrimin dhe konfiskimin e tyre sipas ligjit, si dhe në të njëjtin standard me ligjin nr.112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, etj.

1.3.6 Në kuadrin e zbatimit të kësaj kërkesë të rezolutës dhe të rekomandimit të KM, dhe nevojave për adresimin e vështirësive të hasura për përdorimin e bazave të të dhënave shtetërore dhe të çdo personi juridik privat që ushtron funksion publik, me synim për lehtësimin e hyrjes në databazë në funksion të rritjes së efikasitetit të hetimit, ndjekjes penale, ju parashtrijmë problematikën e përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme nga drejtuesit dhe prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, lidhur me zbatimin e vendimit të KM nr.389 datë 18.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të

shërbimeve kadastrale”, ku në pikën 9, në lidhje me pikën 6 e 9.2 e vijues parashikohet se, *Institucionet e permendura ne pikën 9 të këtij vendimi (ku përfshihen a)Gjykatat, b)Prokuroritë, c)Policia e Shtetit, etj) përjashtohen nga parapagimi i tarifave për nëntë zëra (me numër rendor 31,49,50,51,59,60,62,63,64) dhe e paraqesin kërkesën për shërbime kadastrale, pranë strukturave vendore të ASHK-së, në rrugë digjitale-on-line, ...si të gjithë subjektet e tjera të interesuara, nëpërmjet platformës e-Albania... ata duhet ti shlyejnë drejtorisë vendore të ASHK-së, çdo muaj, shumën e tarifave të shërbimeve kadastrale të ofruara në favor të tyre gjatë muajit paraardhës .*

-Në këtë vështrim, prokuroritë nuk kanë akses elektronik të drejtpërdrejtë, por kanë akses të kufizuar në të dhënat e ASHK-së, parashikime në këtë vendim të KM që kanë penguar dhe po pengojnë prokurorët dhe jo vetëm, në përmbushjen e funksioneve ligjore të tyre, për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të autorëve të dyshuar të veprave penale dhe hetimin e pasurive/aseteve të dyshuara që mund të jenë administruar dhe regjistruar në ASHK, që përfaqësojnë të ardhura të dyshuara nga veprimtaria kriminale për sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e tyre sipas ligjit.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, këtë kërkesë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve të KM e konsiderojmë të zbatuar për vitin 2020 dhe po vijon puna për lehtësimin e mëtejshëm të hyrjes dhe përdorimit të bazave të të dhënave shtetërore në funksion të hetimit dhe gjyqimit në proces zbatimi për vitin 2021.

**1.4** Në zbatim të kërkesës së Rezolutës së Kuvendit **“Të miratojë rregullat standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim që të sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori”**, që përkon dhe me; **-rekomandimin e KM “Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit...”,** gjatë vitit 2020, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.4.1 Me synim përmirësimin e rregullave standard në organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit në organizimin dhe funksionimin e seksioneve të prokurorive, në datë 08.09.2020, me urdhrin nr.120 të Prokurorit të Përgjithshëm, u miratuan disa shtesa në rregulloren standard të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Kjo ndërhyrje u vlerësua e rëndësishme edhe në kuadrin e harmonizimit ndërmjet udhëzimeve të përgjithshme dhe rregullores në fuqi lidhur me organizimin dhe funksionimin e seksioneve në prokurori.

1.4.2 Në vijim të procesit për rishikimin e plotë të rregullores standard në bashkëpunimit dhe me projektin EURALIUS V, me urdhrin nr.164 datë 18.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm u miratuan dy Regulloret Standard, për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm, dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm,

me qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me, organizimin dhe funksionimin e secilës strukturë që kryen funksione procedurale dhe administrative sipas strukturës standarde<sup>8</sup>, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të çdo strukture, për të siguruar efikasitet në organizimin, drejtimin, koordinimin, mbikëqyrjen/monitorimin e punës në çdo prokurori.

i) Tashmë është e ditur se në të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm ka e po krijohen në vazhdimësi vakanca të përkohshme e të përhershme kryesisht për shkak të rivlerësimit kalimtar. Situata është edhe më kritike në ato prokurori ku ushtron de facto funksionet vetëm 1 (një) prokuror, i cili është njëkohësisht edhe drejtues prokurorie.

-Kjo gjendje kritike me tendencë në rritje në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, dhe jo vetëm, ritheksojmë se kërkon: **së pari**, krahas masave për plotësimin e vakancave me prokurorë, marrjen e masave emergjente për shtimin, e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të numrit në administratën ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjithë niveleve, **së dyti**, nevojën për miratimin e hartës së re gjyqësore dhe përmirësime në infrastrukturë për rritje të kapaciteteve akomoduese me ambjente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokurori, me synim për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar dhe pëmirësuar kushtet e punës, në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

1.4.3 Në datë 28.10.2020, me urdhrin nr.136 të Prokurorit të Përgjithshëm, u miratua rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të strukturave që kryejnë funksione procedurale dhe administrative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të çdo strukture të miratuar me urdherin nr.29 datë 03.02.2020 “Për strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme”, si dhe administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Prokurorisë së Përgjithshme, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre.

i) Risi në strukturën e re të kësaj rregulloreje është dhe krijimi i strukturave koordinuese dhe monitoruese në Prokurorinë e Përgjithshme. Funksionet e Sektorit të Monitorimeve, si sektor përgjegjës për monitorimin e veprimtarisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, janë përcaktuese në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë, garantimit të respektimit të pavarësisë së prokurorëve dhe rritjes së përgjegjshmërisë, respektimin e etikës, shmangien e konfliktit të interesit dhe respektimit të drejtave të subjekteve të procedimit penal. Realizimi i kësaj përgjegjësie është parashikuar të kryhet nëpërmjet mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrave dhe udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë, kërkimit të informacioneve periodike apo marrjes së informacioneve/indicieve dhe të dhënave rast pas rasti nga ankesat e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, oficerëve të policisë gjyqësore, institucione apo shtetasve. Për gjetjet nga monitorimet propozohen zgjidhje afatshkurta dhe afatgjata, në nivel politikash,

<sup>8</sup> Neni 20 në lidhje me nenin 38 pika 2 shkronja “e” e ligjit nr.97/2016;

ndryshime në aktet normative dhe/ose kërkimi i inspektimeve tematike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

1.4.4 Në kuadrin e forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, krahas angazhimeve të Sektorit të Monitorimit, të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë (ILD-në) në kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike, dhe për shkeljet individuale të magistratëve/prokurorë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, nëpërmjet ushtrimit dhe zbatimit të praktikave më të mira në çështjet disiplinore për rritjen e performancës së sistemit të drejtësisë penale, Prokuroria e Përgjithshme (PP) me synim rritjen e bashkëpunimit me Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), në nëntor 2020 ka përgatitur dhe iniciuar Projektmarrëveshjen e Bashkëpunimit “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, marrëveshje e cila u nënshkrua nga palët në shkurt 2021.

i) Me krijimin dhe fillimin e funksionimit të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në Shkurt 2020, në zbatim të nenit 283 e vijues të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.40, datë 07.02.2020 “Për kalimin e ankesave dhe akteve disiplinore Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.335 datë 14.02.2020 “*Dërgohen ankesat dhe aktet e hetimit disiplinor për kompetencë*” i ka dërguar Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë për kompetencë 52 praktika lidhur me ankesa dhe/ose materjale në proces verifikimi dhe hetimi disiplinor.

ii) Në vijim, në një rast me shkeljet e konstatuara të një magjistrati/prokuror është përgatitur materiali dhe i është kaluar për inicim të procesit të inspektimit Institucionit të Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

🚦 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë kërkesë, si të rezolutës së Kuvendiut, ashtu dhe të rekomandimeve të KM, për faktin se janë miratuar, dy rregulloret standard me urdhrin nr.164/2020 dhe rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme me urdhërin nr.136/2020, si dhe janë ngritur strukturat e koordinimit dhe monitorimit që do të sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe monitorimin e punës në çdo prokurori, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

**1.5** Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit “*Të forcojë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për të plotësuar nevojat për prokurorë dhe sigurimin e mbarëvajtjes së punës në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore*”, janë zvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.5.1 Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, po bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Shkollën e Magjistraturës, të

orientuar nga një vizioni bashkërendues për të siguruar mbarëvajtjen e punës administrative në prokurori, rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe lehtësimin drejt shmangies së problematikave që janë e po krijohen me vakancat e prokurorëve në sistemin e prokurorisë në këtë periudhë të procesit të rivlerësimit kalimtarë.

1.5.2 Konkretisht, fryt i bashkërendimit me këto institucione janë:

- Emërimi i magistratëve të rinj, në korrik 2020, në gjashtë vendet vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Vlorë, Korçë, Berat, Kavajë, Lezhë e Krujë;

- Niveli i pranimit të 26 (njëzetegjashtë) kandidatëve për prokuror, në Shkollën e Magjistraturës në korrik 2020, është i kënaqshëm për kapacitetet që ka Shkolla, me pritshmëri ndikimin e uljes së vakancave në sistemin e prokurorisë në vitin 2023;

- Paraqitja në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga Prokuroria e Përgjithshme e analizës dhe vlerësimit të ngarkesës mesatare të volumit të punës në secilën prokurori dhe nevojës së balancimit të ngarkesës në të gjithë sistemin e prokurorisë kanë ndikuar në ndryshimet/shtesat e nevojshme në strukturën e disa prokurorive, vakanca të cilat i janë njoftuar periodikisht dhe Shkollës së Magjistraturës, për të patur në vëmendje shtimin e numrit të kandidatëve për magistrat profili prokuror, brenda kapaciteteve të saj, kapacitete të cilët vlerësojmë se është e nevojshme të rishikohet mundësia e rritjes së tyre për shkak të gjendjes së vakancave të krijuara që po shtohen në vijim të procesit të vettingut.

1.5.3 Gjatë vitit 2020 në bashkërendim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë u bë dhe kalimi i dosjeve të magistratëve prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme në strukturën përkatëse të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, kërkesën e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë e konsiderojmë të zbatuar për vitin 2020 dhe po vijon puna për vitin 2021 për marrjen e masave të nevojshme në vazhdimësi të vakancave të përkohshme e të përhershme, kryesisht për shkak të rivlerësimit kalimtar, si dhe për rritjen e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të numrit në administratën ndihmëse/mbështetëse të prokurorëve në prokuroritë e të gjithë niveleve, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur vepimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

1.6 Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, ***“Të miratojë udhëzimin e standardizuar për zbatimin e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike,”*** Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur projektudhëzimin e përgjithshëm ***“Për masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen ose ushtrojnë funksione publike”***, miratuar nga Prokurori Përgjithshëm, me nr.18, datë 31.12.2020, me të cilin janë unifikuar masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17, datë



04.03.2016 të Kuvendit të Shqipërisë, duke respektuar procesin e rregullt ligjor, dhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, mbrojtjes së të dhënave personale, konfidencialitetit dhe të sekretit shtetëror.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë kërkesë të rezolutës së Kuvendit për vitin 2020 për faktin së është miratuar dhe po zbatohet udhëzimi i përgjithshëm nr.18/2020, i cili ka unifikuar masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015.

1.7 Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, ***“Të nxisë, bashkëpunojë dhe kontribuojë në miratimin sa më shpejt nga ana e Komisionit të Policisë Gjyqësore të sistemit të vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore”***, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.7.1 Prokurori i Përgjithshëm ka nxitur, mbështetur dhe asistuar Komisionin e Policisë Gjyqësore në përgatitjen e projektregullore për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të miratuar me vendimin nr.27/1 datë 30.10.2020 nga Komisioni. Rregullorja u hartua edhe me asistencën e Projektit PAMECA V dhe Prezencën e OSBE në Shqipëri. Kjo rregullore së bashku me anekset e saj iu shpërnda gjithë prokurorive dhe institucioneve shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore.

i) Lidhur me zbatimin e sistemit të vlerësimit, Komisioni i Policisë Gjyqësore, duke marrë në konsideratë natyrën e paqartë të dispozitave që rregullojnë vlerësimin e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, varësinë e dyfishtë të tyre, mosngritjen ende të “Strukturës hetimore”, sipas parashikimeve të ligjit nr.25/2019 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore’, si dhe faktin që institucionet e tjera shtetërore, të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e policisë gjyqësore, nuk i kanë ngritur ende këto shërbime, është vlerësuar që fillimisht ky sistem të aplikohet vetëm për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë.

ii) Për Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera, të cilave ligji organik apo i posaçëm, u njeh ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore dhe ngritjen e shërbimeve të policisë gjyqësore, deri në ngritjen e shërbimeve të policisë gjyqësore, sipas parashikimeve të ligjit nr.25/2019, vlerësimi i rezultateve në punë dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore do vazhdojë të kryhet nga institucionet e emërtesës së oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në sistemin e vlerësimit të parashikuar në rregulloret apo aktet nënligjore të këtyre institucioneve.

1.7.2 Në kuadrin e këtij bashkërendimi dhe koordinimi me Komisionin e Policisë Gjyqësore është evidentuar shqetësimi vijues prej 2 vitesh se, në shërbimet e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, nuk janë krijuar “Struktura hetimore”, sipas parashikimeve



në ligjin nr.25/2019 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore’. Kjo gjendje ka ndikuar në ndërprerjen e punës së nisur në bashkëpunim me projektin EURALIUS V për përgatitjen e projektudhëzimit të përgjithshëm “Për funksionimin e policisë gjyqësore”.

🚩 Në përmbushje të detyrave Kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar kërkesën e rezolutës për faktin së është miratuar sistemi i vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të Policisë Gjyqësore me vendimin nr.27/1/2020 të Komisionit, system i cili fillimisht do të aplikohet për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë.

**1.8** Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, *“Të rrisë bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, Policinë e Shtetit, gjykatat dhe institucionet e tjera shtetërore për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare”*, kërkesë që përkon dhe me, - **rekomandimin e KM “Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional”**, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.8.1 Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë po bashkëpunon me INSTAT në kuadër të implementimit të Nomenklaturës Ndërkombëtare të Krimeve për Qëllime Statistike.

i) Me Ministrinë e Drejtësisë vijojmë bashkëpunimin lidhur me procesin e raportimit të të dhënave të harmonizuara për strukturat e Bashkimit Evropian, dhe do të vijojmë të jemi po kështu bashkëpunues në çdo iniciativë për qëllime statistikore, dhe jo vetëm.

1.8.2 Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë aktualisht janë duke punuar për ndërlidhjen e dy programeve kompjuterike ekzistuese (IMPRO dhe M-File), në mënyrë që të gjenerohen të dhëna të përputhshme dhe të ndiqet vijueshmëria e praktikave në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

i) Në zbatim të Planit të Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë<sup>9</sup> të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.409 datë 19.06.2019 dhe në zbatim të Planit të Veprimit ICRG/FATF, që parashikon *“Zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve për prioritizimin e çështjeve të ndihmës së ndërsjellte juridike për të gjitha autoritetet e përfshira deri në pikën që sistemi është funksional”*, mbetet thelbësor vijimi i angazhimit dhe i mbështetjes institucionale të Ministrisë së Drejtësisë për intensifikimin e bashkëpunimi ndërinstitucional brenda afateve që përcakton plani i veprimit për vitin 2021.

<sup>9</sup> Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.409 datë 19.06.2019 Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, i cili në nënobjektivin 5/a: *“Përmirësimi i gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturere”*, tek masa 7, parashikon: *“Masa: 7. Krijimi i kanaleve të sigurtat të komunikimit për shkëmbimin e informacionit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar”, me institucion përgjegjës Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe institucion të përfshirë PP.*

1.8.3 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka ngritur një grup pune, ku janë ftuar dhe marrin pjesë përfaqësues të projektit EURALIUS V, me objekt përmirësimin dhe funksionsimin e sistemit statistikor, sistemit të analizës dhe digjitalizimit të komunikimeve, si dhe po vijon puna për hartimin e një programi statistikor për sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, në pamundësi të vënies plotësisht në funksionim të sistemit CAMS.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, kjo kërkesë e rezolutës dhe rekomandim i KM, është në proces dhe po ndiqet ecuria për zbatimin e tij, për faktin, se po punohet në grupin e punës me përfaqësues të projektit EURALIUS V për përmirësimin dhe funksionsimin e sistemit statistikor dhe sistemit të analizës, si dhe për të siguruar bashkëpunimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë për ndërlidhjen e dy programeve kompjuterike ekzistuese (IMPRO dhe M-File), në zbatim të planit të veprimit ICRG/FATF.

1.9 Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, ***“Të vlerësojë nxjerrjen e një udhëzimi të veçantë me karakter të përgjithshëm me qëllim unifikimin e politikës penale dhe të hetimit të veprave penale në familje, kundër fëmijëve dhe grave dhe krimeve me motive të urrejtjes, bazuar në standardet me të mira ndërkombëtare të fushës, si dhe për mbledhjen, përpunimin e të dhënave për këto vepra penale bazuar në standardet ndërkombëtare të fushës,”***, që përkon, si me kërkesën e rezolutës ***për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve”*** për vitin 2019 dhe sipas planit të veprimit për vitin 2020, më të cilën Kuvendi i kërkon Prokurorit të Përgjithshëm: ***“..të vlerësojë nxjerrjen e udhëzimit me karakter të përgjithshëm për të unifikuar politikën penale dhe hetimin e veprave penale ndaj fëmijëve, veçanërisht rastet e abuzimeve seksuale dhe pornografisë me fëmijët”***, ashtu dhe me rekomandimin e KM ***“Forcimi e respektimi i të drejtave të njeriut”***, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.9.1 Prokuroria e Përgjithshme, në vijim të objektivave të saj dhe në zbatim të rezolutës së Kuvendit, ka analizuar rekomandimet e ekspertëve të GREVIO-s për Shqipërinë dhe me datë 23.12.2020 Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr.17 ***“Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”***, që synon unifikimin e masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm që hetimet dhe ndjekja penale në çështjet për vepra penale kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë urrejtje të jenë, në afate optimale (shpejta), efçente, dhe me kërkesa për masa dënimi efektive, proporcionale e frenuese, që të kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të këtyre formave sensitive të kriminalitetit ndaj viktimave gra.

i) Pjesë e rëndësishme e këtij udhëzimi janë ripërcjellja e parimeve të njohura ndërkombëtarisht, dhënia e përkufizimeve dhe interpretimeve të Konventës së Stambollit dhe doktrinës ndërkombëtare mbi kuptimin dhe format e dhunës ndaj grave, mbledhja e të

dhënave e provave, politika penale, kontrolli i veprimtarisë së policisë gjyqësore, bashkëpunimi ndërinstitucional, trajnimi, si dhe mbledhja e të dhënave për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje për të ndihmuar në analizimin dhe hartimin e politikave parandaluese për këto çështje.

- Në këtë vështrim Prokuroria e Përgjithshme synon të forcojë kuadrin normativ dhe rritjen e kapaciteve profesionale për ndjekje penale efektive, që kontribuon në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të dhunës gjinore dhe dhunës në familje.

1.9.3 Sa i përket kërkesës në rezolutë ***për mbledhjen, përpunimin e të dhënave për këto vepra penale bazuar në standardet ndërkombëtare të fushës kundër dhunës ndaj fëmijëve***, Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr.124, datë 24.09.2020 miratoi krijimin e një regjistri të posaçëm në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, për pasqyrimin e informacionit të çështjeve me të mitur, plotësimin e një kartelesh shoqëruese të dosjes dhe mbajtjen e raportimin periodik të të dhënave statistikore në Prokurorinë e Përgjithshme sipas një modeli të unifikuar.

1.9.4 Në përbushje të funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit, si të udhëzimit nr.5/2018, ashtu dhe të udhëzimit nr.17/2020, në vijimësi ka kërkuar informacion si po respektohet zbatimi i detyrimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga udhëzimet, lidhur me mbrojtjen e viktimave. Respektimi i këtyre detyrimeve është monitoruar në kuadër të raportimeve periodike.

i) Në këtë vështrim, kërkesat e prokurorëve lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer krime seksuale janë të ashpra, ku 94,5 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe vetëm për 5, 5 % është kërkuar caktimi i detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Krahasuar me vitin 2019, ky raport është ndryshuar në drejtim të ashpërsimit të politikës penale të ndjekur, me rritje 0,5 %.

-E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime. Kështu, 89,7 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 10,3 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg. Krahasuar me vitin 2019, ky raport është sërish më i ashpër, pasi ka qenë 80 % burg dhe 20 % alternativa të dënimit me burgim.

ii) Gjithashtu, sa i përket politikës penale në veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të dhënat tregojnë se, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këto vepra janë të ashpra, ku 88 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe për 12% është kërkuar caktimi i detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime rezulton se 63 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 37 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg.

1.9.5 Megjithë përpjekjet dhe angazhimin që kemi marrë, duam të sjellim në vëmendje se janë dy çështje të rëndësishme që lidhen me mbledhjen e të dhënave statistikore në këtë fushë.

-E para, lidhet me qasjen që duhet të kemi ndaj informacionit statistikor. Në mënyrë që të dhënat të shërbejnë për monitorim, analiza e vlerësim të politikave, të dhënat duhet të shkojnë tek motivet. Në këtë drejtim, detyra e mbledhjes së të dhënave nuk duhet të fragmentarizohet te çdo institucion për nevoja të brendshme, por qasja në mbledhjen e përdorimin e këtij informacioni duhet të jetë e harmonizuar dhe multisektoriale, pra në nivel kombëtar.

-E dyta, siç jeni në dijeni, me pasojë të drejtëpërdrejtë në cilësinë e rezultatit, është mungesa e një sistemi të automatizuar funksional.

1.9.6 Shprehje e angazhimit institucional të Prokurorisë së Përgjithshme është edhe tryeza e zhvilluar në datë 9 dhjetor 2020 “Bashkëpunim Ndërinstitucional për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore” me pjesëmarrjen e deputeteve të Kuvendit, përfaqësues të misionit OPDAT dhe koordinatorët e viktimave në prokurori.

i) Ky aktivitet i organizuar në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore shërbeu për të analizuar hapat që ka ndërmarë vendi ynë në vitet e fundit në kuadër të përafrimit të legjislacionit penal material dhe procedural penal, zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore, por edhe për të koordinuar punën mes institucioneve për parandalimin e këtyre fenomeneve.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar kërkesën e rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimin e KM, për faktin se, si udhëzimi i përgjithshëm nr.17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”, me synim unifikimin e politikës penale dhe të hetimit të veprave penale në familje, kundër fëmijëve dhe grave dhe krimeve me motive të urrejtjes, ashtu dhe urdhri nr.124/2020 për krijimin e një regjistri të posaçëm në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm për mbledhjen, përpunimin e të dhënave për këto vepra penale, janë miratuar dhe publikuar, si dhe po zbatohen në sistemin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Gjithashtu, treguesit statistikor evidentojnë se politika penale e kërkesave të prokurorëve ka qenë e ashpër, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe në caktimin e llojit të dënimit ndaj autorëve të veprave penale ndaj fëmijëve, grave dhe familjes, veçanërisht në rastet e abuzimeve seksuale me fëmijët.

**1.10** Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, *“T’u kushtohet vëmendje e veçantë viktimave dhe mbrojtjes së tyre gjatë procedimit penal deri në përfundimin e procesit gjyqësor”*, janë zhvilluar aktivitete dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.10.1 Prokuroria e Përgjithshme, me miratimin e udhëzimit të përgjithshëm nr.17/2020 *“Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”*, ka realizuar, si unifikimin e masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm që hetimet dhe ndjekja penale në

çështjet për vepra penale kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë urrejtje ndaj viktimave gra të jenë, në afate optimale (shpejta), efiente, dhe me kërkesa për masa dënimi efektive, proporcionale e frenuese, ashtu dhe plotësimin e kuadrit nënligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktimën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në vijim të udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

-Gjithashtu, në përmbushje të funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit, si të udhëzimit nr.5/2018, ashtu dhe të udhëzimit nr.17/2020, në vijimësi ka kërkuar informacion si po respektohet zbatimi i detyrimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga udhëzimet, lidhur me mbrojtjen e viktimave. Respektimi i këtyre detyrimeve po monitorohet në kuadër të raportimeve periodike edhe nga prokuroritë e apelit gjatë gjykimit të çështjeve të ankimuar.

1.10.2 Në kuadrin e kujdesit ndaj viktimave, koordinatorët përgjegjës për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm kanë patur në fokus të punës së tyre sigurimin e një asistence sa më eficiente për subjektet e posaçëm, për zgjerimin e bashkëpunimit me OJF-të dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me qëllim referimin e rasteve drejt tyre për marrjen e një shërbimi specifik bazuar në nevojat që viktimat kanë, ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre.

i) Në këtë vështrim, koordinatorët, kanë asistuar në rreth 429 çështje me të mitur dhe 144 çështje lidhur me dhunën në familje. Asistimi ka konsistuar në: - ofrimin e mbështetjes për subjektet me status të posaçëm; -lehtësimin e komunikimit ndërmjet prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore dhe viktimës në situata të rënduara emocionale; -mbështetje psikologjike për viktimën; -njohja me të drejtat për viktimat, orientimi tek ofruesit e shërbimeve kur është e nevojshme etj.

ii) Është krijuar dhe zgjeruar bashkëpunimi me shërbimet që ofrojnë asistencë për subjektet me status të posaçëm. Janë vendosur dhe ruajtur kontakte me këto organizata dhe institucione: -“Terres des Hommes” Shqipëri; -CRCA/ECPAT Shqipëri; -“Të ndryshëm dhe të barabartë”; -Qendra psiko-sociale “Vatra”; -Qendra për “Nisma Ligjore Qytetare”; -Qendra “Lilium”; -Shërbimi Social i Bashkisë Tiranë; -UNICEF; -Shërbimi i Provës.

-Është bashkëpunuar ngushtë në nivel të koordinatorëve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me: -Komisariatit e Policisë; -Shërbimin e Provës; -NJMF (Njësia për mbrojtjen e fëmijëve); -Janë bërë pjesë e Grupit Teknik Ndërsektorial; -OJF që ofrojnë shërbime në rrethet e tyre.

iii) Në kuadrin e forcimit të kapaciteteve profesionale, me ndihmën e projektit OPDAT, janë organizuar pesë tryeza të rrumbullakëta online. Gjatë këtyre aktiviteteve, koordinatorët janë trajnuar mbi tema të ndryshme si: -“Roli i koordinatorit të viktimave e parë nga këndvështrimi i prokurorisë, puna e koordinatorëve në secilën prokurori”; -Takim virtual rajonal midis koordinatorëve të viktimave në Shqipëri dhe ndihmësve të viktimave të krimit në Kosovë; -“Gratë në ushtri”; -“ Dhuna në familje në kontekstin e COVID-19”; -“Krimi i organizuar dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në hetimin e veprave penale”;

- Forcimi i kapaciteteve profesionale të koordinatoreve ka qenë prioritet me synim rritjen e efektivitetit në mbrojtjen e viktimave në procesin penal. Për të përmbushur këtë synim, koordinatorët në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm kanë marrë pjesë në 14 konferenca dhe trajnime në bashkëpunim me organizata të tjera vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

🚦 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar kërkesën e rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimin e KM, për faktin se, udhëzimi i përgjithshëm nr.17/2020 ka plotësuar kuadrin nënligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktimën dhe mbrojtjen e tyre gjatë procedimit penal deri në përfundimin e procesit gjyqësor, në vijim të udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, ashtu sikundër dhe koordinatorët kanë luajtur rol aktiv në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave gjatë procesit penal dhe deri në përfundim të tij.

**1.11** Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, *“Zbatimi i urdhrit penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë duhet të vijojë të njihen dhe të zbatohen më mirë nga prokurorët. Prokuroria duhet t’i kushtojë më shumë kujdes zbatimit të dënimeve alternative dhe respektimit të procedurave të ekzekutimit të vendimeve penale, të forcojë bashkëpunimin me Shërbimin e Provës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve gjatë fazës së procedimit penal dhe ekzekutimit të vendimeve penale”, që përkon me rekomandimin e KM “Forcimi e respektimi i të drejtave të njeriut”-“...rritjen e masave dhe numrit të rasteve të zbatimit të instituteve të reja penale...”, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitete dhe arritur rezultatet si më poshtë:*

1.11.1 Prokuroria e Përgjithshme ka mbikëqyrur nëpërmjet të dhënave statistikore periodike, treguesit në gjykimin e çështjeve në zbatimin e këtyre instituteve, ashtu dhe ka kërkuar informacione për problematikat dhe praktikat e mira të shoqëruara me praktikë gjyqësore sa më të konsoliduar në zbatimin e këtyre instituteve të reja procedurale penale.

i) Referuar të dhënave statistikore për vitin 2020 në prokuroritë pranë Gjykatave me Juridiksion të Përgjithshëm, numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale është për 1402 çështje, me 1413 të pandehur, shifra që zënë 14.05 % të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, duke shkurtuar kështu afatet e hetimit dhe të gjyqimit për këto grup çështjesh.

-Prokurorët kanë kërkuar në gjykatë: -miratimi i urdhrit penal për 410 çështje me 432 pandehur për kundravajtje penale ose me ulje 44,60 % të çështjeve krahasuar me vitin 2019, të cilat kryesisht janë për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët; -miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për 740 çështje me 749 të pandehur ose me rritje 0,82 % të çështjeve krahasuar me vitin 2019, si dhe kanë kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë për 252 çështje me 252 të pandehur ose me rritje 14,55 % të çështjeve krahasuar me vitin 2019.

1.11.2 Në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V, Prokuroria e Përgjithshme, në kuadrin e përgatitjes së udhëzimit të përgjithshëm “Marrëveshja për pranimin e fajësisë”, në muajin qershor 2020 u përgatit analiza e përgjigjeve të pyetësorit nga disa prokurori të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me problematikat dhe nevojat mbi çështje/aspekte thelbësore të zbatimit në praktikë të këtij instituti të ri procedural penal, sidomos rregullimi i aspekteve të propozimit dhe bisedimit të marrëveshjes së fajësisë dhe rolit që duhet të ketë viktima.

i) Në këtë vështrim, me datë 22 korrik 2020 në bashkëpunim me projektin EURALIUS u organizua trajnimi online, me temë “Mbi përvojat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për marrëveshjet për pranimin e fajësisë” me pjesëmarrjen, e ekspertëve ndërkombëtar të disa vendeve (Itali, Kroaci, Bullgari, Gjermani dhe Hollandë) dhe të prokurorëve, si të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe të Prokurorisë së Posaçme, etj.

-Aktualisht po punohet në bashkëpunim me projektin EURALIUS V për përgatitjen e projektudhëzimit të përgjithshëm “Për marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit”

✚ Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar pjesërisht këtë kërkesë të rezolutës, për aplikimin e instituteve të reja procedurale penale me tregues statistikorë, në shifra pothuajse të njëjta për dy institute, dhe rënien ndjeshëm tek urdhri penal, krahasuar me vitin 2020.

✚ Në vijim të zbatimit të këtij prioriteti për treguesin në ulje të urdhrin penal do kërkohet nga drejtuesit e prokurorive për të analizuar shkaqet e rënies të zbatimit të tij dhe marrjen e masave sipas ligjit dhe këtij rekomandimi për rritjen e aplikimit të instituteve të reja procedurale penale për vitin 2021.

**1.12** Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, **“Të miratojë udhëzimin për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për luftimin e kriminalitetit”**, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitete dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.12.1 Prokurori i Përgjithshëm, në datë 20.07.2020, miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr.11 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” me synim ndjekjen e unifikuar të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet masave administrative dhe procedurale të përcaktuara për drejtuesit dhe prokurorët e juridiksionit të përgjithshëm dhe urdhrin nr.112, datë 27.07.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”. Këto akte u janë dërguar me shkresën nr.968/4, datë 27.07.2020 të gjithë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe është mbikëqyrur dhe po mbikëqyret zbatimi i tyre.



🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë kërkesë të rezolutës të Kuvendit, për faktin se është miratuar udhëzimi i përgjithshëm nr.11/2020 për rekomandimet prioritare të KM në luftën kundër kriminalitetit. Për më tepër, me urdhrin nr.112/2020 është miratuar dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve prioritare të KM.

**1.13** Në zbatim të kërkesës në Rezolutën e Kuvendit, ***“Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë duhet të bazohet në manualin e raportimit, i miratuar me vendimin nr.134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, me fokus të veçantë pasqyrimin e detajuar të gjendjes së kriminalitetit, tendencat e tij, efektivitetin e ndjekjes penale, politikat penale, faktorët kriminogjenë të evidentuar gjatë hetimit penal”***, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

1.13.1 Në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës, Prokuroria e Përgjithshme i kërkoj projektit EURALIUS V të mundësojë sigurimin e informacionit mbi standardet dhe/ose praktikatat e mira Evropiane, sa i përket raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vendet e BE-së, me synim paraqitjen e këtij raporti në standard evropian në zbatimin e kërkesës në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë.

i) Në dokumentin “Shënim: Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi kriminalitetin” datë 10.11.2020 të ekspertëve të EURALIUS-it V, në Kreun III “Analizë e standardeve dhe praktikave evropiane” është parashtruar: *“Ekspertët e EURALIUS-it studiuuan dokumente nga CCPE-ja, Komisioni i Venecias, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Prokurorinë. Rezultati është “i dobët”: ... Prandaj mund të konkludohet se nuk ka asnjë standard evropian në lidhje me përmbajtjen e raportimit nga Prokurori i Përgjithshëm në Kuvend. Standardi i vetëm është përgjegjësia publike e shërbimit të prokurorisë (si çdo autoritet shtetëror) që çon në një formë raportimi.*

*... Dallimet mund të gjurmohen në vendin e shërbimit të prokurorisë në sistemin shtetëror: në disa vende shërbimi i prokurorisë është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, në vendet e tjera është një institucion i pavarur; në disa vende përgjegjshmëria kontrollohet nga ekzekutivi, në vendet e tjera kontrollohet nga një këshill prokurorial. Në çdo rast nuk mund të konkludohet se ekziston një praktikë evropiane për sa i përket përmbajtjes së raportimit nga Prokurori i Përgjithshëm në Kuvend.”*

ii) Në këtë vështrim, në përmbushje të kësaj kërkesë të rezolutës, Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë, është hartuar mbështetur në nenin 148/b të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 104 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe është bazuar e do të vijojë të bazohet në pikën 3 e vijues të Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik, i miratuar me vendimin nr.134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, me fokus pasqyrimin, -niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit, ku përfshihet, -respektimi/plotësimi i rekomandimeve të “Progresa-raportit të BE-së për Shqipërinë” dhe/ose -plotësimi i detyrimeve të tjera



ndërkombëtare, -zbatimi i rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën ndaj kriminalitetit, -udhëzimet e përgjithshme dhe aktet normative të nxjera për zbatimin e rekomandimeve, monitorimi i zbatimit të tyre nga ana e prokurorëve dhe efektet që kanë sjellë, -gjendja e kriminalitetit, -tendencat e tij, -efektivitetin e ndjekjes penale, -politikat penale dhe -faktorët e mundshëm kriminogjenë të evidentuar gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, të pasqyruara në përmbajtjen e këtij Raporti.

🚩 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë kërkesë të rezolutës së Kuvendit, për faktin se në hartimin e Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm objekt shqyrtimi, referuar veçorive të organizimit, funksionimit dhe kompetencave institucionale, në raport janë trajtuar mbështetja kushtetuese e ligjore dhe në manualin e monitorimit të miratuar me vendimin nr.134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë.

### *Angazhime për zbatimin e rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë*

1.14.1 Aktivitete në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë ku është përfshirë Prokuroria e Përgjithshme, janë:

i) Prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale, është angazhuar në bashkëpunimin, me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në dhënien e kontributit dhe progresit institucional në përmbushje të rekomandimeve të progresraportit të BE-së për Shqipërinë dhe në progres raportin për zbatimin e planit të veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë.

-Përgatitur dhe dërguar në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) kontributi/progresi institucional “Mbi zhvillimin e takimit të 12-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri, “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, si dhe jemi përfaqësuar në Grupin Ndërinstitucional në takimin online të zhvilluar me delegacionin e BE-së në datat 30 qershor - 1 korrik 2020;

-Përgatitur dhe dërguar MEPJ kontributin/progresin institucional “Mbi takimin e 11-të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, datë 9 dhjetor 2020”, si dhe jemi përfaqësuar në Grupin Ndërinstitucional në takimin online të zhvilluar me delegacionin e BE-së.

1.14.2 Aktivitetet dhe masat në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve Moneyval dhe planit të veprimit FATF/ICRG, ku është përfshirë Prokuroria e Përgjithshme, janë:

ii) Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe planin e veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë, siç e parashtroam më sipër edhe në zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit. Në bashkërendim dhe koordinim me pikat e kontaktit në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, në dinamikë është marrë informacion për ecurinë e rezultateteve të arritura, dhe është informuar/raportuar në strukturën Moneyval pranë KM dhe/ose DPPPP në mënyrë periodike përgjatë vitit 2020, për progresin e masave administrative dhe

procedurale, dhe ndikimin e tyre në rritjen e numrit të procedimeve apo të pandehurve të regjistruar dhe rritjen e numrit të dënuarve krahasuar me vitin 2019.

-Përgatitur dhe dërguar materialet përkatëse në kuadrin e raportprogresit në dy mbledhjet online të Grupit Ndërinstitucional të Punës për zbatimin e Planit të Veprimit të FATF/ICRG, drejtuar nga Zv/Kryeministri, në prill dhe nëntor 2020.

-Gjithashtu, përgatitur kontributin/progresin institucional për raportprogresin në zbatimin e planit të veprimit të FATF/ICRG për Shqipërinë dhe jemi përfaqësuar në përbërje të Grupit Ndërinstitucional në dy takimet online të zhvilluara me ekspertët e ICRG/FATF-në në korrik 2020 dhe janar 2021.

🚦 Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, në vështirimin institucional të prokurorisë, i konsiderojmë të zbatuara për vitin 2020 rekomandimet për progresraportin e BE-së për Shqipërinë dhe masat për progresraportin në zbatim të planit të veprimit të ICRG/FATF për Shqipërinë, si dhe vijon angazhimi institucional i Prokurorisë së Përgjithshme për rritjen e progresit të mëtejshëm në zbatimin e rekomandimeve të BE-Së dhe masave të planit të veprimit të ICRG/FATF për vitin 2021.

### ***Kontributi për reformimin e kuadrit ligjor në Kuvendin e Shqipërisë***

1.15 Marrëdhëniet e Prokurorisë së Përgjithshme me Kuvendin e Shqipërisë janë në raporte bashkëpunimi për përmirësimin e projektligjeve objekt shqyrtimi në komisione.

i) Përgjatë vitit 2020 në kuadrin e kontributit gjithëpërfshirës për reformën ligjore në sistemin e drejtësisë penale dhe në fushën e zgjedhjeve, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme kanë dhënë kontribute në vështirimin institucional të prokurorisë, për disa projektligje, me synim përfaqesjen e tyre me kode e ligje, për përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet dhënies së opinionëve institucionale dhe/ose duke u përfshirë në grupe pune në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ndër të cilët mund të veçojmë:

- Projektligji “Për ndryshime e shtesa në Kodin Penal”;
- Projektligji “Për ndryshime e shtesa në Kodin e Procedurës Penale”;
- Projektligji “Për disa shtesa në ligjin 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Projektligji “Për ndryshime e shtesa në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”;
- Projektligji “Për ndryshime e shtesa në ligjin 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera ndëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
- Projektligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Projektligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”;
- Projektligji “Për policinë e burgjeve”;
- Projektligji “Për dhënie amnistie”;

-Projektligji “Për amnistinë fiskale e penale për subjektet që bëjnë deklarinimin vullnetar të pasurive”;

Etj.

## **2. Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”**

Në zbatim të nenit 103 pika 3, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Rekomandimet Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” të miratuara me vendimin Nr. 501 datë 24.06.2020<sup>10</sup> të Këshillit të Ministrave (në vijim rekomandimet e KM), ju bënë të njohura nga Ministri i Drejtësisë drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të të gjithë niveleve, në një mbledhje të përbashkët të organizuar online në datë 02.07.2020.

**2.1** Prokurori i Përgjithshëm, në cilësinë e autoritetit që kujdeset për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë<sup>11</sup>, në kuadrin e zbatimit si të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020, ashtu dhe zbatimit të rekomandimeve të KM, në datë 24.06.2020, miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr.11 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me synim ndjekjen e unifikuar të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet masave administrative dhe procedurale të përcaktuara për drejtuesit dhe prokurorët në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, ku janë parashikuar:

2.1.1 Masa administrative që duhen marrë sipas ligjit nga drejtuesit e prokurorive për nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimit e një planveprimi për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare, në përputhje me specifikat dhe gjendjen e prokurorisë përkatëse;

2.1.2 Masa në drejtim të riorganizimit të brendshëm, koordinimit dhe forcimit e kapaciteteve institucionale dhe profesionale;

2.1.3 Masa procedurale që duhen marrë sipas ligjit nga drejtuesit e prokurorive në fazën e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzave/çështjeve në gjykim, siç janë:

i) nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete;

<sup>10</sup> Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.501, datë 24.06.2020 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” publikuar në Fletoren Zyrtare nr.121, datë 30.06.2020 dhe gjendet në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/121/114c61bf-71a3-46b6-9a5f-d09d63068fa3>.

<sup>11</sup> Shih, neni 38 pikën 2 shkronja “f” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh” që parashikon: “2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: f) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore e kushtetuese të prokurorisë.”

ii) koordinimi i veprimtarisë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara;

iii) kërkimi i informacionit dhe verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të procedimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;

iv) verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, në veçanti, afatet procedurale, rritja e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve, si dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal;

v) zhvillimi i mbledhjeve tematike me prokurorët e seksioneve dhe/ose me prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;

vi) nxjerrja e urdhrave për policinë gjyqësore që kanë në juridiksion lidhur me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në ushtrimin e funksioneve në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara;

vii) mbështetje për prokurorët në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet menaxhimit të duhur të burimeve njerëzore dhe logjistikës në dispozicion, si dhe për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë për të Mitur për të siguruar aksesin për persona me paaftësi fizike dhe pritjen e publikut, sipas prioriteteve të rekomanduara;

viii) bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe organizimi dhe zhvillimi i analizave të përbashkëta ndërinsticionale në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara;

ix) koordinimi dhe organizimi i trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat e rekomanduara.

2.1.4 Masa procedurale që duhen marrë nga prokurorët lidhur me rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit, për rritjen e efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit sipas prioriteteve të rekomanduara, duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim të paligjshëm në vendimarrjen e tyre, si:

i) kryerja e hetimeve të plota e të gjithanshme për veprat penale prioritare të rekomanduara, me anë të hetimeve proaktive efektive, përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimeve financiare/pasurore, për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve prodhuese të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

ii) lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale, për vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale, me synim për të parandaluar dhe riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale prioritare të rekomanduara; përdorimi i bazave të të dhënave të institucioneve ligjzbatuese të tjera ku prokuroria ka akses për rritjen e efikasitetit të hetimit;

iii) bashkërendimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse ose të agjencive ligjzbatuese, për përmirësimin e ecurisë së hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;

iv) ruajtja e sekretit të hetimit dhe ndalimi i publikimit të akteve në luftën kundër krimeve të rënda prioritare të rekomanduara;

v) zbatimi i udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, përfshirë dhe udhëzimi i përgjithshëm nr.5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale” sipas fushave/drejtimeve prioritare të rekomanduara;

vi) zbatimi efektiv i të drejtave të pandehurve, personave nën hetim apo të dyshuarve, ashtu dhe të viktimave, për veprat penale prioritare të rekomanduara;

vii) ndjekja e një politike penale të kujdesshme, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në aktet/kërkesat/konkluzionet procedurale, për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht ato të keqtrajtimit të të miturit dhe dhunës në familje dhe krimeve seksuale;

viii) rritja e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime dhe në tryeza diskutimesh me fokus në fushat prioritare të rekomanduara.

2.1.5 Në datë 27.07.2020, Prokurori i Përgjithshëm miratoi urdhrin nr.112 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”.

2.1.6 Këto akte u dërguan për njohje e zbatim në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me shkresën nr.968/4, datë 27.07.2020 të Prokurorisë së Përgjithshme.

**2.2** Prokurori i Përgjithshëm, me shkresat nr. 968/5 prot., datë 2.10.2020 dhe me datë 14.01.2021 i ka kërkuar informacion drejtuesve të të gjithë niveleve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, për ecurinë e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.11/2020 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr.112/2020 në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve prioritare të KM, të shoqëruar me tregues statistikor lidhur me të dhënat për numrin, llojet, intensitetin dhe format e kriminalitetit përgjatë vitit 2020, dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, rezultatet dhe problematikat në zbatimin e tyre.

-Përveç sa u trajtua më sipër lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, ku përfshihet dhe zbatimi i disa rekomandimeve prioritare të KM, gjejmë me vend që t’ju informojmë për masat e tjera të marra dhe progresin në përmbushjen e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit Ministrave përgjatë vitit 2020, sipas drejtimeve ku fokusohen, si më poshtë:

***Lidhur me rekomandimin: Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit.***

1 Prokurori i Përgjithshëm, ndërmori një proces gjithëpërfshirës diskutimi lidhur me udhëzimin nr.8/2019, “Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, të pezulluar në dhjetor 2019.

i) Në përfundim të këtij procesi, në datë 20.07.2020 Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr.12, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në

prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm është garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në raport me detyrueshmërinë e ndjekjes penale, përcaktimi i raporteve prokuror - prokuror më i lartë, si dhe mënyra e informimit në të gjitha hallkat dhe nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

ii) Gjithashtu, me synim për të garantuar pavarësinë e prokurorit dhe shmangur çdo keqinterpretim në zbatimin e disa paragrafëve të neneve të udhëzimit ku trajtohen marrëdhëniet mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive lidhur me informimin mbi ecurinë e procedimit, në datë 14.12.2020 Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr.16 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

2. Sa i përket rritjes së rolit të prokurorit në drejtimin e policisë gjyqësore dhe kontrollin e hetimeve paraprake, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të llogaridhënies së strukturave të policisë gjyqësore, kjo çështje është trajtuar në aktet nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe aktet e përbashkëta me institucionet e tjera.

i) Në këtë vështrim, bashkërendimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së policisë gjyqësore, kryerja e analizave të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse ose të agjencive ligjzbatuese, është normuar, si në udhëzimin nr.11/2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, për përmirësimin e ecurisë së hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, ashtu edhe në udhëzimin nr.10/2020 “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale”, që ka për qëllim ndër të tjera të normojë dhe unifikojë masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, për rritjen e efektivitetit në hetimet pasurore dhe financiare për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale.

ii) Udhëzimi i përgjithshëm 10/2020 ka krijuar korniza për ngritjen e seksioneve të veçanta në prokuroritë vendore, rritjen e kapaciteteve në seksionet e veçanta në drejtoritë e policisë vendore, forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, të cilëve u janë besuar trajtimi i rasteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe është përmirësuar efikasiteti dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel vendor dhe qendror.

iii) Memorandumi i Mirëkuptimit, i nënshkruar me datë 30 shtator 2020, mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për mënyrën e trajtimit të një pjese të materialeve kallëzuese, i shoqëruar me udhëzimin e përgjithshëm nr.15/2020 “Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale”, që hyri në fuqi këtë fillimviti, i jep

zgjdhje një problemi të mbartur prej vitesh, lidhur me cilësinë e materialeve referuese nga shërbimet e policisë gjyqësore në strukturat e Policisë e Shtetit.

3. Aspekt i rëndësishëm në forcimin e llogaridhënies konsiderohet nga ana jonë dhe vlerësimi i punës së oficerëve të policisë gjyqësore, i lidhur dhe me marrëdhëniet funksionale të tyre në vartësi të prokurorit. Në këtë drejtim Prokurori i Përgjithshëm ka nxitur, mbështetur dhe asistuar Komisionin e Policisë Gjyqësore për miratimin e rregullore për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin e oficerëve të Policisë Gjyqësore, e miratuar me vendimin nr.27/1 datë 30.10.2020 të këtij Komisioni.

4. Rritja profesionale, krahas detyrimit ligjor për prokurorët, është vlerësuar si domosdoshmëri nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, për forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm. Në të njëjtin drejtim shkojnë edhe objektivat lidhur me policinë gjyqësore, ku po punohet dhe në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore për të finalizuar kuadrin normativ për trajnimin fillestar dhe atë vazhdues të tyre.

i) Në udhëzimin e përgjithshëm nr.11/2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, drejtuesit e prokurorive udhëzohen të koordinojnë, organizojnë trajnime të përbashkëta, dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në to, ashtu dhe prokurorëve u kërkohet të synojnë rritjen e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime dhe në tryeza diskutimesh.

ii) Veç sa më sipër, Prokuroria e Përgjithshme ka nxitur bashkëpunimin me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe ka kontribuar për të finalizuar në dhjetor 2020 projektregulloren “Për caktimin e rregullave për trajnimin fillestar për hetimin, e personave të përzgjedhur si oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore”, i miratuar nga ky Komision në janar 2021. Kjo rregullore ka përcaktuar rregullat për organizimin e trajnimit fillestar që duhet të kryejnë të emëruarit rishtas si oficerë të policisë gjyqësore në seksionet e prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Shërbimet e Policisë Gjyqësore të institucioneve të tjera shtetërore që kanë atributet e policisë gjyqësore.

✚ Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar të KM, për faktin se janë realizuar masat dhe aktivitetet më sipër në zbatim të këtij rekomandimi, krahas masave dhe aktiviteteve të realizuara në zbatim të Rezolutës së Kuvendit, ku përkojnë dhe përfshihen edhe masat/aktivitetet lidhur me zbatimin e rekomandimit për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit.

🚩 Lidhur me këtë rekomandim, ju sjellim në vëmendje se, **garantimi i pavarësisë së prokurorëve** është në kompetencën e KLP. Kjo, referuar si nenit 149 pika 1<sup>12</sup> të Kushtetutës në lidhje me ligjet nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve...” dhe ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ashtu dhe neneve 103, 104 pika 2 e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...” dhe pikës 32 të nenit 6 të ligjit nr.8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (i ndryshuar), ku parashikohet se, *në kompetencë të Këshillit të Ministrave nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë është përgatitja dhe përcjellja Prokurorit të Përgjithshëm i rekomandimet prioritare për luftën kundër kriminalitetit që duhen ndjekur për vitin në vazhdim, për zbatimin e të cilëve (rekomandimeve) informohet Kuvendi i Shqipërisë.*

-Në këtë vështrim vlerësojmë se, në rekomandimet prioritare të KM për luftën kundër kriminalitetit të rivlerësohet përfshirja e rekomandimeve që garantojnë pavarësinë e prokurorit, dhe jo vetëm, të cilët janë në kompetencë vlerësimi dhe monitorimi të KLP-së si organi qeverisës i sistemit të prokurorisë.

-Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme ka dhënë kontribut në këtë drejtim, duke marrë masat e duhura administrative dhe procedurale përmes nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme dhe miratimit të ndryshimeve në rregulloren standard në lidhje me seksionet në prokurori, për garantimin e pavarësisë të prokurorëve.

### ***Lidhur me rekomandimet: Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar***

1. Në lidhje me rekomandimet për luftën kundër korrupsionit dhe luftën kundër krimit të organizuar, ashtu siç trajtohet dhe në pjesën shtjelluese të këtyre rekomandimeve, referuar kompetencës lëndore që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, evidentojmë se, për vitin 2020 rritja e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar, që përfshin këto grup veprash, janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme, në bashkëpunim, si me institucionet e reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK), ashtu dhe me agjencitë e tjera të specializuara ligjzbatuese përkatëse.

i), Në këto rrethana të reja ligjore dhe për këto arsye, Prokuroria e Përgjithshme me marrjen nga Ministria e Drejtësisë të Rekomandimeve Prioritare të miratuara me vendimin e KM nr.501, datë 24.06.2020<sup>13</sup> të KM, ia ka përcjellë një kopje të këtyre Rekomandimeve Prokurorisë së Posaçme të Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

🚩 Referuar kësaj problematike të krijuar nga boshllëku ligjor që evidentohet në nenin 103 pika 1 e ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në

<sup>12</sup> Kushtetuta në nenin 149 pika 1 parashikon: “I.Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>13</sup> Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.501, datë 24.06.2020 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” publikuar në Fletoren Zyrtare nr.121, datë 30.06.2020 dhe gjendet në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/121/114c61bf-71a3-46b6-9a5f-d09d63068fa3>.



Republikën e Shqipërisë”, kemi vlerësuar dhe i kemi kërkuar Ministrisë së Drejtësisë inicimin/propozimin nga ana saj të ndryshimeve ligjore për plotësimin e këtij neni (103 pika 1), me synim që në vitin në vazhdim rekomandimet e KM për veprat penale të korrupsionit dhe krimin e organizuar sipas kompetencës lëndore t’i përcillen drejtpërsëdrejti Prokurorisë së Posaçme.

2. Në këtë vështrim, ashtu siç është trajtuar lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e masave për forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme dhe për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale për veprat në detyrë, përfshi dhe në fushën e korrupsionit, në datë 15.12.2020, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nënshkruan Aktin e Koordinimit Institucional “Për rritjen e efikasitetit nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, me Prokurorinë e Posaçme, dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstytucionale,...”, me anë të komunikimeve të drejtpërdrejta në nivel qendror dhe në nivel rrethi gjyqësor, ndërmjet drejtuesve të prokurorive përkatëse sipas objektit të përcaktuar në këtë akt koordinimi.

i) Për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit dhe prioritetëve në luftën kundër tij, përfshi veprat penale që lidhen me detyrën dhe ato korruptive, në këndvështrimin e Prokurorisë së Përgjithshme është konsideruar domosdoshmëri një qasje e përbashkët dhe e unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë, si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, ashtu dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel qendror.

ii) Në këtë vështrim, janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me: - Kontrollin e Lartë të Shtetit, -Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, -Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, -Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku përfshihen dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen dhe me veprat penale të fushës së krimeve financiare, shpërdorimit të fondeve publike, dhe në fushën e veprimtarisë së ILDKPKI-së.

3. Sa i përket përmirësimit të statistikave, sistemi CAMS nuk është ende funksional. Aktualisht, në bashkëpunim me ekspertët e EURALIUS V po vlerësohet analiza teknike e CAMS e kryer nga eksperti i pavarur i caktuar nga Euralius, nëse dhe në ç’masë një investim i mëtejshëm në këtë program është rentabël dhe/ose mund ta bëjë atë funksional apo duhet një sistem i ri për administrimin e çështjeve në prokurori.

**Lidhur me rekomandimin: Forcimi e respektimi i të drejtave të njeriut.**

1. Lidhur me rekomandimin “...*për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale lidhur me veprën penale të dhunës në familje...*” Prokuroria e Përgjithshme ka marrë masa e nevojshme administrative dhe procedurale me miratimin e udhëzimit të përgjithshëm nr.17/2020 dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe të udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2018, nëpërmjet kërkesave për informacion në kuadrin e kujdesit për ushtrimin e kompetencave Kushtetuese e ligjore nga drejtuesit dhe prokurorët, duke garantuar pavarësinë e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre.

i) Referuar të dhënave statistikore, pesha specifike që zë “Dhuna në familje” neni 130/a i Kodit Penal në grupveprat “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2020 është 92,53 %, ndërsa në vitin 2019 pesha e kësaj vepre rezultoi në masën 92,01 % ose me tendencë në rritje 0,5 %.

-Sipas të dhënave statistikore, për këtë veprë penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, në vitin 2020 janë regjistruar 1251 procedime penale, me 1173 të pandehur ose me tendencë në rritje 9,74 % të procedimeve dhe 8,8 % të pandehurve të regjistruar. Janë dërguar për gjykim 914 % procedime me 979 të pandehur, ose me rritje 8,75 % të procedimeve dhe 9,3 % e të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2019.

ii) Efektiviteti i ndjekjes penale ka qenë i lartë edhe lidhur me veprën penale të dhunës në familje, ku evidentohet se çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 83 % dërguar gjyqit dhe 17 % të pushuara.

iii) Sa i përket politikës penale në veprën penale “Dhuna në familje” sipas nenit 130/a i Kodit Penal, të dhënave statistikore evidentojnë se, kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këtë veprë janë të ashpra, ku 88 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe për 12 % është kërkuar caktimi i detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, ose me rritje 2 % masat e sigurimit personal arrest krahasuar me vitin 2019. Në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këtë veprë penale rezultojnë se 63,7 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 36,7 % të kërkesave janë për caktimin e alternativave të dënimit me burg ose me rritje 3,7 % të kërkesave për caktim e llojit të dënimit me burgim, krahasuar me vitin 2019.

iv) Në këtë vështrim mund të theksojmë që mbetet serish konstatimi i vjetshëm se duhet bërë më shumë dhe në aspektin parandalues të kësaj vepre penale, duke nisur që me edukimin e shoqërisë në moshë të hershme, ndërgjegjësimin e grupeve vunerabël për të drejtat e tyre dhe lehtësimin e aksesit në institucionet ligjzbatuese e në drejtësi.

2. Sa i përket rekomandimit “...*lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit dhe zbatimin efektiv në praktik të tyre... rritja e numrit dhe cilësisë së hetimeve për këto vepra...*”, gjatë vitit 2020 në kuadrin e ndryshimeve të reja ligjore në Kodin Penal për veprat penale në fushën e mjedisit, referuar të dhënave statistikore, për grup veprat penale kundër mjedisit, evidentohet se, pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,19 %, ndërkohë që për vitin 2019 është 0,87 %. Pra, vihet re rritje 0,3 % e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2020.

-Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 11,63, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 9,29 ose me rritje 2,3 %.

ii) Sipas treguesve të të dhënave statistikore rezulton se, për këto grup veprash penale në vitin 2020 janë regjistruar 331 procedime me 144 të pandehur, ose me rritje 24,4 % të numrit të procedimeve dhe 19 % të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2019, tregues që evidenton rritjen e treguesve në fazën e hetimeve për këto grup veprash. Ndërkohë, numri i procedimeve penale dhe i të pandehurve të dërguar në gjyq dhe të dënuar janë në shifra pothuaj se të njëjta krahasuar me vitin 2020, tregues me efekt ndikimi dhe nga gjendja e pandemisë Covit 19.

3. Në zbatim të rekomandimit “...vijimi i hetimeve të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të udhëzimit përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve”, ka marrë dhe po merr masat e duhura organizative dhe proceduriale, në përfaqje dhe me ndryshimet e reja ligjore të Kodit Zgjedhor me ligjin 118/2020, ashtu dhe me ndryshimet në ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH” me ligjin nr.184/2020, me synim unifikimin e masave në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore të vitit 2021.

i) Referuar të dhënave statistikore për vitin 2020 evidentohen të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve<sup>14</sup>”. Siç vërehet nga të dhënat, gjatë vitit 2020 janë regjistruar 5 procedime penale me 1 të pandehur dhe 1 i pandehur është dënuar.

### **Lidhur me rekomandimin: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional**

1. Për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit, në këndvështrimin e Prokurorisë së Përgjithshme është konsideruar domosdoshmëri një qasje e përbashkët dhe e unifikuar ndërmjet institucionave ligjzbatuese. Për këtë qëllim, gjatë kësaj periudhe, Prokuroria e Përgjithshme një vëmendje të veçantë i ka kushtuar, si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, ashtu dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror. Në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe është synuar jo shprehja formale e vullnetit, por marrja e masave konkrete për rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe/ose referimeve në prokurori, inicimi i rasteve për kryerjen e hetimeve proaktive, nxjerrja e metodikave hetimore, vendosja e kontakteve dhe zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve profesionale, masa që çmojmë se do të japin rezultate të prekshme në arritjen e objektivave të përbashkët ndërinstitucionale.

<sup>14</sup> Veçuar nga ky grup veprat penale të korrupsionit në zgjedhje dhe trajtuar në grupveprat penale të korrupsionit

2. Lidhur me trajnimet e përbashkëta, siç e trajtuam edhe më sipër, në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V dhe Projektin PAMECA V kemi realizuar disa trajnime me pjesëmarrje të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, oficerë të Policisë së Shtetit, strukturave hetimore të doganave dhe tatimeve, inspektorë të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Shërbimit të Çështjeve të Brendshme në Ministrinë e Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit në fushat përkatëse.

3. Në kuadrin e masave për përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërinstitucionale me institucionet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, me synim rritjen e cilësisë së referimeve/kallëzimeve dhe efektivitetin e hetimeve për veprat penale në fushën e veprimtarisë së tyre, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me institucionet e përfshira, përgjatë vitit 2020 janë përgatitur dhe janë miratuar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm me drejtuesit e institucioneve MB e MFE, KLSH, ILDKPKI, DPPSH, DPB, SPAK, ILD, etj.

i) Në këto marrëveshje janë përcaktuar objektet dhe fushat e veprimit, si dhe kontributet institucionale dhe caktimi i pikave të kontaktit në nivel qendror dhe/ose vendor për shkëmbimin e informacionit, shmangien e problematikave që mund të dalin gjatë procesit të zbatimit të secilës marrëveshje dhe rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin institucional.

ii) Kjo frymë dhe vullneti i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional në nivel qendror me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese të përfshira ka ndikuar në rritjen e cilësisë së bashkëpunimit në nivel vendor veçanërisht me shërbimet e policisë gjyqësore në komisariate dhe DV të Policisë së Shtetit dhe me Prokurorinë e Posaçme.

4. Në zbatimin të Strategjive dhe Planeve të Veprimit ndërinstitucionale për aktivitete brenda vendit dhe me institucionet ndërkombëtare dhe rajonale ku është përfshirë prokuroria, Prokuroria e Përgjithshme periodikisht ka përgatitur informacionet/materialet lidhur me progresin institucional të prokurorisë në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SNSD), Strategjisë Kundër Korrupsionit (SNKK), Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, dhe Strategjisë Kundër Armëve të Vogla e të Lehta (SKAVL), si dhe i ka dërguar institucioneve përkatëse përgjegjëse (Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme) informacione për zbatimin e tyre.

5. Në kuadrin e reformës ligjore dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP-i), mbi kërkesat e tyre për dhënie mendimi/opinionit për projektligje apo projektakte nënligjore, Prokuroria e Përgjithshme bazuar në kërkimet, analizat dhe vlerësimet ligjore në fushat përkatëse, me synim përfaqësimin

e tyre me Kushtetutën e ligjet, dhe qartësimin e formulimit të tyre, në vështtrimin institucional të prokurorisë ka përgatitur dhënie mendimi/opinionit dhe/ose sugjerime për ndryshime apo plotësime të nevojshme, prej të cilëve projektligje dhe projektvendime të KM dhe projektregullore të ardhura për mendim, ku mund të përmendim: -projektligje dhe projektvendime të KM të ardhura nga Ministria e Drejtësisë; -projektligje dhe projektvendime të KM të ardhura nga Ministria e Brendshme, -projektligje dhe projektvendim i KM të ardhura nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe nga një projektakt normativ të ardhura nga KLP, KPGJ dhe AKEP-i.

### **3. Aktet normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre.**

3.1. Prokurori i Përgjithshëm, në zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, dhe jo vetëm, ashtu dhe në kuadrin e implementimit të reformës ligjore në sistemin e prokurorisë, me synim për të normuar veprimtarinë administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2020, ka vlerësuar detyrimet dhe nevojat për nxjerrjen e akteve të reja normative dhe/ose ndryshime/plotësime të tyre, dhe ka miratuar aktet normative, të cilët janë, udhëzime të përgjithshme, urdhëra për miratimin e rregulloreve ose planeve të veprimit, etj, ndër të cilët mund të veçojmë, si vijojnë:

#### 3.1.1 Udhëzimet e Përgjithshme të miratuara nga Prokurori Përgjithshëm:

- ✓ “Për një shtesë në udhëzimin nr.3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, miratuar me nr.1, datë 31.01.2020;
- ✓ “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”, miratuar me nr.2, datë 10.03.2020;
- ✓ “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes COVID-19”, miratuar me nr.3, datë 19.03.2020;
- ✓ “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19” miratuar me nr.4, datë 24.03.2020;
- ✓ “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”, miratuar me nr.5, datë 08.04.2020;
- ✓ “Mbi masat procedurale dhe administrative në veprimtarinë funksionale dhe mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së COVID-19”, miratuar me nr.6, datë 27.04.2020;
- ✓ “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”, me nr.7, datë 13.05.2020;
- ✓ “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, miratuar me nr.8, datë 19.05.2020;

- ✓ “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimin financiar, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale”, miratuar me nr.10, datë 17.07.2020, për krijimin e seksioneve të posaçme në prokurori dhe në strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese të tjera dhe rritjen/forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në procedurat standarde në veprimtarinë hetimore, polici/agjenci të tjera ligjzbatuese – prokurori;
- ✓ “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, miratuar me nr.11, datë 20.07.2020;
- ✓ “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, miratuar me nr.12, datë 20.07.2020;
- ✓ “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”, miratuar me nr.14 datë 21.09.2020;
- ✓ “Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale”, miratuar me nr.15, datë 30.10.2020;
- ✓ “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, miratuar me nr.16, datë 14.12.2020,;
- ✓ “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje”, miratuar me nr.17, datë 23.12.2020,;
- ✓ “Për masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit nga struktura e posaçme në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë”, miratuar me nr.18, datë 31.12.2020

### 3.1.2 Rregulloret e miratuara me urdhëra të Prokurorit të Përgjithshëm:

- Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, miratuar me urdhërin nr.136, datë 28.12.2020;
- Rregullore ”Për disa shtesa në rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë me Juridiksion të Përgjithshëm” e miratuar me urdhërin nr.120, datë 08.09.2020;
- Rregulloret “Standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apeleve me juridiksion të përgjithshëm”, miratuar me urdhërin nr.164, datë 18.12.2020;
- Rregullore ”Për përcaktimin e formës së regjistrimit dhe mënyrën e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore të çështjeve me të mitur në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm” miratuar me urdhërin nr.124, datë 24.09.2020,
- Etj.

## 3.1.3 Plane veprimi të miratuar me urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm:

- Plani i Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019”, miratuar me urdhrin nr.103 datë 17.07.2020;
- Plani i Veprimit -Për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”, miratuar me urdhrin nr.112, datë 27.07.2020;
- Etj.

3.2 Këto akte normative janë nxjerrë në mbështetje dhe zbatim të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore. Kundër një udhëzimi të përgjithshëm dhe udhëzimit që e ka ndryshuar<sup>15</sup> atë, sipas ligjit<sup>16</sup> është ushtruar ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga një prokuror në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përfundim të shqyrtimit të ankimit, me vendimin nr.59 datë 18.03.2021<sup>17</sup> ka vendosur: *Rrëzimin si të pabazuar në ligj të dy kërkesave në ankimin e prokurorit...*, duke arsyetuar se “...ky udhëzim... i përmbahet në mënyrë korrekte parashikimeve Kushtetuese dhe atyre ligjore...”.

3.3 Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” e Kushtetutës, neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, “c”, “f”, 104 pika 2 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara dhe efektivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale në fushat përkatëse, periodikisht ka kërkuar informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, nëse kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe nëse kanë marrë masa, për koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera, apo për kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve dhe/ose për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët lidhur me çështje konkrete, apo nxjerrjen e

<sup>15</sup> Udhëzimi i Përgjithshëm nr.12/2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë. Informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr.16/2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë. Informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”

<sup>16</sup> Shih, nenin 47 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...”

<sup>17</sup> Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr.59 datë 18.03.2021<sup>17</sup> ka vendosur: “1.Rrëzimin si të pabazuar në ligj të kërkesës së prokurorit A.K. për konstatimin e pavlefshëmrisë absolute të Udhëzimit të Përgjithshëm 16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm; 2.Rrëzimin si të pabazuar në ligj të kërkesës së prokurorit A.K. për konstatimin e pavlefshëmrisë absolute të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokuroriaë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, të Prokurorit të Përgjithshëm”.

urdhërave për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre, me synim që të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë së prokurorisë, dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët e prokurorisë që drejtojnë, duke garantuar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

3.4 Në informacionet e përcjella nga drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm rezulton se pothuajse të gjitha prokuroritë kanë marrë masa për zbatimin e drejtpërdrejtë të këtyre udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve nënligjore të tjera.

-Në disa prokurori drejtuesit e prokurorisë kanë marrë, si masa administrative për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose hartimin e planeve të veprimit për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe masa procedurale për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe/ose kërkuar informacion prokurorëve për ecurinë e çështje konkrete, duke garantuar pavarësinë e tyre.

-Në disa prokurori të tjera, drejtuesit e prokurorisë rezulton se nuk kanë marrë masa të plota administrative dhe procedurale për zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerrë në zbatim të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të KM, apo për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, duke i zbatuar ato pjesërisht apo me mangësi serioze.

-Gjithashtu, konstatohet se ka pasur raste të mungesës së përsëritur të informimit mbi zbatimin e udhëzimeve dhe ngritjes së infrastrukturës përkatëse administrative për lehtësimin e kushteve për zbatimin e tyre, ku duhet evidentuar rasti i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane që është edhe prokuroria më e madhe e vendit. Nga kjo prokurori nuk është përcjellë as raporti vjetor mbi ecurinë e punës për vitin 2020, që është detyrim ligjor<sup>18</sup> shumë i rëndësishëm.

3.5 Rregullimi ligjor aktual vështirëson lidhjen organike efektive mes zyrave të prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, në kuptim të ushtrimit të detyrave ligjore dhe kushtetuese, ndërkohë që angazhimet institucionale që dalin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave apo në raport me organizma të tjerë ndërkombëtarë kërkojnë një nivel më të lartë kohezioni institucional.

-Sigurimi i pavarësisë së prokurorëve është një arritje e madhe, e cila nuk duhet të cënohet në asnjë mënyrë, por ka nevojë për ndërhyrje të tjera ligjore që do të sigurojnë funksionimin e prokurorisë si një e tërë, dhe jo si bashkim entitetesh autonome, pa instrumenta efikase që garantojnë funksionimin normal të zyrave të prokurorisë. Ne kemi nevojë për një prokurori që vepron shpejt në drejtim të përcaktimit të prioriteve, ndjekjes së tyre në mënyrë të bashkërenduar brenda saj dhe me insitucionet e tjera, përmes masave organizative apo mirëpërdorimit të burimeve njerëzore e financiare, duke pasur në themel pavarësinë procedurale të prokurorëve. Për të arritur këtë qëllim, vlerësojmë të domosdoshme përfshirjen e Prokurorit të Përgjithshëm në procesin e caktimit, pezullimit

<sup>18</sup> Neni 50 “Raportimi vjetor te Prokurori i Përgjithshëm” i ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.



apo shkarkimit të drejuesve të prokurorisë, si dhe pajisjen e tij me instrumenta ligjorë të nevojshëm për të ndërhyrë në mënyrë efikase, në veprimtarinë organizative të zyrave të prokurorive, në raste të ngutshme, për të siguruar koordinimin dhe kohezionin institucional në mënyrë efektive.

3.6 Në këtë vështrim, referuar analizës, vlerësimit dhe interpretimit të Kushtetutë dhe ligjit nr.97/2016, dhe jo vetëm, konstatohet se:

3.6.1 Kushtetuta në nenin 148/b dhe ligji 97/2016 në nenin 38 e vijues, ka parashikuar kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm (në vijim PP), siç janë: **-siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, -proponon dhe administron buxhetin e prokurorisë;** -është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka **përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë;** **-kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore e kushtetuese të prokurorisë, -përcakton strukturat, organikën dhe rregulloret standard,** etj.

i) Referuar nenit 147/a<sup>19</sup> të Kushtetutës, kompetencat lidhur me drejtimin dhe kujdesin për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, propozimin dhe administrimin e buxhetin të gjykatave e veprimtari të tjera të mirëadministrimit të gjykatave i janë caktuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Ndërsa, Kushtetuta dhe ligji, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP-në), nuk parashikon anjë kompetencë të tillë në raportë me sistemin e prokurorisë. Për më tepër, institucioni i KLP-së ka si funksion kushtetues, garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe jo kompetenca për të siguruar mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë.

ii) Në këtë vështrim, gjithashtu, konstatohet dhe vlerësojmë se, kompetencat e KLP-së të njësuara me ato të KLGJ në ligjin nr.96/2016 dhe në ligjin nr.97/2016, lidhur me caktimin e kancelarëve në prokurori apo caktimin e këshilltarit ligjor jomagjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme (me ligjin nr.42/2021) apo kompetenca të tjera që lidhen me përgjegjësitë në veprimtarinë dhe mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, çojmë se nuk janë në përfaqje me dispozitat e sipër cituara të Kushtetutës, të cilat ngarkojnë Prokurorin e Përgjithshëm dhe jo Këshillin e Lartë të Prokurorisë për ushtrimin e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi.

iii) Në këto vështrime kushtetuese e ligjore, vlerësojmë se kompetencat e KLP-së në drejtim të organizimit dhe funksionimit administrativ të prokurorisë:

-kanë krijuar një konflikt normativ kompetencash ligjore me ato kushtetuese; dhe

-ndikojnë drejtëpërdrejtë në ushtrimin e detyrës të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi përgjegjësia që i ngarkohet nuk është në përpjestim të drejtë me autoritetin që i është dhënë dhe instrumentat që disponon në marrëdhënie me hallkat e sistemit të prokurorisë, për të mundësuar përmbushjen e përgjegjësi që e ngarkon Kushtetuta dhe ligji.

<sup>19</sup> Neni 147/a i Kushtetutës parashikon: “KLGJ ushtron funksionet: d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave...”; “dh) proponon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;”, etj.

3.6.2 Për arsyt mësipër, sugjerohet rivlerësimin e dispozitave ligjore përkatëse në përjasje me dispozitat kushtetuese në fuqi për inicimin e ndërhyrjeve të nevojshme në nënenet përkatëse në ligjin 97/2016, ligjin nr.96/2016 apo ligjin nr.115/2016.

#### 4. Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave

Në analizë dhe vlerësim të ndikimit të politikave institucionale dhe politikave të rekomanduara në kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e BE-së për Shqipërinë, dhe jo vetëm, të përcuara nga Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshëm dhe akteve normative të tjera në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, se si kanë ndikuar ato, dhe jo vetëm, mbi tendenca e kriminalitetit të reflektuara në numrin e procedimeve të regjistruara, evidentohen treguesit statistikorë, si më poshtë:

4.1 Për vitin 2020 vërehet **tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale** si më poshtë:

- “Veprat Penale të kryera me dashje kundër shëndetit”, **4,65 %**;
- “Krimet seksuale”, **13,92 %**;
- “Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit”, **18,48 %**;
- “Veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë<sup>20</sup>”, **9,96 %**;
- “Veprat penale të mashtrimit<sup>21</sup>”, **18,26 %**;
- “Veprat penale të shkatërrimit të pronës”, **9,22 %**;
- “Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare<sup>22</sup>”, **44,16 %**;
- “Veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare”, **11,11 %**;
- “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet”, **27,21 %**;
- “Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë”, **8,24 %**;
- “Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve”, **38,61 %**;
- “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, **11,11 %**;
- “Veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës”, **8,38 %**;
- “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik<sup>23</sup>”, **30,71 %**;
- “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike<sup>24</sup>”, **4,81 %**;
- “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”, **39,88 %**;
- “Veprat penale kundër drejtësisë”, **22,22 %**;
- “Veprat penale të trafiqeve të paligjshme”, **12,54 %**;

<sup>20</sup> Veçuar trafiku i mjeteve motorike dhe veprave të artit;

<sup>21</sup> Veçuar mashtrimi kompjuterik;

<sup>22</sup> Veçuar korrupsioni në sektorin privat;

<sup>23</sup> Veçuar korrupsioni

<sup>24</sup> Veçuar veprat lidhur me narkotikët

4.2 Për sa i përket veprave penale të mëposhtme, vihet re **një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara** për vitin 2020. Kështu:

- “Krimet Kundër jetës të kryera me dashje”, **18,23 %**;
- “Krimet kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi”, **14,29 %**;
- “Krimet kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi”, **35,29 %**;
- “Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, **6,77 %**;
- “Veprat penale kundër lirisë së personit<sup>25</sup>”, **6,42 %**;
- “Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes<sup>26</sup>”, **9,12 %**;
- “Krimet në fushën e doganave”, **2,50 %**;
- “Veprat penale kundër mjedisit”, **24,44 %**;
- “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit<sup>27</sup>”, **17,21 %**;
- “Veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale”, **21,19 %**;
- “Veprat penale kundër prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve”, **17,80 %**.
- “Veprat penale kundër krimit kompjuterik”, **35,65 %**.
- Në informacionet e përcjella nga drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm rezulton se pothuajse të gjitha prokuroritë kanë marrë masa për zbatimin e drejtpërdrejtë të këtyre udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve nënligjore të tjera.

4.3 Referuar analizës dhe vlerësimit të tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave mësipër, bazuar në të dhënat statistikore, të trajtuara edhe tek efektiviteti i ndjekjes penal në raport, evidentohet se tendencat në ulje dhe/ose në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për disa grup veprash penale, jo në të gjitha rastet kanë qenë të ndikuara nga efektiviteti i ndjekjes penale të ushtruar për këto grup veprash.

i) Në këtë vështrim, grupveprat penale “trafiqet e paligjshme” dhe vepra penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” kanë tendencë në ulje të numrit të procedimeve të regjistruara, ndonëse efektiviteti i ndjekjes penale ndaj tyre ka patur tendence në ulje.

ii) Gjithashtu, grupveprat penale kundër, “jetës të kryera me dashje”, “prodhimit dhe kultivimit të narkotikeve” dhe “dhunës në familje”, kanë tendencë në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara, ndonëse efektiviteti i ndjekjes penale ndaj tyre ka patur tendencë në rritje.

-Ndërkohë, për grupveprat penale kundër, “jetës të kryera me dashje” efektiviteti i ndjekjes penale ndaj tyre ka patur tendencë në ulje, tregues i cili është shoqëruar me tendencën në rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale.

ii) Analizës dhe vlerësimit të shkaqeve të uljes dhe/ose rritjes së tendencave të kriminalitetit, theksojmë se i mungon kontributi në raportet vjetore të ecurisë së punës të prokurorive të rretheve gjyqësore, megjithë se ju është kërkuar zyrtarisht drejtuesve të

<sup>25</sup> Veçuar trafiku i personave të rritur

<sup>26</sup> Veçuar trafiku i të miturve

<sup>27</sup> Veçuar korrupsioni

prokurorive për të vlerësuar dhe pasqyruar në raportet vjetore për vitin 2020 dhe këtë aspekt të punës së prokurorisë që ata drejtojnë.

### **5. Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësorë të veprimtarisë së institucionit**

Në analizë dhe vlerësim të ndikimit të politikave institucionale dhe politikave të rekomanduara nga institucionet kushtetuese, të përcuara nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshëm dhe akteve normative të tjera në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, mbi disa tregues sintetik siç janë dhe efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësor në ndjekjen penale, dhe jo vetëm, evidentohen treguesit statistikorë, si më poshtë:

#### ***i) Tregues të përgjithshëm të efektivitetit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të çështjeve/akuzave në gjyq***

-Gjatë vitit 2020 janë përfunduar 26169 çështje që përbën ulje prej 7,14 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2019, prej të cilave: 38,11 % janë dërguar për gjykim, 22,62 % janë pushuar, 35,93 % janë pezulluar dhe 3,34 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

-Janë dërguar në gjykatë 9973 çështje me akuzë ndaj 11503 të pandehurve. Krahasimisht me vitin 2019 rezulton një ulje prej 4,07 e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 5,39 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

-Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 janë dënuar 8022 të pandehur dhe për 152 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose krahasuar me vitin 2019 me ulje 8,96 % e numrit të pandehur të dënuar dhe ulje 19,15 % e numrit të pandehurve të deklaruar të pafajshëm.

-Në gjykatë janë dërguar 410 kërkesa për miratim të urdhrit penal në lidhje me 432 të pandehur ose krahasuar me vitin 2019 me ulje 44,59 % të kërkesave dhe ulje 43,23 % të pandehurve për miratimin e urdhërit penal, ndërsa nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal në 12 raste ose krahasuar me vitin 2019 me ulje 40 % të rasteve që është vendosur nga gjykata refuzimi i miratimit të urdhrit penal.

-Në gjykatë, gjithashtu, janë dërguar 740 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë në lidhje me 749 të pandehur ose krahasuar me vitin 2019 me rritje 0,82 % të kërkesave dhe rritje 0,54 % të pandehurve për miratim marrëveshje, ndërkohë nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes në 45 raste ose krahasuar me vitin 2019 me rritje 4,65 % të rasteve që është vendosur nga gjykata refuzimi i miratimit të marrëveshjes.

-Gjatë vitit 2020, u dërguan në gjykatë për pushim 4647 çështje ose me rritje 53,16 % krahasuar me vitin 2019, prej të cilëve 2252 çështje janë pushuar për munges fakti, ose 48,46 % të çështjeve të pushuara. Nga të dhënat rezulton se për 233 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ose me rritje 8,88 % krahasuar me vitin 2019, ndërsa në 5 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës, tregues në ulje krahasuar me 12 vendime të tilla në vitin 2019.

Ndërkohë, është kërkuar gjykimi i drejtëpërdrejtë për 252 çështje me 252 të pandehur, që krahasuar me vitin 2019, përbëjnë rritje prej 14,55 % të numrit të çështjeve dhe 8,62 të numrit të të pandehurve për të cilët është kërkuar ky lloj gjykimi.

ii) *Efektiviteti<sup>28</sup> i ndjekjes penale sipas grupveprave penale që evidentohen me tendencë në rritje dhe/ose në ulje.*

- Lidhur me veprat penale të trafiqeve të paligjshme, në vitin 2020, pavarësisht se numri i procedimeve të regjistruara është ulur (12,54 %), treguesi i efektivitetit duke krahasuar numrin e çështjeve të dërguara në gjyq me numrin e çështjeve të pushuara është i ulët, përkatësisht 31,25 % dërguar gjyqit dhe 68,75 % të pushuara.

- Për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve, në vitin 2020, numri i procedimeve të regjistruara është ulur ndjeshëm (39,88 %) dhe treguesi i efektivitetit duke krahasuar numrin e çështjeve të dërguara në gjyq me numrin e çështjeve të pushuara është i lartë, përkatësisht 92,06 % dërguar gjyqit dhe 7,94 % të pushuara.

-Sa i përket veprave penale lidhur me narkotikët, çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 58,42 % dërguar gjyqit dhe 41,58 % të pushuara. Megjithatë numri i procedimeve për këto vepra është rritur gjatë vitit 2020 me 17,80 %.

-Efektiviteti i ndjekjes penale për pastrimin e parave evidenton, edhe për vitin 2020 tregues të ulët të raportit të çështjeve penale të dërguara në gjyq krahasuar me çështjet e pushuara, raport i cili është 20% çështje dërguar gjyqit me 80% çështje të pushuara. Ndërkohë, për veprat penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, numri i procedimeve të regjistruara është rritur me 20,19 %, numri i të pandehurve të regjistruar

---

<sup>28</sup> Koment: Në treguesit e efektivitetit është analizuar raporti ndërmjet çështjeve të dërguara në gjyq dhe atyre të pushuara, që janë mënyra të zgjidhjes ligjore përfundimtare të hetimeve. Ndërkohë, procedimet e pezulluara për shkak se nuk njihet apo nuk është zbuluar autori i veprës penale, që përbëjnë rreth 35,93 % të procedimeve të përfunduara, të dhëna që nuk janë përfshirë në treguesit e efektivitetit, për faktin se ky grupçështjesh për të cilat janë ndërprerë hetimet i kalojnë agjencive ligjzbatuese përkatëse për ndjekje/gjurmim të mëtejshëm për zbulimin e autorëve.

është rritur 103,1 % dhe numri i personave të dënuar është ritur 11 % krahasuar me vitin 2019.

- Në vitin 2020 ka një rritje prej 18,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2019, ndërkohë ndjekja penale ka rezultuar në tregues jo efektiv për faktin se janë dërguar për gjykim 31,66 % të çështjeve dhe janë pushuar 68,34 % e çështjeve.

- Efektiviteti i ndjekjes penale ka qenë i lartë lidhur me dhunën në familje, ku çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 83,02 % dërguar gjyqit dhe 16,98 % të pushuara. Në të njëjtën periudhë, çështjet e regjistruara paraqesin rritje prej 9,74 % krahasuar me vitin 2019.


- Lidhur me veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, treguesi i efektivitetit duke krahasuar numrin e çështjeve të dërguara në gjyq me numrin e çështjeve të pushuara është 41,82 % dërguar gjyqit dhe 58,18 % të pushuara. Nga ana tjetër të dhënat statistikore, evidentojnë ulje prej 14,32 % të procedimeve të regjistruara për këtë vepër në krahasim me vitin 2019. Ndërkohë efektiviteti i ndjekjes penale të nenit 291 të Kodit Penal, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, është i lartë, ku vërehet se përqindja e procedimeve dërguar gjyqit është 92,87 % dhe përqindja e procedimeve të pushuara është 7,13 %.

### ***iii) Efektiviteti i përgjimit të komunikimeve elektronike në hetimet paraprake***


Gjatë vitit 2020, në kuadrin e 630 procedimeve penale, me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore, në zbatim të kriterëve ligjore, është arritur në arrestimin/ndalimin e 709 personave të dyshuar për krime kundër rendit dhe sigurisë publike, kundër jetës dhe kundër autoritetit të shtetit, dhe për vepra penale kundër lirisë së personit, shpërdorim detyre, në fushën e narkotikëve, trafikeve apo vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja e mëtejshme për shtetin dhe shtetasit.

Në shifra të përgjithshme, gjatë vitit 2020 janë ekzekutuar gjithsej 1570 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake dhe 730 autorizime të prokurorit. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 3816 pajisje fundore në përdorim të 3535 personave të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Ecuria e këtij mjeti kërkimi prove në dy vitet e fundit paraqitet në grafikun në vijim:




Grafiku i mëposhtëm paraqet procedimet sipas grupveprave penale për të cilat është kërkuar përgjimi i komunikimeve elektronike në hetimet paraprake:



## II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT, TË DHËNA PËR NUMRIN, LLOJET, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE FORMAT E KRIMINALITETIT

Gjatë vitit 2020, në organin e prokurorisë janë trajtuar 58466<sup>30</sup> materiale kallëzuese që përbën një ulje prej 2,37 % në krahasim me vitin 2019. Janë ndjekur gjithsej 44834 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 1,23 % në krahasim me vitin 2019, nga të cilat 27890 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 9,29 % në krahasim me vitin 2019 dhe 640 procedime penale të rifilluara, që tregojnë rritje prej 9,59 % në krahasim me vitin 2019. Janë mbartur, 16304 procedime penale me një rritje prej 25,83 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2019. Është vendosur mosfillimi për 13632 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 12,61 % në krahasim me vitin 2019.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2020 paraqitet si vijon:



<sup>29</sup> Procedimi penal nuk njësohet me vepër penale, pasi:

- 1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna për veprën penale më të rëndë, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
- 2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.

<sup>30</sup> Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2020 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2020; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2020.




## 2.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2020 nga prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 10000 procedime penale (ulje prej 4,05 % në krahasim me vitin 2019) me 11530 të pandehur (ulje prej 5,41 % në krahasim me vitin 2019). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 11741 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal.

Nga prokuroritë pranë gjykatës të apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 1070 çështje themeli (ulje prej 58,58 % në krahasim me vitin 2019) dhe 2521 raste për masat e sigurimit personal (ritje prej 13,51 % në krahasim me vitin 2019).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar organin e akuzës në 4 çështje pranë Gjykatës së Lartë dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 1 çështje.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në përqindje për çështjet e përfaqësuara në gjykatë në të tre shkallët:



## 2.3 TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT


### Procedime të regjistruara dhe në ndjekje

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2016 janë regjistruar 31305 procedime penale që përbëjnë ulje prej 3,6 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 janë regjistruar 31481

procedime penale që përbën rritje prej 0,56 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 janë regjistruar 31409 procedime penale që përbën ulje prej 0,23 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2019 janë regjistruar 30748 procedime penale që përbën ulje prej 2,10 % krahasuar me vitin 2018 dhe në vitin 2020 janë regjistruar 27890 procedime penale që përbën ulje prej 9,29 % krahasuar me vitin 2019.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2016 rezultojnë 41690 procedime në ndjekje penale që përbën ulje prej 5,4 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 rezultojnë 40911 procedime në ndjekje penale që përbën ulje prej 1,87 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 rezultojnë 42814 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 4,65 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2019 rezultojnë 44289 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 3,45 % krahasuar me vitin 2018 dhe në vitin 2020 rezultojnë 44834 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 1,23 % krahasuar me vitin 2019.


Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike procedimet penale të regjistruara dhe procedimet në ndjekje në pesë vitet e fundit nga organi i prokurorisë:



### Ndjekja penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak

Pesha specifike që zënë procedimet penale të regjistruara në bazë të Kodit Penal Ushtarak në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2020 është 0,14 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 0,17.


Grafikët në vijim paraqesin të dhënat e volumit të punës në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës, për veprat penale në fushën e zbatimit të Kodit Penal Ushtarak:



Siç vërehet nga grafiku, në vitin 2020, janë regjistruar 38 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, janë mbartur 23 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 1 kallëzim/referim.

Gjatë vitit 2020 nga prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 27 procedime penale.

Procedimet penale janë regjistruar për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal Ushtarak që paraqiten në grafikun në vijim:



Në vijim të dhënat lidhen me vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, ligji nr.7895/1995 i ndryshuar.

### Çështje të përfunduara

Në lidhje me **çështjet e përfunduara**<sup>31</sup>, të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2016 rezulton një ulje 5,9 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje 9,3 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një rritje prej 1,93 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2017, në vitin 2019 rezulton një ulje prej 7,95 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2020 rezulton një ulje prej 7,14 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me **çështjet e pushuara**, në vitin 2016 rezulton një ulje prej 6,6 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një rritje prej 3,2 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një rritje prej 1,74 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2017, në vitin 2019 rezulton një ulje prej 12,53 % e çështjeve të pushuara<sup>32</sup> në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2020 rezulton një rritje prej 1,67 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2016 rezulton një rritje e lehtë prej 0,2 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje prej 13,4 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një ulje prej 2,69 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2017, në vitin 2019 rezulton një ulje prej 7,30 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2020 rezulton një ulje prej 6,80 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me **çështjet e dërguara në gjykatë**, në vitin 2016 rezulton një ulje prej 11,2 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2015, në vitin 2017 rezulton një ulje prej 11,6 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2016, në vitin 2018 rezulton një rritje prej 2,59 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2017, në vitin 2019 rezulton një ulje prej 11,82 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2020 rezulton një ulje prej 4,07 % e çështjeve të dërguara në gjykatë<sup>33</sup> në krahasim me vitin 2019.

Lidhur me numrin e të pandehurve të dërguar në gjykatë vërehet se në vitin 2016 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 11,4 % krahasuar me vitin 2015, në vitin 2017 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 14,5 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 4,65 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2019 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 9,29 % krahasuar me vitin 2018 dhe në vitin 2020 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 5,39 % krahasuar me vitin 2019.


---

<sup>31</sup> Në këtë tregues përveç çështjeve të pushuara, pezulluara dhe dërguar gjyqit mblihen edhe çështjet e transferuara.


<sup>32</sup> Në këtë tregues përfshihen çështje të pushuara nga prokurori dhe nga gjykata.

<sup>33</sup> Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake si dhe kërkesat për miratimin e urdhrin penal dhe marrëveshjes së fajësisë.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e pesë viteve të fundit:



Më poshtë paraqiten të dhëna në **lidhje me të pandehurit** sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake:




**Vendimmarrja e gjykatës**

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq në vitin 2016 përbën 2,5 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2017 ky tregues përbën 8,2 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2018 ky tregues është 1,43 %, në vitin 2019 ky tregues përbënte 1,74 % dhe në vitin 2020 është 1,28 %.

Në lidhje me **pushimin e akuzës** për të pandehurit, në vitin 2016 është vendosur pushimi i akuzës për 0,1 % të akuzave të ngritura, në vitin 2017 për 0,4 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës, në vitin 2018 për 0,12 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë është vendosur pushimi i akuzës, në vitin 2019 për 0,10 % të numrit të akuzave të ngritura në gjykatë dhe në vitin 2020 është vendosur pushimi i akuzës për 0,13 % të akuzave të ngritura.

Në lidhje me **vendimet e gjykatës për pafajësinë**, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2016 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 2,5 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2017 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 2,6 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2018 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,57 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate, në vitin 2019 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,55 % kanë marrë pafajësi me vendim gjykate dhe në vitin 2020 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,32 % kanë marrë pafajësi.

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë në pesë vite, 2016-2020:




### Pezullimet

Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokuroria është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore dhe nga ana tjetër hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit ose nga gjykata kur vendimi është ankimuar.


Ky tregues për vitin 2020 përbën 35,93 % të procedimeve për të cilat janë përfunduar dhe pezulluar hetimet.

Të dhënat tregojnë se ndër 9402 procedime të pezulluara, 9400 prej tyre janë pezulluar për shkak se nuk njihet autori i veprës penale dhe 2 procedime janë pezulluar për shkak se i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për procedimet e pezulluara në vitet 2016-2020:



Për vitin 2020, procedimet penale të pezulluara sipas grup veprave penale paraqiten grafikisht si më poshtë (në grafik nuk janë përfshirë procedimet e pezulluara për grup veprat penale numri i të cilave është më i ulët se 20):




## Mosfillimet


Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2016 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 15655 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 8,3 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2015, në vitin 2017 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 17378 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 11 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2016, në vitin 2018 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 14920 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 14,15 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2017, në vitin 2019 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 15596 referime dhe kallëzime ose një rritje prej 4,53 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2018 dhe në vitin 2020 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 13631 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 12,60 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2019.

Të dhëna të detajuara gjenden në grafikun e mëposhtëm:






## 2.4 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË



Më poshtë paraqiten të dhënat në përqindje mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2020:



Siç vërehet nga të dhënat, numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë me 31,74 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi. Prokuroritë e tjera me shifrat më të larta janë: prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës që ka regjistruar 9 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan që ka regjistruar 7,69 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë që ka regjistruar 7,13 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër që ka regjistruar 5,61 % të procedimeve të regjistruara, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Fier që ka regjistruar 5,19 % të numrit total të procedimeve të regjistruara dhe prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë që ka regjistruar 4,73 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi.

## 2.5 KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100.000 BANORË<sup>34</sup>

Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100.000 banorë në vitin 2020 është **979** ndërsa në vitin 2019 koeficienti i kriminalitetit ka qenë **1072**. Në lidhje me koeficientet e kriminalitetit për 100.000 banorë sipas qarqeve, të dhënat statistikore rezultojnë si më poshtë:


Në qarkun Berat që përfshin prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 663; në qarkun Dibër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Dibër dhe Mat, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 605; në qarkun Durrës që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Durrës dhe Krujë, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 1207; në qarkun Elbasan që përfshin prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 793; në qarkun Fier që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Fier dhe Lushnje koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 747; në qarkun Gjirokastër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Gjirokastër dhe Përmet koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 1578; në qarkun Korçë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Korçë dhe Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 890; në qarkun Kukës që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Kukës dhe Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 825; në qarkun Lezhë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Lezhë dhe Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 1117; në qarkun Shkodër që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Shkodër dhe Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 823; në qarkun Tiranë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë dhe Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 1030 dhe në qarkun Vlorë që përfshin prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Vlorë dhe Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2020 është 1479.

Siç rezulton nga të dhënat, përqindjen më të ulët të koeficientit të kriminalitetit edhe në vitin 2020 e ka qarku Dibër, ndërsa përqindjen më të lartë qarku Gjirokastër.


Renditja dhe të dhënat e kriminalitetit në dy vitet e fundit paraqiten grafikisht në vijim:

---

<sup>34</sup> <http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/>



Sa i përket tendencës në dy vite të dhënat grafike paraqiten si vijon:



Siç vërehet nga grafiku, qarku Gjirokastrë ka koeficientin më të lartë të kriminalitetit për vitin 2020 dhe ky koeficient është rritur në vitin 2020 me 14,03 % krahasuar me vitin 2019. Qarqet Vlorë, Durrës, Lezhë e Tiranë kanë gjithashtu koeficient mbi mesataren kombëtare, por që është ulur në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Qarqet Korçë, Shkodër, Elbasan, Fier e Berat kanë koeficient kriminaliteti nën mesataren kombëtare i cili rezulton në ulje krahasimisht me vitin 2019.

Ndërsa qarqet Kukës e Dibër kanë koeficient kriminaliteti nën mesataren kombëtare por që rezulton me rritje për vitin 2020 krahasuar me një vit më parë.

## 2.6 TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 janë **filluar kryesisht 59** procedime penale nga ana e prokurorisë.

**Kallëzime nga nëpunësit publikë:** në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 840 kallëzime, që përbën ulje prej 41,59 % krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1438 kallëzime, që do të thotë ulje prej 10,13 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1600 kallëzime, që do të thotë ulje prej 12,18 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1822 kallëzime, që do të thotë rritje prej 17,3 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1553 kallëzime.

**Kallëzime nga personeli mjekësor:** në vitin 2020 nuk rezultojnë kallëzime nga personeli mjekësor, në vitin 2019 rezulton të ketë ardhur në prokurori 1 kallëzim nga personeli mjekësor shifër e njëjtë me vitin 2018, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2 kallëzime nga personeli mjekësor, shifër e njëjtë me vitin 2016.

**Kallëzime nga shtetasit:** në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1769 kallëzime, që përbën ulje prej 46,70 % krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 3319 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë rritje prej 19,56 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2776 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë rritje prej 1,39 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2738 kallëzime nga shtetasit, që do të thotë ulje prej 1,9 % në krahasim me vitin 2016, gjatë të cilit rezulton të kenë ardhur në prokurori 2789 kallëzime.

**Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim:** në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 186 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që përbën ulje prej 6,53 % krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 199 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim që do të thotë rritje prej 11,17 % krahasuar me një vit më parë, në vitin 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 179 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim që do të thotë ulje prej 35,38 % krahasuar

me një vit më parë, në vitin 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 277 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që do të thotë rritje prej 19,4 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2016 rezulton të kenë ardhur në prokurori 232 kallëzime.

Gjatë vitit 2020 rezulton të jetë marrë njoftim për 4897 ngjarje, që do të thotë ulje prej 12,93 % në krahasim me vitin 2019, gjatë vitit 2019 rezulton të jetë marrë njoftim për 5624 ngjarje, që do të thotë rritje prej 2,24 % në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2018 rezulton të jetë marrë njoftim për 5501 ngjarje, që do të thotë ulje prej 5,6 % në krahasim me vitin 2017, gjatë vitit 2017 rezulton të jetë marrë njoftim për 5828 ngjarje, që do të thotë ulje prej 13,7 % në krahasim me vitin 2016, gjatë të cilit rezulton të jetë marrë njoftim për 6757 ngjarje.


Gjatë vitit 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 31798 **referime nga Policia e Shtetit dhe Polici të tjera** që përbën ulje prej 13,50 në krahasim me vitin 2019, gjatë vitit 2019 rezulton të kenë ardhur në prokurori 36760 referime që përbën ulje prej 0,20 në krahasim me vitin 2018, gjatë vitit 2018 rezulton të kenë ardhur në prokurori 36835 referime që përbën rritje prej 2,52 në krahasim me vitin 2017, gjatë vitit 2017 rezulton të kenë ardhur në prokurori 35929, që do të thotë rritje prej 15,7 % në krahasim me vitin 2016, gjatë të cilit rezulton të kenë ardhur në prokurori 31063 referime.

## **2.7 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË**

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 urdhrat për ekzekutim të dënimeve kryesore me burgim, gjobë e dënime plotësuese, zënë 43,03 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 56,97 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Krahasuar me vitin 2019, urdhrat e ekzekutimit për dënimet me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë dhe dënime plotësuese kanë pësuar një ulje prej 48,91 %, ndërsa ato për dënimet alternative kanë pësuar një ulje prej 51,70 %.

Gjatë vitit 2020 janë ekzekutuar 2990 vendime penale të formës së prerë, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar 1876 vendime. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 5 dënime me burgim të përjetshëm, 277 vendime me burgim, 736 vendime për dënimin me gjobë, 29 dënime plotësuese dhe 829 dënime alternative.


Grafikun në vijim paraqet raportin në përqindje të vendimeve të ekzekutuara dhe të vendimeve të pa ekzekutuara:



## 2.8 KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

### Raporti krime dhe kundërvajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2020, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara në prokurori sipas veprave penale:





**Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, rezulton si vijon:**


- Raporti që zënë **krimet kundër njerëzimit**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 1,85 %<sup>35</sup>;
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,03 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 3,09 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,06 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 1,53 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,49 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,50 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,81 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 4,88 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,01 %;
- Raporti që zënë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 31,24 %;
- Raporti që zënë **mashtrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 2,25 %;
- Raporti që zënë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 4,10 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,16 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,06 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,59 %;

---

<sup>35</sup> Përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 1,08 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,28 %;
- Raporti që zënë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 2,70 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0 %;
- Raporti që zënë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,46 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që cënojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 6,28 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 1,19 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,00 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,03 %;
- Raporti që zënë **krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,04 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 2,50 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 2,37 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 26,46 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 3,15 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 1,81 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020, është 0,02 %.

Numri i procedimeve sipas grup veprave penale dhe raporti i tyre me numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2020, paraqiten grafikisht si më poshtë:



Në vijim do të analizohet në mënyrë më të detajuar secili nga seksionet e Kodit Penal:

## 2.9 ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

### KRIME KUNDËR NJËRËZIMIT

Në vitin 2020 nuk rezultojnë procedime të regjistruara në lidhje me krimet e parashikuara në Kreun I të Kodit Penal, “Krime kundër njerëzimit”.

### KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike<sup>36</sup> që zë ky grup veprash penale për vitin 2020 është 1,72 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2019 ky grup veprash përbënte 1,32 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 16,87, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 14,18.


### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 1), rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 18,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2019. Ndërkaq kemi një ulje prej 5,61 % të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re rritje prej 18,92 % përkundrejt këtij totali në vitin 2019, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur me 13,38 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 14,46 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:

---

<sup>36</sup> “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve të regjistruara. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të mos ketë përputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 97,86 % e tyre janë meshkuj (nga të cilët 1,67 % janë të mitur) dhe 2,14 % janë femra (ndër të cilat nuk rezultojnë të mitura).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se për këto grup veprash penale 4,84 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë, 37,10 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve, prej 58,06 % rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.


Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 83,76 % e të pandehurve janë të papunë, 15,38 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 0,86 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se, rreth 64,17 % e të pandehurve për këtë grup veprash janë banues në qytet dhe 35,83 % e tyre, në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vihet re se 16,22 % e tyre janë përsëritës për vepra të tjera dhe 83,78 % janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të krimeve kundër jetës të kryera me dashje në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime kundër jetës të kryera me dashje është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 19 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier e Vlorë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë e Krujë janë regjistruar rreth 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër e Pogradec janë regjistruar përkatësisht rreth 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë, Gjirokastrë, Përmet e Kukës janë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2020. Prokuroritë e tjera kanë regjistruar një numër më të vogël procedimesh (më pak se 1 %) për krime kundër jetës të kryera me dashje.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Kanosja

Në në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” peshën specifike më të lartë e përbën vepra penale e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”, që në vitin 2020 është 70,42 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 64,78 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 janë regjistruar 338 procedime penale që përbëjnë një rritje prej 28,52 % krahasuar me vitin 2019.

### **Vrasja me dashje**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2020 është 6,67 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 8,13 %.

Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2020 janë regjistruar 32 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal “Vrasja me dashje”, që rezulton me një ulje prej 3,03 % në krahasim me vitin 2019.

### **Vrasja me paramendim**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” për vitin 2020 është 9,79 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 12,07 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020, ka një ulje prej 4,08 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 “Vrasja me paramendim”, krahasuar me vitin 2019.

### **Vrasja në rrethana të tjera cilësuese**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 5,63 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 8,87 %.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020, ka një ulje prej 25 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, krahasuar me vitin 2019.

### **Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime kundër jetës të kryera me dashje” është 2,29 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 4,19 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 janë regjistruar 11 procedime penale për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, që ndaj 17 procedimeve të regjistruara në vitin 2019, përbën ulje prej 35,29 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 97,86 % janë meshkuj madhorë, 58,06 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 83,76 %, janë të papunë dhe 16,22 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për krime kundër jetës me dashje, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 19 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë e Lezhë me 34 procedime dhe në qarkun Vlorë me 29 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, 86,18 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 82,35 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masës së dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 90,80 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 9,20 % dënim me gjobë (ku 71 % i përkasin kanosjes), ndërkohë që është kërkuar tërheqje aktesh në 1 rast, pushim akuze në 1 rast, 4 pushim çështjeje dhe 2 kërkesa për pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 23,19 % të të pandehurve (81 % e të cilëve të akuzuar për kanosje), 8,70 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum (67 % e të cilëve të akuzuar për kanosje), 36,23 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 27,54 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 4,35 % e kërkesave rezultojnë për dënim të përjetshëm. Gjykata ka vendosur në 90,14 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 9,86 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka kthyer aktet në 1 çështje, ka vendosur 2 pushim akuze, 5 pushim çështjeje dhe 2 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 21,86 % të të pandehurve (93 %



e të cilëve për kanosje), 10,94 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum (57 % e të cilëve për kanosje), 39,06 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 23,44 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 4,70 % dënime të përjetshme.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 94 procedime që përbëjnë 19,58 % të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që edhe në vitin 2019 kjo peshë ishte pothuajse e njëjtë, 20,20 %.

### **KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI**

Nga të dhënat statistikore (tabela 2) rezulton se në vitin 2020 ka rritje të lehtë të treguesve lidhur me “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”. Konkretisht nga 7 procedime penale me 5 të pandehur të regjistruar në vitin 2019, në 8 procedime penale me 5 të pandehur të regjistruar në vitin 2020. Procedimet e dërguara në gjykatë rezultojnë me rritje nga 7 në vitin 2019, në 8 procedime me 12 të pandehur në vitin 2020, ndërkohë janë dënuar 5 të pandehur për këtë vepër gjatë vitit 2020.

### **VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE**


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2020 është 3,09 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2019 ky grup veprash përbënte 2,94 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 30,25, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 31,55.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 3), rezulton se në vitin 2020 ka një ulje të gjithë treguesve për “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit” në krahasim me vitin 2019. Kështu, numri i procedimeve të regjistruara rezulton me ulje prej 4,65 %, numri i procedimeve dërguar në gjykatë ka pësuar ulje prej 5,33 %, numri i të pandehurve të regjistruar në vitin 2020 rezulton me ulje 0,34 %, numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë është ulur me 5,41 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 3,64 % krahasuar me vitin 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 2,95 % e tyre janë femra dhe 97,05 % janë meshkuj, ndër të cilët 2,92 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 4 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale 5,78 % e tyre janë me arsim të lartë, 41,43 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër prej 52,79 % e të pandehurve, rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.


Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 74,33 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 24,14 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat dhe 1,53 % të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 54,97 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 45,03 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 7,10 % prej tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale dhe 92,90 % janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 25 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier e Vlorë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, Dibër e Sarandë janë regjistruar rreth 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës, Lezhë, Shkodër e Pogradec janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë, Gjirokastrë, Kavajë e Lushnje janë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kurbin, Mat, Tropojë e Përmet janë regjistruar më pak se 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2020, ndërkohë që prokuroria e shkallës së parë Pukë nuk ka regjistruar asnjë procedim për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

#### Plagosja e rëndë me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2020 është 13,23 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 11,41 %.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020, vihet re tendencë rritje prej 10,68 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosja e rëndë me dashje”, në krahasim me vitin 2019.

### Plagosja e lehtë me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit” për vitin 2020 është 83,18 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 85,38 %.

Në vitin 2020, të dhënat statistikore tregojnë tendencë në ulje prej 7,13 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal “Plagosja e lehtë me dashje”, krahasuar me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 97,05 % janë meshkuj madhorë, 52,79 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 74,33 % janë të papunë, ku 7,10 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për krime kundër shëndetit me dashje, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 25 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 55 procedime, qarku Kukës me 44 procedime dhe qarku Korçë me 43 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 62,94 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 57,06 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 59,40 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 40,60 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka patur 1 tërheqje aktesh, 1 kërkesë për pushim akuze dhe 24 kërkesa për pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 53,80 % të të pandehurve, 11,39 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 31,01 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 3,80 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 59,40 % të dënimeve dënim me burg dhe në 41,60 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë vendosur 5 pushim akuze, 40 pushim çështjeje dhe 2 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 57,55 % të të pandehurve, në 0,72 % është vendosur ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, në 24,46 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum, 15,83 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,44 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 7,66 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2020 dhe 7,64 % në vitin 2019, përkatësisht 66 të pezulluara në vitin 2020 dhe 69 procedime të pezulluara në vitin 2019.

## VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Të dhënat statistikore (tabela 4) tregojnë se numri i procedimeve penale për “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” të regjistruara në vitin 2020 është rritur në 17 nga 11 procedime të regjistruara në vitin 2019. Për këtë periudhë rezulton 1 procedim me 1 të pandehur të dërguar në gjykatë, 2 të pandehur të regjistruar dhe nuk rezultojnë të pandehur të dënuar.

## VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,53 %. Ky tregues për vitin 2019 ka qenë 1,30 %, pra vihet re rritje e tij për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 14,97, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 13,94.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 5) rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 6,77 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga mosdhënia e ndihmës”, në krahasim me vitin 2019. Numri i procedimeve dërguar në gjykatë është i njëjtë me vitin 2019, 13 procedime, numri i të pandehurve të regjistruar është rritur nga 16 në 18 dhe numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur nga 18 në 14. Po kështu vërehet ulje edhe në lidhje me numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata nga 7 të pandehur në vitin 2019 në 5 të pandehur të dënuar në vitin 2020.

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit rezultojnë të moshës madhore, ku 61,90 % e përbëjnë meshkujt dhe 38,10 % femrat.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 85,72 % e të pandehurve janë me arsim të lartë, me arsim të mesëm janë 4,76 % e të pandehurve dhe me arsim deri në 9 vjeçar, 9,52 % e të pandehurve.

Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 72,73 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 90,48 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet ndërsa pjesa tjetër në fshat, ndërsa në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzaniës ose mosdhënia e ndihmës, është në prokurorinë pranë gjykatës së

shkallës së parë Fier, që përbën 21 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 18 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Kukës janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Krujë e Pogradec janë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Dibër, Berat, Pukë, Sarandë, Kavajë, Mat, Përmet e Tropojë janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi dhe në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Gjirokastër, Kurbin, Lezhë e Lushnje janë regjistruar më pak se 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2020 për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose mosdhënia e ndihmës.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës” është 11,5 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 14,54 %.

Të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2020 për këtë vepër penale është ulur me 15,52 % krahasuar me vitin 2019.


### Shkaktimi i vetëvrasjes

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 88,5 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 84,96 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 11,21 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):





### KRIME SEKSUALE


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,49 %, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 0,51 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 4,78, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 5,52.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 6) rezulton se në vitin 2020 ka ulje prej 13,92 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2019, ndërkohë që kemi ulje prej 28,21 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 9,57 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 31,46 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,45 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë dhe moshën për të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 98 % e të pandehurve (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 2 % janë femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve meshkuj, 11 % janë të mitur (14-18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 66,34 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 30,69 % me arsim të mesëm dhe 2,97 % me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 74,54 % e të pandehurve janë të papunë, 21,82 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 3,64 % të punësuar në sektorin shtetëror.

Rezulton se 64,65 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 35,35 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 90,91 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 9,09 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohen.

## SHËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime seksuale, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 22 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 16 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje e Shkodër janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan e Korçë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, Lezhë e Sarandë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kavajë e Vlorë janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Kurbin, Pogradec, Dibër, Përmet e Tropojë janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi për vitin 2020 për krime seksuale, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Mat e Pukë nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” në vitin 2020 është 16,18, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 17,72 %.


Në vitin 2020 vihet re ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, prej 21,43 % në krahasim me vitin 2019.

### Ngacmimi seksual

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime seksuale” është 42,65 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 36,08 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, në grupin e krimeve seksuale vihet re tendenca pothuajse e njëjtë e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal “Ngacmimi seksual”, në krahasim me vitin 2019 (rritje e lehtë nga 57 në 58 procedime të regjistruara).

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 87,13 % janë meshkuj madhorë, 11 % janë të mitur, 66,34 % janë me arsim deri 9 – vjeçar, 74,54 % janë të papunë dhe 9,09 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për krime seksuale, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 22 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqet Durrës e Fier me 8 procedime dhe qarku Lezhë me 7 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 91 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 87,95 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest. Ndërkohë janë vendosur edhe 5 masa ndaluese ndaj të pandehurve.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burg, ndërkohë që është kërkuar pafajësi për 1 të pandehur. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 13,34 % të të pandehurve, 8,33 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 78,33 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në të gjithë dënimet, dënim me burg, ndërkohë që ka vendosur 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 18,33 % të të pandehurve, 13,34 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 68,33 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 11 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2020 dhe 12 % në vitin 2019, përkatësisht 15 të pezulluara në vitin 2020 dhe 19 procedime të pezulluara në vitin 2019.

## VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,42 % dhe për vitin 2019 ka qenë 0,36 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 4,08, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 3,81.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 7) rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 6,42 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër lirisë së personit” në krahasim me vitin 2019. Ndërkaq kemi rritje prej 2,1 herë (110,53 %) të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit e regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 18,03 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 52,50 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 21,05 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Në lidhje me gjininë, 94,81 % e të pandehurve janë meshkuj (mbi 18 vjeç) dhe 5,19 % janë femra (mbi 18 vjeç).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 61,04 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 36,36 % me arsim të mesëm dhe 2,60 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 24,14 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror nuk rezultojnë dhe të papunë 75,86 %.

Rezulton se 63,16 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 36,84 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 88,16 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 11,84 % janë përsëritës për vepra të tjera.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër lirisë së personit, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 28 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Fier janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër e Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë e Lushnje janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë e Vlorë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kavajë, Pogradec e Sarandë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë, Krujë, Përmet e Pukë janë regjistruar rreth 2 % e totalit, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat e Kukës janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 për vepra penale kundër lirisë së personit, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kurbin, Mat e Tropojë nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 12,07 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 6,42 %. Në vitin 2020 për këtë vepër janë regjistruar 14 procedime penale, që i korrespondon dyfishit të procedimeve të regjistruara në vitin 2019.

### Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2020, në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 48,28 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 62,39 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2020 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” prej 17,65 %, në krahasim me vitin 2019.

### Heqja e paligjshme e lirisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër lirisë së personit” është 23,28 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 18,35 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”, nga 20 procedime në vitin 2019, në 27 procedime në vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):





## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 94,81 % janë meshkuj madhorë, 61,04 % janë me arsim deri 9 vjeçar, 75,86 % janë të papunë, dhe 11,84 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër lirisë së personit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 28 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 12 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 88,37 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 83,72 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 91,67 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 8,33 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar edhe 1 pushim akuze. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 36,36 % të të pandehurve, 22,73 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 40,91 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 91,30 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 8,70 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 47,62 % të të pandehurve, 28,57 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 23,81 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 18 procedime që përbëjnë 15,52 % të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2019 pesha që zinin procedimet e pezulluara ishte 17,43 %.

## VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,81 %, ndërkohë që në vitin 2019 ky regjistruar ka qenë 0,90.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 7,91, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 9,64.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 8) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 18,48 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” në krahasim me vitin 2019. Ndërkaq kemi ulje prej 10,81 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019, ulje në lidhje me numrin e të pandehurve regjistruar për

këtë grup veprash penale prej 25,30 % përkundrejt këtij totali në vitin 2019, ulje me 14,29 % të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë dhe ulje me 42,19 % të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, krahasuar me vitin 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 82,95 % janë meshkuj dhe 17,05 % femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 51,56 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 36,72 % me arsim të mesëm dhe 11,72 % të pandehur me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore, rezulton se nga sektori privat janë regjistruar 37,29 % e të pandehurve dhe 62,71 % rezultojnë të papunë.

Rezulton se 67,97 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 32,03 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 86,17 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 12,20 % e tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 1,63 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 38 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës, Lezhë e Gjirokastrë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Krujë, Berat e Dibër janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Përmet, Sarandë, Kavajë, Kurbin e Lushnje janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Pukë e Pogradec, janë regjistruar më pak se 1 % e procedimeve dhe në prokuroritë e shkallës së parë Tropojë e Mat nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash për vitin 2020.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Shfrytëzimi i prostitucionit

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 14,22 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 10,14 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit”, në vitin 2020 me 14,29 % në krahasim me vitin 2019.

### Përndjekja

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 57,78 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 68,12 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2020 janë regjistruar 54,79 % më pak procedime penale sesa në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal “Përndjekja”.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** meshkuj madhorë janë 82,85 % dhe femra janë 17,05 %, 51,56 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 62,71 % janë të papunë, 1,63 % janë përsëritës për të njëjtën veprë dhe 12,20 % janë përsëritës për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 38 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 15 procedime dhe qarkun Vlorë me 12 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 76,79 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 75 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 86,96 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 13,04 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar në 3 çështje pushimi i tyre. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 33,75 % të të pandehurve, 25 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 41,25 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 98,65 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,35 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur kthim aktesh në 1 çështje, 3 pushim çështje dhe 17 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 37,84 % të të pandehurve, 36,49 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 24,32 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 19,56 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2020 dhe 18,48 % në vitin 2019, përkatësisht 44 të pezulluara në vitin 2020 dhe 51 procedime të pezulluara në vitin 2019.

### **Rekomandime**

## **VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 4,85 %, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 4,04 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 47,51 ndërsa në vitin 2019 ka qenë 43,28.

### **TENDENCA**

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore në vitin 2020 për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”, rezulton rritje prej 9,12 % e numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2019 e ndërkaq kemi rritje prej 8,54 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar

përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 9,12 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 8,99 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 10,60 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

94,06 % e të pandehurve janë meshkuj ku 1,46 % e përbëjnë të miturit dhe 5,94 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë 3,13 % të mitura.

Për këto vepra, rezultojnë edhe 2 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 59,87 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 36,23 % me arsim të mesëm dhe 3,90 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 4,17 % e të pandehurve, në sektorin privat 23,34 % e të pandehurve dhe të papunë 72,49 %.

Rezulton se 57,49 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 42,51 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 88,54 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2,13 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 9,33 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, është regjistruar në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 32 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë e Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Lezhë, Gjirokastrë, Krujë, Kurbin, Sarandë e Dibër, janë regjistruar 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Kavajë, Kukës e Pogradec, janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Mat, Pukë, Përmet e Tropojë janë regjistruar

një numër procedimesh që përbën më pak se 1 % të numrit total të procedimeve penale të regjistruar për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Braktisja e fëmijëve të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2020 është 1,78 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 3,47 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal “Braktisja e fëmijëve të mitur”, në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, nga 43 në 24 procedime të regjistruara ose 44,19 %.

### Keqtrajtimi i të miturit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2020 është 3,55 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 2,18 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturit”, në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, nga 27 në 48 procedime të regjistruara, ose 77,78 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




### Dhuna në familje



Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” për vitin 2020 është 92,53 %, ndërsa në vitin 2019 pesha e kësaj vepre rezulton në masën 92,01 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 9,74 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të Kodit Penal “Dhuna në familje”, në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, tregon se është arritur ulje në masën 7,68 % në numrin e procedimeve të regjistruara në vitin 2016 krahasuar me vitin 2020.



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 92,71 % janë meshkuj madhorë, 59,87 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 72,49 %, janë të papunë, 2,13 % janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 9,33 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 32 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 62 procedime dhe qarku Vlorë me 60 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 88,58 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 85,29 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest, ndërkohë që janë vendosur edhe 7 masa ndaluese.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 99,73 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 0,27 % dënim me gjobë,

ndërkohë që është kërkuar pushimi në 11 çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 36,74 % të të pandehurve, për 0,40 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 24,90 % e kërkesave rezultojnë për caktimin e dënimit në minimum, 37,69 % në marzhin mesatar dhe 0,13 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 99,73 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 0,27 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 13 pushime çështje dhe 7 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 41,53 % të të pandehurve, për 0,41 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 32,51 % e dënimeve rezultojnë për caktimin e dënimit në minimum dhe 25,14 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita (0,41 % liruar me kohën e paraburgimit).

### **VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT**

Në lidhje me veprat penale kundër lirisë së besimit, gjatë vitit 2020 janë regjistruar 4 procedime penale me 1 të pandehur për veprën penale “Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit”.

### **VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE VJEDHJA E PASURISË**


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 30,70 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 30,94 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 300,46, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 331,78.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 11) rezultojnë se në vitin 2020 ka një ulje prej 9,96 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë dhe një ulje prej 11 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 7,19 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 13,40 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18,25 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

93,81 % e të pandehurve janë meshkuj, ku 12,98 % e përbëjnë të miturit, dhe 6,19 % janë të pandehura femra ndër të cilat rezultojnë të jenë 3,41 % të mitura.

Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 20 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 72,60 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 24,55 % me arsim të mesëm dhe 2,84 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 3,81 % e të pandehurve, në sektorin privat 9,81 % e të pandehurve dhe të papunë 86,38 %.

Rezulton se 63,31 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 36,69 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 78,35 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 9,80 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 11,86 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e vjedhjes së pasurisë është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 40 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë, Fier e Shkodër janë regjistruar përkatësisht 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje, Sarandë e Kavajë janë regjistruar rreth 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë, Kurbin, Gjirokastrë e Berat janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë, Pogradec, Kukës e Dibër janë regjistruar përkatësisht rreth 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërsa në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Mat, Përmet, Tropojë e Pukë janë regjistruar më pak se 1 % e totalit e numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020, për veprat penale të vjedhjes së pasurisë.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Vjedhja

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është 91,36 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 91,42 %.

Nga të dhënat vihet re se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në vitin 2020 janë ulur me 10 % në krahasim me vitin 2019.

### **Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2020 është 0,80 %, ndërsa për vitin 2019 ky tregues ka qenë 0,90 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2020 vërehet tendenca në ulje prej 20 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, në krahasim me vitin 2019.

### **Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2020 është 0,07 %, ndërsa për vitin 2019 ky tregues ka qenë 0,17 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2020 vërehet trendi në ulje i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit”, në krahasim me vitin 2019, nga 16 procedime në 6 procedime të regjistruara.

### **Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2020 është 6,12 %, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 6,05 %.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” i Kodit Penal, ka një ulje prej 9,04 % në krahasim me vitin 2019.

### **Vjedhja me dhunë**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2020 është 1,43 % ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 1,23 %.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2020 ka rritje prej 5,13 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja me dhunë”, në krahasim me vitin 2019.

### **Vjedhja me armë**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vjedhja e pasurisë” për vitin 2020 është 0,18 % ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 0,16 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal “Vjedhja me armë” është i njëjtë në dy vitet e fundit, 15 procedime të regjistruara.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 81,63 % janë meshkuj madhorë nga të cilët të mitur 12,98 %, 72,60 % janë me arsim deri 9- vjeçar, 86,38 % janë të papunë, 9,80 % përsëritës për të njëjtën vepër dhe 11,86 % janë përsëritës për vepra të ndryshme.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vjedhjen e pasurisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 40 % e tyre, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 475 procedime, qarkun Durrës me 402 procedime dhe qarkun Tiranë me 398 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 81,79 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 76,92 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest, ndërkohë që është vendosur edhe 1 masë ndaluese.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 97,38 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 2,62 % dënim me gjobë,

ndërkohë që është kërkuar pushimi i 7 çështjeve dhe pushim akuze në një rast. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 48,01 % të të pandehurve, për 0,11 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 17,33 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 32,29 % në marzhin mesatar, 0,11 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 0,32 kërkesa për burgim të përjetshëm (1,83 % liruar me kohën e paraburgimit). Gjykata ka vendosur në 96,93 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 3,07 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur kthim aktesh në 4 çështje, 8 pushim çështje dhe 13 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 50 % të të pandehurve, për 23,58 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 23,47 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 0,66 % në marzhin maksimal të dënimit dhe 0,33 % dënime të përjetshme (2,02 % liruar me kohën e paraburgimit).

**Siguria publike:** për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 6497 procedime që përbëjnë **77,44 %** të procedimeve të regjistruara. Ky tregues është me rritje krahasur me 7446 procedime të pezulluara në vitin 2019, gjatë të cilit procedimet e pezulluara përbënin një peshë prej 78,40 % të procedimeve të regjistruara.

### MASHTRIMET


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,02 %, ndërsa në vitin 2019 është 2,45 %. Pra, vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 19,82, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 24,11.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 12) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje të gjithë treguesve për veprat penale të mashtrimit. Kështu, vërehet ulje prej 18,26 % e numrit të procedimeve regjistruar krahasuar me vitin 2019 dhe ulje prej 17,41 % e procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 38,77 %, një ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 27,81 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,61 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Rezulton se 86,96 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 13,04 % e të pandehurve janë femra.

Në këtë grup veprash rezultojnë të pandehur edhe 6 shtetas të huaj.

Për sa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 25,71 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 46,39 % me arsim të mesëm dhe 27,90 % me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 2,90 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror, në sektorin privat rezultojnë 42,03 % e të pandehurve dhe 55,07 % janë të papunë.


Rezulton se 74,14 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 25,86 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 0,65 % e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën vepër, 5,48 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, ndërsa 93,87 % janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:





Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e mashtrimit është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 44 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar rreth 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Sarandë, Berat, Lezhë e Pogradec janë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Krujë, Kavajë e Gjirokastër janë regjistruar 1 % e totalit të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020, ndërsa në prokuroritë e tjera janë regjistruar më pak se 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale të mashtrimit.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Mashtrimi

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 80,50 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 88,84 %.

Në këtë grup veprash penale vihet re një tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mashtrimi”, në vitin 2020, prej 25,94 % në krahasim me vitin 2019.

### **Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 2,66 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 0,58 %.

Për këtë vepër vërehet rritje e numrit të procedimeve regjistruar gjatë vitit 2020, ku ky tregues është 15 ndërkohë që në vitin 2019 janë regjistruar 4 procedime penale për krijimin e skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar.

### **Mashtrimi në sigurime**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Mashtrimet” është 5,50 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 4,64 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re ulje e lehtë e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”, nga 32 në vitin 2019, në 31 procedime penale në regjistruara në vitin 2020.

### **Mashtrimi në kredi**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit për vitin 2020 është 6,56 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 2,32 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal “Mashtrimi në kredi”, në vitin 2020, prej 2,3 herë krahasuar me vitin 2019, konkretisht nga 16 në 37 procedime penale.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezultojn se:

**Profili i të pandehurve:** 86,96 % janë meshkuj madhorë, 46,39 % janë me arsim të mesëm, 55,07 % janë të papunë, 0,65 % përsëritës për të njëjtën veprë dhe 5,48 % janë përsëritës për vepra të ndryshme.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vjedhjen e pasurisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 44 % e tyre, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezultojn në qarkun Vlorë me 34 procedime dhe qarkun Tiranë me 28 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 81,67 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 76,67 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masës e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezultojn se në 94,18 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 5,82 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar në 2 raste tërheqje aktesh, 3 pushim çështjeje dhe 6 pushim akuze. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 36,52 % të të pandehurve, për 7,30 % të kërkesave rezultojn për caktimin e dënimit në minimum dhe 56,18 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 93,82 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 6,18 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 5 pushim çështjeje, 2 pushim akuze, 2 kthim aktesh dhe 11 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 42,51 % të të pandehurve, 40,12 % rezultojn për caktimin e dënimit në minimum dhe 17,37 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 64 procedime që përbëjnë 11,35 % të procedimeve të regjistruara. Ky tregues është me ulje prej 40,19 % krahasur me 107 procedime të pezulluara në vitin 2019, gjatë të cilit procedimet e pezulluara përbënin një peshë prej 15,51 % të procedimeve të regjistruara.

### SHKATËRRIMI I PRONËS


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 4,10 %, tregues i njëjtë me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 40,13, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 43,95.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 13) rezulton se në vitin 2020 ka trend në ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të shkatërrimit të pronës në krahasim me vitin 2019, e konkretisht 9,22 %. Ndërkohë vërehet rritje prej 15,12 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019, ulje 44,78 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 18,97 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34,94 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit 9,10 % janë femra dhe 90,90 % meshkuj, ndër të cilët 5 % janë të pandehur të mitur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 51,82 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 42,73 % me arsim të mesëm dhe 5,45 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Rezulton 1 shtetas i huaj ndër të pandehurit për këto grup vepra.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektor shtetëror janë regjistruar 5,97 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë 37,31 % e të pandehurve dhe 57,72 % janë të papunë.

Rezulton se 50,93 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 49,07 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë, 90,29 % e të pandehurve, ndërsa 9,71 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

### **SHPERNDARJA GJEOGRAFIKE**

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për shkatërrimin e pronës, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 22 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier e Elbasan janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë e Gjirokastrë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Berat, Sarandë, Lezhë e Krushjë janë regjistruar rreth 3 % e totalit të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Kukës, Kavajë e Pogradec janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Mat, Lushnjë, Dibër, Tropojë, Kurbin, Përmet e Pukë janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara për vitin 2020 për shkatërrimin e pronës.

## **VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

### **Shkatërrimi i pronës**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 44,31 % për vitin 2020, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 43,16 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës” në vitin 2020 është në ulje me 6,81 % në krahasim me vitin 2019.

### **Shkatërrimi i pronës me zjarr**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” është 41,24 % për vitin 2020, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 40,46 %.


Nga të dhënat statistikore në vitin 2020, vihet re tendenca në ulje me 7,47 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, në krahasim me vitin 2019.

### **Shkatërrimi i pronës me eksploziv**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2020 është 2,89 %, ndërsa në vitin 2019 ky tregues ka qenë 4,45 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, prej 41,07 % në krahasim me vitin 2019, që i korrespondon 33 procedimeve penale të regjistruara ndaj 56 procedimeve në vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezultojnë se:

**Profili i të pandehurve:** 90,90 % janë meshkuj madhorë, 51,82 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 57,72 %, janë të papunë dhe 9,71 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për shkatërrimin e pronës, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 22 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezultojnë në qarqet Vlorë me 92 procedime dhe qarku Gjirokastrë me 89 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 70 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 66,67 % të kërkesave është vendosur masa sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masës së dënimit të kërkuar nga prokurori, rezultojnë se në 69,64 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 30,36 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar në 1 rast tërheqje aktesh dhe 11 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 66,67 % të të pandehurve, për 15,38 % të kërkesave rezultojnë për caktimin e dënimit në

minimum dhe 17,95 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 74,07 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 25,93 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 7 pushim çështje, 1 kthim aktesh dhe 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 70 % të të pandehurve, 12,5 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 17,5 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 585 procedime që përbëjnë 51,23 % të procedimeve të regjistruara, peshë pothuajse e njëjtë me vitin 2019 ku procedimet e pezulluara përbënin 51,19 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

### **VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,15 %, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 0,25 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 1,51, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 2,69.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 14) rezulton se në vitin 2020 të gjithë treguesit për këtë grup veprash janë ulur. Numri i procedimeve penale të regjistruara dhe numri i të pandehurve të regjistruar është ulur respektivisht 44,16 % dhe 39,47 % në krahasim me vitin 2019, ndërsa numri i procedimeve të dërguara në gjykatë dhe numri i të pandehurve të dërguar gjykatë është ulur respektivisht 44,44 % dhe 36,17 %, krahasuar me vitin 2019, ndërkohë që numri i të pandehurve të dënuar është ulur 41,46 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:





## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, tregojnë se, 86,36 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 13,64 % femra, të moshës madhore.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 22,72 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 59,10 % me arsim të mesëm dhe 18,18 % të pandehur me arsim të lartë.


Rezulton 1 shtetas i huaj ndër të pandehurit për këto grup vepra.

Lidhur me vendbanimin rezulton se 86,36 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 13,64 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 90,90 % janë të padënuar më parë dhe 9,10 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohet.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive, ku vërehet se prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë e Berat, kanë regjistruar numrin më të lartë të procedimeve penale për këtë grupveprash ndërkohë që prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Korçë, Krujë, Lezhë, Pukë e Sarandë, nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.




### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

#### Punësimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” në vitin 2020 është 72,09 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 81,82 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal “Punësimi i paligjshëm”. Kështu në vitin 2020 janë regjistruar 31 procedime penale, kundrejt 63 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2019 ose 50,79 % më pak.

Grafikisht, ecuria pesë-vjeçare e kësaj vepre paraqitet si vijon:



### **VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE**


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është aq sa në vitin 2019, 0,06 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 0,56, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 0,63.

#### **TENDENCA**

Në vitin 2020 (tabela 15) numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare në krahasim me vitin 2019 ka pësuar ulje nga 18 në 16 procedime, ndërkohë që numri i të pandehurve të regjistruar është rritur nga 17 në 22. Numri i procedimeve të dërguara gjyqit dhe numri i të pandehurve dërguar gjyqit është ulur nga 15 procedime me 19 të pandehur në 7 procedime me 12 ndërsa numri të pandehur, ndërkohë që të pandehurit e dënuar nga gjykata rezultojnë me rritje nga 11 në 19 të pandehur.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



### KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,59 %, ndërsa për vitin 2019 është 0,52 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 5,76, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 5,59.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 16) rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 2,50 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2019. Ndërkaq kemi ulje prej 4,90 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 4,23 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është rritur me 5,34 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 5,95 % krahasuar me vitin 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve rezulton se 97,42 % e të pandehurve janë të rritur meshkuj dhe 2,58 % të rritur femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 21,94 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 61,93 % me arsim të mesëm dhe 16,13 % të pandehurve janë me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2020 gjithsej të punësuar në sektorin privat zënë 70,59 % të numrit të të pandehurve dhe 29,41 % rezultojnë të papunë.


Rezultojnë edhe 7 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2020.

Sa i përket vendbanimit, 88,74 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 11,26 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 94,04 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2,65 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale dhe 3,31 % përsëritës për vepra të tjera të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 23 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 17 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastër e janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 për krime në fushën e doganave, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kukës, Përmet, Sarandë, Tropojë, Lezhë e Lushnje janë regjistruar rreth 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në vitin 2020 në grupin e krimeve në fushën e doganave është 17,68 %, ndërsa për vitin 2019 ky tregues ka qenë 12,5 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në vitin 2020, nga 20 në 29 procedime ose prej 45 % në krahasim me vitin 2019.

### **Kontrabanda me mallra të tjera**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 21,34 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 26,88 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re se procedimet penale të regjistruara për këtë veprë janë ulur me 18,60 %, konkretisht në vitin 2020 janë regjistruar 35 procedime penale kundrejt 43 procedimeve të regjistruara në vitin 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

### **Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë**


Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2020 vihet re tendenca në ulje me 12,5 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, ku kjo veprë ka një peshë prej 21,34 % të procedimeve të regjistruara.

### **Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë**

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2020 vihet re tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”, ku kjo veprë ka një peshë prej 24,39 % të procedimeve të regjistruara.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për vitin 2020 janë regjistruar 40 procedime penale ndaj 22 procedimeve të regjistruara në vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 97,42 % janë meshkuj madhorë, 61,93 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 70,59 %, janë të punësuar në sektorin privat, 2,65 % janë përsëritës për të njëjtën veprë dhe 3,31 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për krime në fushën e doganave, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 23 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 30 procedime dhe qarku Korçë me 18 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masës së dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 77,50 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 22,50 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 74,19 % të të pandehurve. Gjykata ka vendosur në 78,48 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 21,52 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 1 pushim akuze. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 82,26 % të të pandehurve.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 26 procedime që përbëjnë 15,85 % të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2019 ku procedimet e pezulluara përbënin 8,13 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

## VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET




Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,08 %, ndërsa për vitin 2019 është 1,35 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 10,54, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 14,50.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 17) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 27,21 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” në krahasim me vitin 2019. Ndërkaq rezulton rritje prej 3,88 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 39,77 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,62 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 15,63 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë të rritur ku 11,02 % femra dhe 88,98 % meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 19 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 61,16 % me arsim të mesëm dhe 19,84 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për këto vepra rezultojnë të marrë si të pandehur edhe 3 shtetas të huaj.


Sa i përket gjendjes shoqërore, 81,36 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin privat, 1,69 të punësuar në sektorin shtetëror dhe pjesa tjetër prej 16,95 % janë të papunë.

Lidhur me vendbanimin, rezulton se 80,95 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 19,05 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 93,50 % janë të padënuar më parë, 5,69 % e tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,81 % përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Sic vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 26 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë

pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Berat janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier e Gjirokastrë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë, Kukës e Vlorë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Kurbin, Tropojë, Krujë e Lushnje janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Mat, Përmet, Dibër, Pogradec e Sarandë janë regjistruar më pak se 1,5 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë e Pukë nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash.

## **VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

### **Fshehja e të ardhurave**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 56 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 65,78 %.


Nga të dhënat statistikore të vitit 2020 vërehet tendenca në ulje prej 38,46 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave” në krahasim me vitin 2019.

### **Mospagimi i taksave dhe i tatimeve**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 30 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 24,58 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara në vitin 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal “Mospagimi i taksave dhe i tatimeve”, prej rreth 11,76 % krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 88,98 % janë meshkuj madhorë, 61,16 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 81,36 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 5,69 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 26 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë me 27 procedime dhe qarku Lezhë me 26 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masës së dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 67,05 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 32,95 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar 2 pushim çështje dhe 2 kërkesa për tërheqje aktesh. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 67,05 % të të pandehurve, 23,73 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 11,86 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 62,96 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 37,04 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka kthyer aktet në 1 çështje, ka vendosur 3 pushim çështje dhe 4 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 78,43 % të të pandehurve.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 7 procedime, tregues i njëjtë me vitin 2019.

## FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,28 %, po aq sa në vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 2,74, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 2,97.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 18) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 8,24 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2019 dhe ulje prej 12,50 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 37,84 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 8 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13,04 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, 95,45 % janë meshkuj dhe 4,55 % janë femra.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 27,27 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 59,09 % me arsim të mesëm dhe 13,64 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në lidhje me gjendjen shoqërore rezultojnë se 42,86 % e të pandehurve kanë qenë të papunë, 50 % të punësuar në sektorin privat dhe 7,14 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror. Rezultojnë se 72,73 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 27,27 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 4,55 % rezultojnë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 95,45 % e të pandehurve rezultojnë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Sic vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Vlorë janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan, Fier e Korçë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë e Lushnje janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, Krujë, Kurbin, Kukës, Lezhë, Përmet, Pogradec, Sarandë

e Tropojë janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Mat, Dibër e Pukë nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash.


## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Falsifikimi i monedhave

Për vitin 2020 pesha specifike e kësaj vepre përbën 96,15 % të procedimeve të regjistruara për grupin e veprave penale “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë”, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 96,47 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2020 vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”, prej 8,54 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 95,45 % janë meshkuj madhorë, 59,09 % janë me arsim të mesëm, 50 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 4,55 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për falsifikimin e monedhave, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 24 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastrë e Vlorë me 5 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 50 % të të pandehurve, 20 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 30 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 55 % të dënimeve, aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë, në 20 % të dënimeve caktimin e dënimit në minimum dhe në 25 %, caktimin e dënimit në marzhin mesatar të përcaktuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 38 procedime që përbëjnë 48,72 % të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2019, ku ky tregues përbënte 47 % të çështjeve.

### FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,56 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 3,79 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 25,09, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 40,63.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 19) rezulton se në vitin 2020 ka ulje prej 38,61 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2019, ulje të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 45,11 %, ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 42,09 %, ulje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 34,65 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 5,40 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:





## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të dhënat lidhur me gjininë e të pandehurve tregojnë se 85,29 % e tyre janë meshkuj dhe 14,71 % janë femra.

Në vitin 2020 rezultojnë të pandehur 27 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 37,33 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 45,50 % me arsim të mesëm dhe 17,17 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë 6,67 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin privat janë 20 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër prej 73,33 % e të pandehurve, rezultojnë të papunë.

Rezulton se 65,15 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 34,85 % e të pandehurve në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 95,90 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 4,10 % e tyre rezultojnë të dënuar për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për falsifikimin e dokumenteve, rezulton në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 34 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë e Durrës janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan, Sarandë, Fier e Gjirokastër janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, Kukës e Lezhë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje, Dibër e Tropojë janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kavajë, Mat, Përmet, Kurbin, Krujë, Pogradec e Pukë janë regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 1 % të numrit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Falsifikimi i dokumenteve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 53,08 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 55,72 %. Nga të dhënat statistikore vërehet ulje prej 38,73 % e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, “Falsifikimi i dokumenteve”.

### Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i Dokumenteve” për vitin 2020 është 21,85 %, ndërkohë që vitin 2019 është 27,78 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2020 procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, kanë pësuar një ulje prej 51,70 % krahasuar me një vit më parë.

### Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” është 16,67 % për vitin 2020, ndërkohë që për vitin 2019 rezulton 10,75 %.

Nga të dhënat statistikore, në vitin 2020 vërehet ulje prej 4,8 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 85,29 % janë meshkuj madhorë, 45,50 % janë me arsim të mesëm, 73,33 %, janë të papunë dhe 4,10 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për falsifikimin e dokumenteve, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 34 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 54 procedime dhe qarkun Vlorë me 43 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 96,51 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 3,49 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar pushimi i çështjes në 1 rast. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 66,12 % të të pandehurve, 18,75 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 15,13 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 96,64 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 3,56 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur 3 pushim çështje dhe 15 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 73,26 % të të pandehurve, 17,02 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 9,72 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 152 procedime që përbëjnë 21,29 % të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2019 ku procedimet e pezulluara përbënin 18,31 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

### VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT

Tabela 20 paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e IX-të të Kreut të tretë të Kodit Penal, veprat penale në fushën e falimentimit, ku siç vërehet gjatë vitit 2020 është regjistruar 1 procedim penal me 3 të pandehur për veprën penale “Falimentimi i provokuar”.

### ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,46 %, ndërsa për vitin 2019 është 0,47 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 4,50, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 5,03.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 21) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”, në krahasim me vitin 2019 me 11,11 %, numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është i njëjtë me një vit më parë, numri i të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale është rritur 2,4 herë përkundrejt këtij totali në vitin 2019, numri i të pandehurve të cilët janë

dërguar në gjykatë është rritur me 9,52 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 27,94 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit rezultojnë 99 % meshkuj të rritur dhe 1 % femra të rritura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 29 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 61 % me arsim të mesëm dhe 10 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Sa i përket gjendjes shoqërore, të punësuar në sektorin privat rezultojnë 73,68 % e të pandehurve, 23,68 % rezultojnë të papunë dhe 2,64 % të punësuar në sektorin shtetëror.

Nga treguesit vërehet se 74 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 26 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 97 % janë të padënuar më parë dhe 3 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për zhvillimin e palejuar të lojrave të fatit, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 33 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 15 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje e Pogradec janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë, Kurbin, Lezhë, Mat e Vlorë janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, Fier, Kavajë e Tropojë janë regjistruar 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Kukës, Gjirokastër, Përmet, Pukë e Sarandë nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash.


## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Organizimi i lotarive të palejuara

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” është 95,31 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 92,36 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, në vitin 2020, me 8,27 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 99 % janë meshkuj madhorë, 61 % janë me arsim të mesëm, 73,68 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 3 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për zhvillimin e palejuar të lojrave të fatit është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 33 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Korçë me 11 procedime dhe qarkun Shkodër me 9 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 67,27 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 32,73 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 83,78 % të të pandehurve. Gjykata ka vendosur në 65,31 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 34,69 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur kthim aktesh në 1 rast dhe 5 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 90,63 % të të pandehurve.

## VEPRA PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 6,28 %, ndërsa për vitin 2019 ky tregues ka qenë 6,22 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 61,42, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 66,69.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 22) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 8,38 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës në krahasim me vitin 2019 dhe ulje prej 4,06 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 5,14 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,92 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 7,89 % krahasuar me vitin 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rregjimit juridik të tokës për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:



Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë se 6,21 % e përbëjnë femrat dhe 93,79 % meshkujt.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 34,41% janë me arsim të mesëm, 3,23 % të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër prej 62,36 % me arsim 9 vjeçar.


Në sektorin privat rezultojnë të punësuar 28,42 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 0,89 % dhe pjesa tjetër e të pandehurve prej 70,69 janë të papunë.

Nga treguesit vërehet se 38,22 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 61,78 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 98,20 janë të padënuar më parë, 0,21 % e të pandehurve përsëritës për të njëjtën vepër dhe 1,59 % përsëritës për vepra të ndryshme penale.

### SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 21 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara,

në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër, Elbasan e Durrës janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës, Lushnje, Korçë, Lezhë e Fier janë regjistruar rreth 3 % e totalit të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kurbin e Dibër janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë e shkallës së parë Gjirokastrë, Pogradec, Tropojë, Kavajë janë regjistruar rreth 1 % e procedimeve penale, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Përmet, Mat e Pukë është regjistruar një numër procedimesh më i ulët se 0,5 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash për vitin 2020.


## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Ndërtimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës është 89,13 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 91,30 %.

Vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal “Ndërtimi i paligjshëm” në vitin 2020 prej 9,06 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 93,79 % janë meshkuj madhorë, 62,36 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 70,69 % janë të papunë.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër rregjimit juridik të tokës, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë, 21 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 162 procedime dhe qarkun Kukës me 109 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 92,71 % të të pandehurve është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë. Gjykata ka vendosur në 93,16 % të dënimeve, aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë.

## VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,19 %, ndërkohë që për vitin 2019 është 0,87 %. Pra vihet re rritje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2020.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 11,63, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 9,29.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 23) rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 24,44 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2019 dhe ulje prej 3,03 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 19,01 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,11 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 2,08 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të gjithë të pandehurit, janë meshkuj të rritur.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 66,29 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 33,71 % me arsim të mesëm.


Të punësuar në sektorin privat rezultojnë 41,18 % e të pandehurve dhe të papunë rezultojnë të jenë 58,82 %.

Ndërsa lidhur me vendbanimin rezulton se 28,57 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 71,43 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 85,71 % janë të padënuar më parë, 11,91 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 2,38 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit, është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë e Berat, që kanë regjistruar 11 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë, Dibër, Lezhë e Pogradec janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Shkodër janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës e Fier janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë, Kurbin e Tropojë janë regjistruar rreth 3 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë e Sarandë janë regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara për vitin 2020, ndërkohë që në prokuroritë e shkallës së parë Mat, Pukë, Kavajë, Lushnjë e Përmet janë regjistruar më pak se 2 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Ndotja e ajrit, e ujrave dhe e tokës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 12,39 % për vitin 2020, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 13,53 %.

Nga të dhënat statistikore, vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit” në krahasim me vitin 2019, nga 36 procedime në 41 procedime penale të regjistruara në vitin 2020.

### Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” është 7,25 %. Për këtë vepër të shtuar në vitin 2019, janë regjistruar 24 procedime penale gjatë vitit 2020.

### Prerja e paligjshme e pyjeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër mjedisit” për vitin 2020 është 55,89 %, ndërsa në vitin 2019, 61,28 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, në vitin 2020 prej 13,50 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** të gjithë janë meshkuj madhorë, 66,29 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 58,82 % janë të papunë, 11,91 % përsëritës për të njëjtën veprë dhe 2,38 % përsëritës për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, është regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë Krujë e Berat 11 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarqun Kukës me 30 procedime dhe qarkun Berat me 29 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se 53,19 % e kërkesa kanë qenë për dënimin me gjobë dhe 46,81 % për dënimin me burg, ku për të gjithë të pandehurit është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë. Gjykata ka vendosur në 44,68 % të dënimeve dënimin me gjobë dhe në 55,32 dënimin me burg, ku të gjithë dënimet janë pezulluar dhe i pandehuri është vendosur në provë.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2020 janë pezulluar 71 procedime që përbëjnë 21,45 % të procedimeve të regjistruara, tregues në ulje krahasuar me vitin 2019 ku procedimet e pezulluara përbënin 25,19 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

## **KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES**

dhe

## **KRIME QË CËNOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA**

Pesha specifike që zënë krimet kundër rendit kushtetues dhe krimet që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020 është 0,03 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 0,013 %.

### **Krime kundër rendit kushtetues**

Të dhënat statistikore (tabela 24) tregojnë se gjatë vitit 2020 janë regjistruar 7 procedime penale dhe 1 i pandehur për krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, ndërkohë që është dërguar për gjykim 1 procedim me 1 të pandehur. Konkretisht, janë regjistruar 6 procedime penale me 1 të pandehur, është dërguar në gjykatë 1 procedim penal me 1 të pandehur dhe është dënuar nga gjykata 1 i pandehur, për veprën penale të parashikuar nga neni 223 i Kodit Penal “Thirrjet publike për veprime të dhunshme” dhe 1 procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 224 i Kodit Penal “Krijimi i partive dhe shoqatave antikushtetuese”.

## **VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE**

Pesha specifike që zënë veprat me qëllime terroriste në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2020 është 0,04 %, ndërsa në vitin 2019 ky tregues ka qenë 0,03.

**TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 25) rezulton se totali i procedimeve të regjistruara për vepra penale me qëllime terroriste në vitin 2020 është 12, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 10.

Prokuroria në vitin 2020 ka regjistruar:

3 procedime penale për nenin 230 të Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste”;

2 procedime penale për nenin 230/a të Kodit Penal “Financimi i terrorizmit”;

6 procedime penale për nenin 232/a të Kodit Penal “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”, ndërkohë që për këtë vepër 2 procedime me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim;

1 procedim penal për nenin 232/b të Kodit Penal “Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”.

**VEPRA PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR  
DHE ORGANIZATA KRIMINALE**

Nga të dhënat statistikore (tabela 26), rezulton se në vitin 2020 nga prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm është regjistruar 1 procedim penal për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”. Ky procedim është transferuar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme.

**VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA  
NGA SHTETASIT**

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,45 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 1,89 %.


Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 23,93, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 20,30.

**TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 27) rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 17,21 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” dhe ka një rritje prej 27,22 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje 7,52 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 21,36 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 26,30 % përkundrejt vitit 2019.



Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, moshë, arsimit, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga të pandehurit, rreth 1,4 % kanë qenë të pandehur të mitur. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) rezultojnë 98,6 %, nga të cilët 97,33 % janë meshkuj dhe 2,67 % femra.

Në këtë grup veprash rezultojnë edhe 4 të pandehur të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 42,52 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 46,61 % me arsim të mesëm dhe 10,87 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 3,44 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 21,76 % e të pandehurve dhe të papunë 74,81 %.

Rezulton se 69,09 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 30,91 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve rreth 89,83 % janë të padënuar më parë ndërsa 10,17 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 32 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë e Durrës janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë e Shkodër janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë, Pogradec, Fier, Berat e Gjirokastrë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër e Krujë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës, Kurbin, Lushnje e Kavajë janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Përmet, Sarandë, Mat e Tropojë janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, ndërkohë që në prokurorinë e shkallës së parë Pukë nuk janë regjistruar procedime penale për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 28,93 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 31,15 %.

Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” prej 8,84 % në krahasim me vitin 2019.

### **Goditjet për shkak të detyrës**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” në vitin 2020 është 14,68 %.


Për këtë vepër penale rezulton tendenca në rritje prej 6,38 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

### **Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 40,53 % në vitin 2020, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 36,14 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal “Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik”, në vitin 2020, prej 31,43 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 97,33 % janë meshkuj madhorë, 46,61 % janë me arsim të mesëm, 74,81 %, janë të papunë dhe 10,17 % janë përsëritës.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 32 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 56 procedime dhe qarkun Lezhë me 37 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 50,17 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 45,45 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 68,32 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 31,68 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar edhe 3 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 60,90 % të të pandehurve, për 24,57 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 14,53 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 69,49 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 30,51 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 8 pushim çështjeje dhe 4 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 64,80 % të të pandehurve, 23 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 12,20 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

## VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,34 %, ndërsa në vitin 2019 pesha e këtyre veprave ka qenë 3,07 %. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 22,91, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 32,87.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 28) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 30,71 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, në krahasim me vitin 2019 dhe ulje prej 9,47 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 51,61 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur 13,53 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 22,12 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit e rritur (mbi 18 vjeç) rezultojnë 13,03 % femra dhe 86,97 % meshkuj.

Lidhur me arsimin rezulton se 74,06 % e tyre janë me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë 79,34 % e të pandehurve, nga të cilët 7,27 % janë nëpunës të nivelit të lartë dhe 18,79 % punonjës policie.

Rezultoni se 67,88 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 32,12 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 98 % e të pandehurve janë të padënuar më parë.

### SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 26 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 16 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara,

në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë, Sarandë, Shkodër e Gjirokastrë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat janë regjistruar 3 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, Kurbin, Pogradec e Fier janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, për vitin 2020 për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, ndërkohë që në prokurorinë e shkallës së parë Kukës, Përmet, Kavajë, Lushnje, Pukë, Mat e Tropojë janë regjistruar rreth 1 % e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash.

### **VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

#### **Shpërdorim detyre**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2020 në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” është 92,94 %, ndërsa për vitin 2019 ky tregues ka qenë 93,62 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorim detyre”, në vitin 2020, prej 31,21 % në krahasim me vitin 2019.

#### **Kryerja e veprimeve arbitrare**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” në vitin 2020 është 5,52 % ndërsa në vitin 2019 ka qenë 3,83 %. Pra ky tregues rezulton në rritje për vitin 2020.


Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare” në vitin 2020 është i njëjtë me atë të vitit 2019, 36 procedime penale.

#### **Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë në vitin 2020 është 0,61 % ndërsa në vitin 2019 ka qenë 1,17 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” ka tendencë në ulje të numrit të procedimeve e konkretisht nga 11 procedime të regjistruara në vitin 2019, në 4 procedime të regjistruara në vitin 2020.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 86,97 % janë meshkuj madhorë dhe 74,06 janë me arsim të lartë.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 26 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastër me 54 procedime dhe qarkun Durrës me 47 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 57,58 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 24,24 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 98,15 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 1,85 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar tërheqja e akteve në një rast dhe 2 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në



55,66 % të të pandehurve, për 10,38 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 33,96 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 97,53 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 2,47 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 1 pushim akuze, 3 pushim çështje dhe 24 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 51,90 % të të pandehurve, 13,92 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 34,18 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

### **VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE**


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 18,77 % ndërsa në vitin 2019 ka qenë 17,89 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 183,66, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 191,83.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore për “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” (tabela 29) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 4,81 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje prej 3,87 % e numrit të të pandehurve të regjistruar në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me numrin e procedimeve të dërguara në gjykatë për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 2,44 %, rritje e lehtë e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 0,69 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 4,33 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Nga të pandehurit, 2,64 % kanë qenë të pandehur të mitur dhe 97,36 % të rritur (mbi 18 vjeç). Të pandehurit meshkuj përbëjnë edhe për këtë grup veprash pjesën më të madhe e konkretisht 98,06 % ndër të cilët 2,64 % të mitur dhe 1,94 % femra ndër të cilat 2,78 % rezultojnë të mitura.

Rezultojnë 17 të pandehur me shtetësi të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 47,83 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 43,69 % me arsim të mesëm dhe 8,48 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë rreth 1,67 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë të punësuar 34,28 % e të pandehurve dhe të papunë 64,05 %.

Rezulton se 59,75 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 40,25 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 94,43 % e tyre janë të padënuar më parë, 5,02 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 0,55 % përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 34 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan e Durrës janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër, Vlorë e Fier janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë e Berat janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë, Gjirokastrë, Dibër, Kurbin, Pogradec, Kavajë e Sarandë janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara dhe në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Kukës, Mat, Tropojë, Përmet e Pukë janë regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Vetëgjyqësia

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2020 është 4,40 %, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 4,15 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca e lehtë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në vitin 2020, prej 0,88 % në krahasim me vitin 2019.

### Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2020 është 5,99 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 6,57 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” i Kodit Penal në vitin 2020, prej 13,30 % në krahasim me vitin 2019.

### Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2020 është 2,03 %, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 1,64 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në vitin 2020 prej 17,78 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2020 është 15,23 %, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 16,92 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në vitin 2020, prej 14,32 % në krahasim me vitin 2019.

### Largimi nga vendi i aksidentit

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 5,74 % për vitin 2020, ndërsa në vitin 2019 pesha specifike e kësaj vepre ka qenë 4,88 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, në vitin 2020 janë rritur 11,94 % krahasuar me vitin 2019.

### Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2020 është 53,85 %, që përbën edhe peshën më të lartë, ndërsa në vitin 2019 ky tregues ka qenë 51,74 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” në vitin 2020, prej 0,92 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 98,06 % janë meshkuj, 47,83 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 64,05 % janë të papunë, 0,55 janë përsëritës për të njëjtën veprë dhe 5,02 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 34 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 314 procedime dhe qarkun Gjirokastrë me 256 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 25,22 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 22,84 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 94,60 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 5,40 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar tërheqja e akteve në 5 raste, 1 pushim akuze dhe 14 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 75,27 % të të pandehurve, për 0,04 % të tyre është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, për 13,78 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 10,87 % në marzhin mesatar dhe 0,04 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur 92,53 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 7,47 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 15 kthim aktesh, 23 pushim çështjeje dhe 8 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 79,40 % të të pandehurve, për 0,08 % të tyre është vendosur ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 13,88 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 6,48 % në marzhin mesatar dhe 0,04 në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita (0,12 % të liruar me kohën e paraburgimit).

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 473 ose 8,36 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019 rezulton e njëjta shifër e procedimeve të pezulluara, dhe ky tregues përbënte 7,96 % të procedimeve të regjistruara.

## VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,03 %, ndërsa në vitin 2019 ky tregues ka qenë 0,77 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 10,05, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 8,24.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 30) rezulton se në vitin 2020 ka një rritje prej 21,19 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në krahasim me vitin 2019. Ndërkaq kemi ulje 4,17 %, të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar me 100 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur me 2,13 % ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 22,73 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për vitet 2019-2020 paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) meshkuj 90,54 % dhe femra 9,46 %.

Ndër të pandehurit, rezultojnë edhe 5 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 35,14 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 56,76 % me arsim të mesëm dhe 8,117 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se 23,40 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 76,60 % janë të papunë.

Rezultoni se 63,51 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 36,49 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezultoni se 72,97 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa 27,03 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër pastrimit të parave, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 18 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Lushnje e Fier janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër, Gjirokastrë e Korçë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Përmet, Mat, Kurbin, Sarandë, Krujë, Pogradec e Pukë është regjistruar një numër procedimesh që përbën më pak se 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup



veprash, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Kavajë, Kukës e Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për vitin 2020 për vepra penale kundër pastrimit të parave.


## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale për vitin 2020 është 97,55 % ndërsa në vitin 2019 ka qenë 98,31 %.

Gjatë vitit 2020 vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, prej 20,26 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e kësaj veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 90,54 % janë meshkuj, 56,76 % janë me arsim të mesëm, 76,60 % janë të papunë dhe 27,03 % janë të dënuar më parë.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër pastrimit të parave, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 18 %, ndërkohë që

koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 25 procedime dhe qarkun Vlorë me 21 procedime.

**Politika Penale:** Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burg, ndërkohë që ka patur 1 kërkesë për pushim akuze, 2 kërkesa për pushim çështjeje dhe 1 kërkesë për pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 35,30 % të të pandehurve, 5,88 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 58,82 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në të gjithë rastet dënim me burg, ndërkohë që janë vendosur 2 pushim çështjeje dhe 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur sipas kërkesës së prokurorit.

**Signoria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 52 ose 18,18 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019, ky tregues përbënte 33,05 % të procedimeve të regjistruara.

### **Rekomandime**

## **VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTORË**


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020 është 3,15 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 4,75 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2019 është 30,78 ndërsa, në vitin 2019 ka qenë 50,90.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 31) rezulton se në vitin 2020 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është ulur 39,88 % në krahasim me vitin 2019 dhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është ulur 15,76 % në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 30,85 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 10,01 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,46 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 97,19 % meshkuj dhe 32,81 % femra.

Të pandehur të huaj rezultojnë 44.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 64,31 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 32,76 % me arsim të mesëm dhe 2,93 % me arsim të lartë.


Të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 4,93 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 0,48 % dhe pjesa tjetër prej 94,59 % rezulton e papunë.

Rezulton se 59,22 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 40,78 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 92,46 % e tyre janë të padënuar më parë, 3,77 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të tjera dhe po kaq përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 33 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë e Korçë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër e Durrës janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan e Vlorë janë regjistruar një numër procedimesh që përbën 3 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash, prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, Fier, Kurbin, Lezhë, Kavajë, Përmet, Krujë, Tropojë e Lushnje kanë regjistruar rreth 1 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Mat e Pukë nuk kanë regjistruar procedime për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2020.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” në vitin 2020 është 72,26 %, ndërsa në vitin 2019 ky tregues ka qenë 90,94 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, në vitin 2020, prej 52,23 % në krahasim me vitin 2019.

## Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” për vitin 2020 është 27,28 %, ndërsa për vitin 2019 ky tregues ka qenë 8,51 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, në vitin 2020, prej 92,74 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIMET

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 97,19 % janë meshkuj, 64,31 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 94,59 % janë të papunë dhe 7,54 % janë përsëritës, ku 50 % e tyre të dënuar për të njëjtën vepër.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 33 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastrë me 172 procedime, qarkun Kukës me 74 procedime dhe qarkun Korçë me 73 procedime.

**Politika Penale:** Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 76,62 % të të pandehurve është kërkuar dënim me gjobë dhe në 23,38 % dënim me burg, ndërkohë që ka patur 1 kërkesë për pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 43,33 % të të pandehurve, në 1,11 % është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 7,78 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 47,78 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 76,90 % të dënimeve dënim me gjobë dhe në 23,10 % dënim me burg, ndërkohë që janë vendosur 1 pushim akuze, 1 pushim çështje dhe 3 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 55,68 % të të pandehurve, në 10,23 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 34,09 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 29 ose 3,31 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019, ky tregues përbënte 1,51 % të procedimeve të regjistruara.

## VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,81 % ndërsa për vitin 2019 ka qenë 2,11 %. Pra vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është, 17,71 ndërsa në vitin 2019 ka qenë 22,64.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 32) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 22,22 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2019 e ndërkaq numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është i njëjtë me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 6,62 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,87 % përkundrejt këtij totali në vitin 2019 dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,61 % krahasuar me një vit më parë.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër drejtësisë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, vetëm 2,47 % rezultojnë të mitur dhe 97,53 % të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç). Sa i përket gjinisë së të pandehurve, rezulton se 9,90 % janë femra dhe 90,10 % meshkuj.

Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 5 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 52,50 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 41,04 % me arsim të mesëm dhe 6,46 % e të pandehurve me arsim të lartë.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat rezultojnë 30,08 % e të pandehurve dhe të papunë 76,92 %.

Sa i përket vendbanimit, vërehet se 66,11 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 33,89 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 68,79 % janë të padënuar më parë, 31 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,21 % janë përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 25 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Vlorë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Korçë janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat e Sarandë janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë e Lezhë është regjistruar një numër procedimesh që përbën 3 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kavajë, Kurbin, Gjirokastrë, Përmet, Pogradec, Dibër e Lushnje janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Kukës, Mat e Tropojë janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroria pranë gjykatës të shkallës së parë Pukë nuk ka regjistruar procedime penale lidhur me vepra penale kundër drejtësisë për vitin 2020.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës



Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2020 është 13,89 %, tregues në ulje krahasuar me vitin 2019 gjatë të cilit pesha specifike e kësaj veprë ishte 15,74 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “Pëngime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, në vitin 2020, prej 31,37 % në krahasim me vitin 2019.

### **Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2020 është 20,04 %, ndërsa në vitin 2019 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë veprë përbënte 18,98 % të totalit të grupit.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, në vitin 2020, prej 17,89 % në krahasim me vitin 2019.

### **Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit**

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2020 është 22,22 %, ndërsa në vitin 2018 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë veprë përbënte 8,49 %.


Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, në vitin 2020, prej 2 herë më shumë (103 %) në krahasim me vitin 2019.

### **Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim**

Pesha specifike e kësaj veprë në grupin e veprave penale “Kundër drejtësisë” për vitin 2020 është 14,48 %, ndërkohë që në vitin 2019 ky tregues ishte 29,32 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2020 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, prej 61,58 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 90,10 % janë meshkuj, 52,50 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 76,92 % janë të papunë dhe 31 % janë të dënuar më parë.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër drejtësisë, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 25 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 33 procedime dhe qarkun Gjirokastrë me 30 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 76,81 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 77,37 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 85,56 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 14,44 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka patur 3 kërkesa për pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 34,18 % të të pandehurve, 30,38 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 35,44 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 87,02 % të dënimeve dënim me burg dhe në 12,98 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë vendosur 5 pushim çështjeje dhe 12 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 35,96 % të të pandehurve, në 30,22 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 30,26 % të

dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita (0,45 % e të pandehurve dënuar me kohën e vuajtur në paraburgim).

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 85 ose 16,87 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019, ky tregues përbënte 9,26 % të procedimeve të regjistruara.

### **VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE**

Të dhënat në lidhje me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve (tabela 33) tregojnë se gjatë vitit 2020 janë regjistruar 5 procedime penale me 1 të pandehur dhe 1 i pandehur është dënuar.

### **VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT**

Nga të dhënat statistikore (tabela 34) rezulton se në vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë regjistruar 25 procedime penale për veprat penale të korrupsionit, në lidhje me 17 të pandehur. Janë dërguar në gjykatë 3 procedime me 3 të pandehur dhe janë dënuar 20 të pandehur për këto vepra.

Sa i përket veprave penale të korrupsionit, në fushën e përgjegjësisë së prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, vërehet tendencë në ulje për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, konkretisht:

-Për nenin 124/a të Kodit Penal “Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit”, është regjistruar 1 procedim penal ndaj 2 procedimeve në vitin 2019;

-Për nenin 164/a të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv në sektorin privat”, është regjistruar 1 procedim penal, po aq sa në vitin 2019;

-Për nenin 164/b të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv në sektorin privat”, është regjistruar 1 procedim penal ndaj 4 procedimeve në vitin 2019;

-Për nenin 328 të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe për nenin 328/b të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, nuk janë regjistruar procedime penale, por kjo edhe për faktin se në vitin 2020, nuk janë zhvilluar zgjedhje.

### **KRIMI KIBERNETIK**


Pesha specifike që zë ky grup veprash penale në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2020, është 0,56 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 0,37.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 5,48, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 4,02.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 35) rezulton se në vitin 2020 numri i procedimeve të regjistruara, është rritur me 35,65 % krahasuar me një vit më parë, ka një ulje të numrit të procedimeve dërguar në gjykatë, nga 10 procedime në vitin 2019 në 6 procedime dërguar në gjykatë në vitin 2020 (40 %), ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2020 përkundëjt këtij totali në vitin 2019 nga 13 në 3 (76,92 %), ulje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë nga 11 në 8 (27,27 %) dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar për vepra penale kundër krimit kompjuterik nga 18 në 6 (66,67 %).

Grafikisht tendenca e krimit kibernetik për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Të pandehurit janë të gjithë të rritur (mbi 18 vjeç) nga të cilat 76,92 % meshkuj dhe 23,08 femra %.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 23,08 % e tyre janë me arsim të mesëm, 46,15 % me arsim të lartë, 30,77 % me arsim deri 9-vjeçar.

Rezulton se 61,54 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet dhe 38,46 % në fshat.

Ndërsa lidhur me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krimin kibernetik, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 67 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Elbasan janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Fier janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë, Kavajë e Kukës janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat, Korçë, Krujë, Mat, Pogradec, Vlorë, Dibër, Kurbin, Lezhë, Lushnje e Tropojë është regjistruar një numër procedimesh që përbën 1 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Përmet, Sarandë e Pukë nuk kanë regjistruar procedime penale lidhur me krimin kibernetik për vitin 2020.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Mashtrimi kompjuterik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” për vitin 2020 është 40,38 %, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 47,83 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik” në vitin 2020, prej 14,55 % në krahasim me vitin 2019.


### Falsifikimi kompjuterik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimin kompjuterik” është 21,15 % për vitin 2020, ndërsa në vitin 2019, ky tregues ka qenë 14,78. Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal, “Falsifikimi kompjuterik”, është rritur nga 17 në 33 procedime ose 94 %.

### Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimin kompjuterik” është 32,69 % për vitin 2020, ndërsa në vitin 2019, ky tregues ka qenë 26,96. Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal, “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, është rritur nga 31 në 51 procedime ose 64,52 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 76,92 % janë meshkuj madhorë, 46,15 % janë me arsim të lartë, 62,5 % të punësuar në sektorin privat.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për krimin kibernetik, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 67 % dhe koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton po në qarkun Tiranë me 12 procedime.

**Politika Penale:** Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjithë rastet është kërkuar dënim me burg dhe është vendosur nga gjykata dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 40 % të të pandehurve, 30 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 30 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 43 % të të pandehurve, në 43 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 14 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 111 ose 71,15 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019, ky tregues përbënte 80,87 % të procedimeve të regjistruara.

## TRAFIQET E PALIGJSHME


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,93 %, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 0,96 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 9,07 ndërsa në vitin 2019 ka qenë 10,31.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 36) rezulton se në vitin 2020 ka një ulje prej 12,54 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të trafikëve të paligjshme në krahasim me vitin 2019. Numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është ulur 28,57 % ndërsa në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale vërehet një ulje prej 10,53 % e të pandehurve të regjistruar, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 20 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 54,69 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafikëve për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Sipas gjinisë, rezultojnë se 2,5 % janë femra dhe 97,5 % janë meshkuj.

Në vitin 2020 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 3 shtetas të huaj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 50 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 50 % me arsim të mesëm.

Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve rezulton se 7,46 % janë të punësuar në sektorin privat, 5,96 % janë të punësuar në sektorin shtetëror dhe 86,58 % janë të papunë.


Rezulton se 51,95 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 48,05 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 83,10 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 16,90 % prej tyre rezultojnë përsëritës në vepra penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:





Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për trafiket e paligjshme, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, që përbën 16 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastër janë regjistruar 13 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat e Kukës janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës të shkallës së parë Elbasan janë regjistruar një numër procedimesh që përbën 4 % të totalit të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Korçë e Pogradec janë regjistruar një numër procedimesh që përbën 3 % të totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Lezhë, Lushnje, Dibër e Fier janë regjistruar një numër procedimesh që përbën 2 % të totalit të procedimeve të regjistruara, prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Kavajë, Krujë e Kurbin kanë regjistruar rreth 1 % të procedimeve penale të regjistruar në shkallë vendi, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Mat, Përmet, Pukë e Tropojë nuk kanë regjistruar procedime penale lidhur me trafiket e paligjshme për vitin 2020.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### **Trafikimi i personave të rritur**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” në vitin 2020 është 8,91 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave të rritur” në vitin 2020, prej 21,05 % në krahasim me vitin 2019, nga 19 në 23 procedime.

### **Trafikimi i të miturve**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” në vitin 2020 është 1,94 % ndërsa në vitin 2019 ka qenë 2,03 %.

Numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, në vitin 2020 është 5, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 6.

### **Trafikimi i mjeteve motorike**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 57,36 % për vitin 2020, ndërkohë që për vitin 2019 ka qenë 57,63 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal “Trafikimi i mjeteve motorike”, në vitin 2020, prej 12,94 % në krahasim me vitin 2019.

### **Trafikimi i armëve dhe i municionit**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 2,71 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, është ulur nga 10 procedime penale të regjistruara në vitin 2019, në 7 procedime penale në vitin 2020.

### **Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës**


Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafiqeve të paligjshme” është 0,39 %, që i korrespondon 1 procedimi penal, shifër e njëjtë në dy vitet e fundit.

### **Trafikimi i narkotikëve**

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër trafikëve të paligjshme” në vitin 2020 është 28,68 %, ndërkohë që në vitin 2019 ky tregues ka qenë 29,49 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal “Trafikimi i narkotikëve”, në vitin 2020 prej 14,94 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 97,50 % janë meshkuj, 50 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 86,58 % janë të papunë dhe 16,90 % janë të dënuar më parë.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për trafikët e paligjshme, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë 16 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun me Gjirokastrë 57 procedime dhe qarkun Vlorë me 26 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 94,55 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 92,59 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 20,69 % të të pandehurve, për

3,45 % të kërkesave rezultojnë për caktimin e dënimit në minimum, 44,83 % në marzhin mesatar dhe 31,03 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 28,57 % të të pandehurve, 57,14 % rezultojnë për caktimin e dënimit mesatar dhe 14,29 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita, ndërkohë që rezultojnë edhe 1 vendim pafajësie.

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 110 ose 42,64 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019, ky tregues përbënte 29,49 % të procedimeve të regjistruara.

### **VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PRODHIMIN DHE KULTIVIMIN E NARKOTIKËVE**


Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2020 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 6,18 %, ndërsa për vitin 2019 ka qenë 4,76 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.

Koeficienti i kriminalitetit për 100 000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2020 është 60,47, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 51,04.

### **TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 37) rezultojnë se në vitin 2020 ka një rritje prej 17,80 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2019 e ndërkaq kemi rritje prej 5,35 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2019 prej 13,97 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 18,36 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18,82 % përkundrejt vitit 2019.

Grafikisht tendenca e veprave penale për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 96,95 % të pandehur meshkuj të rritur (mbi 18 vjeç) nga të cilët 1,81 % meshkuj të mitur (14 deri 18 vjeç). Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 3,05 % femra të rritura dhe 3,45 % femra të mitura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 44,31 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 50,99 % me arsim të mesëm dhe 4,70 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Në vitin 2020 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 8 shtetas të huaj.


Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 13,63 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror 4,60 % dhe të papunë 81,77 %.

Rezulton se 56,88 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 43,12 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 92,86 % e tyre janë të padënuar më parë, 1,05 % janë përsëritës për të njëjtën vepër, ndërsa 6,09 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2020, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive:



Siç vërehet edhe nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore, numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve, është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Krujë, që përbën 24 % të numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi. Në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 20 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës e Elbasan e Fier janë regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan, Gjirokastër e Shkodër janë regjistruar 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës janë regjistruar 4 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi, në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Berat e Lezhë janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, në prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Korçë, Dibër, Kurbin, Lushnje, Sarandë, Kavajë e Tropojë është regjistruar një numër procedimesh që përbën 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash, ndërkohë që prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë Pogradec, Kukës, Përmet, Mat, e Pukë kanë regjistruar rreth 1 % të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve për vitin 2020.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Prodhimi dhe shitja e narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në këtë grup është 48,46 % për vitin 2020, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 57,02 %.


Nga të dhënat statistikore vihet re se për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2020 është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2019, konkretisht 834 procedime ndaj 833 (0,12 %).

### Kultivimi i bimëve narkotike

Pesha specifike që zë kjo veprë penale këtë grup është 51,42 % për vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2019 ka qenë 42,98 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike” në vitin 2020, prej 40,92 % në krahasim me vitin 2019.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2016-2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):



### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 96,95 % janë meshkuj, 50,99 % janë me arsim të mesëm, 81,77 % janë të papunë dhe 1,05 janë përsëritës për të njëjtën veprë dhe 6,09 % janë përsëritës për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale:** numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, është regjistruar në prokurorinë e shkallës së parë Krujë

24 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100 000 mijë banorë rezulton në qarkun Durrës me 165 procedime dhe qarkun Gjirokastrë me 152 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 78,14 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 73,33 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 35,88 % të të pandehurve, 15,78 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 48,34 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjkata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 47,40 % të të pandehurve, 21,09 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 31,51 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2020 është 693 ose 40,27 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2019, ky tregues përbënte 29,16 % të procedimeve të regjistruara.




## 2.10 TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK

Nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:

Në vitin 2020 janë përfunduar hetimet për 13805 të pandehur nga të cilët 11503 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2298 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve. Në vitin 2019 janë përfunduar hetimet për 14423 të pandehur nga të cilët 12158 janë dërguar në gjykatë ose 84 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2232 të pandehur janë pushuar hetimet ose për rreth 16 % të të pandehurve. Në vitin 2018 janë përfunduar hetimet për 16247 të pandehur nga të cilët 13403 janë dërguar në gjykatë ose 82 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2844 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 18 % të të pandehurve. Në vitin 2017 janë përfunduar hetimet për 16176 të pandehur nga të cilët 12808 janë dërguar në gjykatë ose 79 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3368 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 21 % të të pandehurve. Në vitin 2016 janë përfunduar hetimet për 17803 të pandehur nga të cilët 14746 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 3057 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2020:




### Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në dënimin e të pandehurve

Grafiku i mëposhtëm përmban të dhëna të detajuara lidhur me numrin e të pandehurve dënuar dhe ata që kanë marrë pafajësi në pesë vitet e fundit:




### Të dhëna mbi kërkesën e prokurorit dhe vendimet e gjykatës

Më poshtë paraqiten në përqindje të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës gjatë vitit 2020, lidhur me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë:




Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me dënimin “Burgim i përjetshëm” për periudhën 2016-2020:



Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2020 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur 20 % krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2018 në masën 58,33 %, në vitin 2018 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2017 në masën 7,69 %, në vitin 2017 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2016 në masën 45,8 %, në vitin 2016 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2015 në masën 26,3 %.

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2020 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2019 në masën 50 %, në vitin 2019 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2018 në masën 60 %, në vitin 2018 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2017 në masën 9 %, në vitin 2017 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2016 në masën 21,4 %, në vitin 2016 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2015 në masën 55,55 %.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin e të pandehurve me burgim sa maksimumi i** parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete për vitet 2016-2020:



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2020 ka një ulje prej 36,92 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 ka një ulje prej 57,52 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2018, në vitin 2018 ka një ulje prej 6,13 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2017, në vitin 2017 ka një ulje prej 48,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2016, në vitin 2016 ka një rritje prej 11,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin në vitin 2015.

Lidhur me vendimet e dënimit në maksimumin e masës së dënimit të parashikuar për veprën penale konkrete, gjatë vitit 2020 vërehet ulje prej 32,61 % krahasuar me vitin 2019, gjatë vitit 2019 vërehet ulje prej 52,08 % krahasuar me vitin 2018, gjatë vitit 2018 vërehet ulje prej 9,43 % krahasuar me vitin 2017, gjatë vitit 2017 vërehet e njëjta shifër me vitin 2016, gjatë vitit 2016 vërehet ulje në masën 22,6 % në krahasim me vitin 2015.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me masën e **dënimit me burgim në minimumin** e parashikuar nga ligji:



Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum, vihet re se në vitin 2020 kërkesat e prokurorit janë ulur me 12,60 % krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 kërkesat e prokurorit janë ulur me 4,60 % krahasuar me vitin 2018, në vitin 2018 kërkesat e prokurorit janë ulur me 27,64 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 kërkesat e prokurorit janë ulur me 15 % krahasuar me vitin 2016, në vitin 2016 kërkesat e prokurorit janë ulur me 27,7 % krahasuar me vitin 2015.

Vihet re se në vitin 2020 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 1,44 % krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 15,14 % krahasuar me vitin 2018, në vitin 2018 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 18,93 % krahasuar me vitin 2017, në vitin 2017 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 16,7 % krahasuar me vitin 2016, në 2016 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 10,2 % krahasuar me vitin 2015.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar **“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”** si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se në vitin 2020 ka një ulje prej 3,07 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2019 ka një ulje prej 4,51 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2018 ka një rritje prej 16,28 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg, në vitin 2017 ka një rritje prej 13 %, në vitin 2016 ka një ulje prej 1 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në krahasim me vitin 2015.

Ndërkohë që edhe vendimet e gjykatës në vitin 2020 kanë pësuar ulje prej 4,53 % në krahasim me vitin 2019.

**Në lidhje me dënimin me gjobë,** grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2016-2020:




Të dhënat statistikore tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë në vitin 2020 prej 27,20 % në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 rezulton ulje prej 11,97 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 rezulton rritje prej 12,98 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 rezulton ulje prej 48,4 % në krahasim me vitin 2016, po kështu vërehet ulje e kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë edhe në vitin 2016 prej 15,78 % në krahasim me vitin 2015.

Sa i përket të dhënave lidhur me vendimet e dënimit me gjobë, vihet re se në vitin 2020 ka një ulje prej 28,42 % në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 ka një ulje prej 11,92 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 ka një rritje prej 13,03 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 ka një ulje prej 43 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2016 ka rezultuar një ulje prej 18,2 % në krahasim me vitin 2015.

## 2.11 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2020

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në hetim<sup>37</sup> në pesë vitet e fundit (2016 – 2020):

<sup>37</sup> Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur çështjet e të cilëve janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë.



Në lidhje me të pandehurit e regjistruar në vitin 2020, nga të dhënat statistikore rezultojn se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2020 janë regjistruar 14151 të pandehur që do të thotë ulje prej 9,06 % në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 janë regjistruar 15561 të pandehur që do të thotë ulje prej 1,47 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 janë regjistruar 15793 të pandehur që do të thotë ulje prej 7,22 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 janë regjistruar 17022 të pandehur që do të thotë ulje prej 6,8 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2016 janë regjistruar 18264 të pandehur që do të thotë rritje prej 1 % në krahasim me vitin 2015.

Në lidhje me të pandehurit mbartur në hetim, duke marrë në referencë vitet 2016-2020 rezultojn se, në vitin 2020 janë mbartur hetimet për 8038 të pandehur që do të thotë rritje prej 15,70 % në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 janë mbartur 6947 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,60 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 janë mbartur 6281 të pandehur që do të thotë rritje prej 20,19 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017 janë mbartur 5226 të pandehur që do të thotë ulje prej 5,8 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2016 janë mbartur 5548 të pandehur që do të thotë ulje prej 15,3 % në krahasim me vitin 2015.


Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezultojn se, në vitin 2020 janë rifilluar hetimet për 46 të pandehur që do të thotë ulje prej 62,60 % në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 janë rifilluar hetimet për 123 të pandehur që do të thotë rritje prej 6,03 % në krahasim me vitin 2018, në vitin 2018 janë rifilluar hetimet për 116 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,48 % në krahasim me vitin 2017, në vitin 2017



janë rifilluar hetimet për 105 të pandehur që do të thotë ulje prej 34,8 % në krahasim me vitin 2016 dhe në vitin 2016 janë rifilluar hetimet për 161 të pandehur, shifër që është pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2015.


### Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2018-2020:



Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra në vitin 2020 është 95,09 % meshkuj dhe 4,91 % femra, në vitin 2019 raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 94,25 % meshkuj dhe 5,75 % femra dhe në vitin 2018 raporti i të pandehurve sipas gjinisë është 94,09 % meshkuj dhe 5,91 % femra.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2018-2020:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2020 rezultojnë 51,11 % e të pandehurve me arsim deri 9 vjeçar që përbën rritje në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 të pandehurit me arsim deri 9 vjeçar zënë 47,15 % të të pandehurve, që tregon ulje në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2018 rezultojnë 47,34 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën ulje në krahasim me vitin 2017.

Me arsim të mesëm në vitin 2020 rezultojnë 40,08 % e të pandehurve, që përbën ulje krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 rezultojnë 43,30 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor, që tregon ulje në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2018 rezultojnë 43,98 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që përbën rritje krahasuar me vitin 2017.

Me arsim të lartë, në vitin 2020 rezultojnë 9,55 % e të pandehurve shifër pothuajse në të njëjtin nivel në krahasim me vitin 2019, në vitin 2019 rezultojnë 9,55 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor, që tregon rritje në krahasim me vitin 2018 dhe në vitin 2018 rezultojnë 8,68 % e të pandehurve me këtë nivel arsimor që tregon rritje në krahasim me vitin 2017.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitet 2018-2020:




Për sa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2020 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 4,63 % e të pandehurve, në vitin 2019 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 4,62 % e të pandehurve dhe në vitin 2018 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 5,65 % e të pandehurve.

Të pandehurit e punësuar në sektorin privat në vitin 2020 përbëjnë 24,21 % të numrit të të pandehurve, në vitin 2019 përbëjnë 27,99 % të numrit të të pandehurve dhe në vitin 2018 të pandehurit e punësuar në sektorin privat përbëjnë 29,49 % të numrit të të pandehurve.

Në vitin 2020 rezultojnë 71,38 % e të pandehurve si të papunë, në vitin 2019 rezultojnë 67,38 % e të pandehurve si të papunë dhe në vitin 2018 rezultojnë 64,87 % e të pandehurve si të papunë.


Pra ajo që vërehet nga të dhënat statistikore është se gjatë tre viteve të fundit më shumë se 64 % e të pandehurve janë të papunë dhe ky është një nga faktorët kryesor kriminogjenë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve për vitet 2018- 2020:



Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat edhe për vitin 2020 ku tendencat tregojnë se 60,07 % e të pandehurve rezultojnë me vendbanim në qytet dhe 39,93 % rezultojnë me banim në fshat.

Grafiku në vijim paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2018-2020:




Për sa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2020 rezulton se 1,88 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale që do të thotë se ky tregues është rritur krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 rezulton se 1,78 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale që do të thotë se ky tregues është ulur krahasuar me vitin 2018 dhe në vitin 2018 rezulton se 2,77 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

Përsëritës për vepra penale të ndryshme në vitin 2020 rezulton se janë 7,42 % e të pandehurve, që do të thotë rritje krahasuar me vitin 2019, në vitin 2019 rezulton se janë 6,03 % e të pandehurve, që do të thotë rritje krahasuar me vitin 2018 dhe në vitin 2018 rezulton se janë 5,00 % e të pandehurve përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo për të cilën janë proceduar.

Të pandehurit e padënuar më parë në vitin 2020 përbëjnë 90,70 % të të pandehurve, të pandehurit e padënuar më parë në vitin 2019 përbëjnë 92,19 % të të pandehurve dhe në vitin 2018 përbëjnë 92,23 % të të pandehurve.

### Shtetësia e të pandehurve

Për sa i përket shtetësisë së të pandehurve, gjatë vitit 2020 rezulton se 1,13 % e tyre janë me shtetësi të huaj. Ky tregues rezulton në ulje 10,87 % krahasuar me numrin e të pandehurve të huaj të regjistruar në vitin 2019.



### Të miturit 2020

Gjatë vitit 2020, bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 478 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin.


Nga të dhënat rezulton se janë regjistruar 525 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale dhe ndaj 31 prej tyre është vendosur masë sigurimi arrest në burg, ose për rreth 5,90 % të të miturve.

Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, të dhënat tregojnë se është vendosur mosfillimi për 39 referime/kallzime penale, janë pushuar 199 çështje dhe janë dërguar për gjykim 146 çështje.

Shkaqet e vendimmarrjes në rastet e pushimit të çështjes, tregojnë se në 87,44 % të çështjeve janë vendosur masa alternative të shmangies dhe pjesa tjetër është pushuar për shkaqe të tjera proceduriale.

Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat rezulton se është aplikuar shmangia në 213 raste, ndër të cilat në 7 raste është vendosur ndërmjetësimi, në 4 raste këshillim për të miturin dhe familjen, në 13 raste është vendosur paralajmërim me gojë dhe në 189 raste është vendosur paralajmërim me shkrim.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me aplikimin e masave të shmangies:



### III. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

Gjatë vitit 2020, Prokuroria e Përgjithshme ka pasur në fokus të veçantë përmbushjen e detyrimeve në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në Eurojust. Prokurori i Përgjithshëm mori një rol proaktiv në procesin e caktimit të prokurorit ndërlidhës në Eurojust. Në këtë kuadër, pas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm është zhvilluar procedura e komandimit të një prokurori në pozicionin e prokurorit ndërlidhës pranë EUROJUST nga Këshilli i Lartë të Prokurorisë. Prokurori i Përgjithshëm përzgjedhi për pozicionin e prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust znj. Fatjona Memçaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në datën 17 dhjetor 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbi bazën e propozimit të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, vendosi komandimin e prokurores znj. Fatjona Memçaj në Eurojust. Prokurori ndërlidhës do t'i ushtrojë funksionet në zyrën e EUROJUST në Hagë për një periudhë prej 2 vjet e 6 muaj.

Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit, koordinimit të hetimeve dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me vendet e tjera evropiane.

Prej muajit Janar 2020, Pika e Kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme ka administruar në total 28 praktika (kërkesa për asistencë), nga të cilat 21 kërkesa janë dërguar nga prokurorët e vendeve të BE-së të atashuar në Eurojust, ndërsa 7 kërkesa janë përcjellë nga autoritetet vendase për në Eurojust nëpërmjet pikës së kontaktit në Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim përshpejtimin e dhënies së ndihmës juridike. Ndërkohë rezulton se 17 praktika janë përfunduar gjatë vitit 2020.

Më poshtë paraqiten treguesit në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale për vitin 2020, sipas fushave respektive.

#### I. Ekstradime

##### *i. Ekstradime nga jashtë*


Gjatë vitit 2020 janë trajtuar gjithsej 119 praktika ekstradimi, për shtetas shqiptarë apo të huaj të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga prokuroria shqiptare mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal “*arrest në burg*” të dhënë nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.

Këta shtetas janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të huaja, duke iniciuar kështu procedurën e ekstradimit për në Shqipëri.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, në raport me vitin e kaluar vërehet ulje e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e subjekteve nga jashtë, e konkretisht në masën 33,8 %.

Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2017-2020:

	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
<b>Nr. kërkesave për ekstradim</b>	194	171	180	119




Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2020, numri më i madh i i personave të arrestuar jashtë vendit me qëllim ekstradimi në Shqipëri vijon të jetë me shtete si, Italia me 31 raste, Greqia 25, Anglia 16, Gjermania 12, Franca 5, Belgjikë, Kosovë dhe Spanjë me nga 4 raste, Slloveni 3 etj.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*), si dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

Shteti	Viti 2019	Viti 2020
<b>Itali</b>	41	31
<b>Greqi</b>	39	25



Angli	13	16
Gjermani	11	12
Francë	11	5
Kosovë	6	4
Spanjë	7	4
Hungari	4	1
SH.B.A	4	1
Zvicër	4	0



*ii. Ekstradime për jashtë*

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2020 janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimi drejt shteteve të tjera 114 shtetas (shqiptarë apo të huaj), një tregues ky i cili i krahasuar me një vit më parë rezulton me ulje në masën 27,3%.

<b>Ekstradime për jashtë</b>			
<b>Viti 2017</b>	<b>Viti 2018</b>	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2020</b>
<b>145</b>	<b>128</b>	<b>157</b>	<b>114</b>

Vlen të theksohet se, për disa subjekte të arrestuar me qëllim ekstradimi në Itali, autoritetet italiane kanë paraqitur në 38 raste, kërkesë për njohjen e vendimeve penale duke konvertuar kështu, procedurën e ekstradimit me atë të njohjes me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të dhënë nga këto autoritete në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Gjatë vitit 2020 numri më i lartë i kërkesave të ekstradimit për shtetasit shqiptarë ose të huaj, të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë është paraqitur nga Italia<sup>38</sup> me 45 kërkesa (*pasi sikurse u cituar më lart 34 kërkesa janë paraqitur për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale italiane*), Gjermania 5 kërkesa, Maqedonia e Veriut 4 kërkesa, Austri, Kosovë dhe Kroaci përkatësisht nga 3 kërkesa, Franca 4, Bosnjë-Herzegovina dhe Sllovenia me nga 2 kërkesa, ndërsa shtete si SH.B.A, Britania e Madhe, Francë, Greqi, Oman, Bjellorusi, Indi etj. kanë paraqitur nga 1 kërkesë.


Të dhënat e mësipërme paraqiten në tabelën e mëposhtme dhe në grafikun krahasues (*ekstradime për jashtë*) për periudhën 2019-2020:

<b>Shteti</b>	<b>Viti 2019</b>	<b>Viti 2020</b>
<b>Maqedonia e Veriut</b>	1	4
<b>Serbi</b>	2	1
<b>Austri</b>	1	3
<b>Kroaci</b>	0	3
<b>Mali i Zi</b>	2	0
<b>Indi</b>	3	1

<sup>38</sup> Për vitin 2020 rezultojnë në total 79 praktika të regjistruara fillimisht si praktika ekstradimi të subjekteve nga Shqipëria në Itali, nga të cilat 38 praktika, me kërkesë të autoriteteve italiane janë konvertuar në praktika njohje dhe ekzekutim në Shqipëri të vendimeve penale italiane.

Francë	4	1
Gjermani	8	5
Zvicër	3	0
Kosovë	7	3
Itali	104	79

**Ekstradime për jashtë**




Theksojmë se, në kuadër të trajtimit të kërkesave të ardhura nga autoritetet e huaja gjatë vitit 2020 (për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuese apo për

njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë), mbështetur në ligjin 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 1079, datë 15.07.2020, “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së Planit të Veprimit ICRG/FATF” ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (përfshirë DPPPP, DPD e DPT) dhe Ministrisë së Brendshme, i është kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit e Krimit të Organizuar dhe Drejtorisë për Krimin Ekonomik dhe Financiar në Policinë e Shtetit, në **19 raste**, zbatimi i masave parandaluese kundër pasurisë së këtyre subjekteve.

## II. Letërporositë


### i. Letërporositë nga jashtë

Sa i takon kërkesave për ndihmë juridike në çështjet penale të ardhura nga autoritetet e huaja, gjatë vitit 2020 janë transmetuar gjithsej 550 letërporosi, tregues i cili rezulton me ulje në masën 12% krahasuar me vitin 2019, vit në të cilin janë transmetuar 625 letërporosi.



Duke iu referuar të dhënave statistikore konstatohet se, ashtu si vitet e kaluara numri më i lartë i kërkesave për ndihmë juridike ka ardhur nga shtetet kufitare si, Greqia me 102 letërporosi, Kosova 89, Gjermania 61 (*konstatohet rritje e numrit të letërporosive të dërguara nga ky shtet krahasuar me 1 vit më parë*), Portugalia 58, , Italia 40, Maqedonia e Veriut 23, Sllovenia 20, Franca 18 (*rritje e numrit të letërporosive krahasuar me vitin 2019*), Mali i Zi dhe Kroacia kanë dërguar nga 16 letërporosi, Belgjika 15 letërporosi, Spanja 13, Turqia 12, Austria 10, Hungaria 9 etj.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020 autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar në Shqipëri kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat<sup>39</sup> të grupuara sipas grupveprave penale rezultojnë:

- **35 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **trafiqeve të paligjshme** (*kryesisht trafikimi i lëndëve narkotike*), të cilat janë dërguar nga shtete si Austri, Belgjikë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Hollandë, Norvegji, Slloveni, Zvicër dhe Turqi;
- **67 letërporosi** të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të **falsifikimit të dokumenteve**, të cilat janë dërguar nga shtete si Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Mali i Zi, Hollandë, Portugali, Slloveni, Spanjë dhe Turqi;
- **15 letërporosi** për veprën penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**, nga shtete si Belgjikë, Francë, Hollandë, Itali, Gjermani, Rumani etj;
- **19 letërporosi** për veprën penale të **mashtimit**, nga shtete si Austri, Belgjikë, Gjermani, Greqi, Kosovë, Poloni, Rumani, Serbi, Spanjë, Mbretëri e Bashkuar dhe SH.B.A;
- **4 letërporosi** për veprat penale të **krimin kibernetik** të dërguara nga Gjermania, Rumania, Mbretëria e Bashkuar dhe SH.B.A;
- **1 letërporosi** për veprën penale të **dhunës në familje** e dërguar nga Spanja.

Vlen të përmendim se gjatë vitit 2020, DMJJ koordinoi zhvillimin me sukses të një komisioni rogator të kërkuar nga autoritetet belge të drejtësisë. Më konkretisht, këto autoritete nëpërmjet Zyrës së Oficerit Ndërlidhës në Tiranë kanë përcjellë drejtpërdrejt në Prokurorinë e Përgjithshme kërkesën për ndihmë juridike të Gjyqtarit Hetues pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Antëerpen, në kuadër të hetimeve, për kryerjen e veprës penale “*Pastrim i produkteve të veprës penale*” ndaj një shtetasi shqiptar, me objekt kryerjen e një sërë veprimesh hetimore si, *marrjen në pyetje, kontroll banese, përcjelljen e informacioneve në lidhje me pasuritë* etj. Ekzekutimi i kësaj letërporosie u realizua në muajin Tetor 2020, në prani të përfaqësuesve të autoriteteve belge.

Në tjetër aspekt i kërkesave për ndihmë juridike të autoriteteve të huaja është paraqitja e kërkesave me objekt ushtrimin në Shqipëri të ndjekjes penale për shtetasit shqiptarë. Të dhënat tregojnë se, gjatë vitit 2020 janë dërguar nga autoritetet e huaja gjithsej **19 kërkesa** për ndihmë juridike me objekt **ushtrimin në Shqipëri të ndjekjes penale** ndaj disa shtetasve, të cilat i janë transmetuar Prokurorive të Rretheve Gjyqësore sipas kompetencës. Më konkretisht, nga të dhënat rezultojnë se:


<sup>39</sup> Sipas të dhënave, të gjeneruara nga sistemi elektronik IMPRO

- Autoritetet **malazeze** kanë përcjellë **8 kërkesa** të tilla, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale “*Mosveprim sipas rregullave shëndetësore për evitimin e sëmundjeve të rrezikshme ngjitëse*” (4 kërkesa), “*Falsifikim dokumentesh*” (2 kërkesa), “*Lëndim i rëndë trupor*” dhe “*Shkelje e pacënueshmërisë së banesës*”, parashikuar nga legjislacioni penal malazez. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Lezhë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Tiranë;
- Autoritetet **franceze** kanë përcjellë **2 kërkesa** të tilla, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale “*Kanosja*” (1 kërkesë) dhe “*Përdhunimi i një vajze të mitur*”, parashikuar nga legjislacioni penal francez. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Shkodër dhe Lushnjë;
- Autoritetet **gjermane** kanë përcjellë **3 kërkesa** të tilla, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale “*Vjedhje*”, “*Vjedhje me dhunë në bashkëpunim*” dhe “*Përdhunim; lëndim i rrezikshëm fizik dhe privimi nga liria*”, parashikuar nga legjislacioni penal gjerman. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Fier dhe Lezhë;
- Autoritetet **greke** kanë përcjellë **2 kërkesa** me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale “*Trafikimi i lëndëve narkotike*” dhe “*Mbajtja e trafikimi i lëndëve narkotike*”, parashikuar nga legjislacioni penal grek. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Berat dhe Gjirokastrë;
- Autoritetet **austriake** kanë përcjellë **2 kërkesa të tilla**, me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale “*Vjedhje; Vjedhje e rëndë*” dhe “*Mbajtja, përdorimi i paligjshëm dhe trafikimi i lëndëve narkotike*”, parashikuar nga legjislacioni penal grek. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Autoritetet **kosovare dhe të Maqedonisë së Veriut** kanë përcjellë **përkatesisht nga 1 kërkesë** me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale në Shqipëri, për kryerjen e veprave penale “*Bashkësia jashtëmartesore me personin e moshës nën 16 vjeç*” dhe “*Vjedhja*”, parashikuar nga legjislacioni penal grek. Këto kërkesa i janë përcjellë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Fier dhe Dibër.

**ii. Letërporositë për jashtë**


Gjatë vitit 2020, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë i kanë drejtuar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 620 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruara ndaj shtetasve shqiparë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar ulje të lehtë me 2.9% krahasuar me vitin 2019, në të cilin janë dërguar 639 letërporosi.

<b>Letërporosi për jashtë</b>	
Viti 2019	Viti 2020
639	620



Sa i takon shpërndarjes gjeografike sipas Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore rezulton se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për periudhën raportuese ka dërguar jashtë vendit në funksion të hetimit 133 letërporosi, Prokuroria Durrës 87 letërporosi, Korça 63, Elbasani 52, Fieri 44 letërporosi, Lezha 34, Shkodra 32, Saranda 25 letërporosi etj. (të dhëna të cilat paraqiten në grafikun e mëposhtëm)





Të dhënat statistikore tregojnë se, numri më i madh i letërporosive i është dërguar shteteve kufitare dhe përkatësisht, Greqisë i janë dërguar 128 kërkesa, Italisë 127, Kosovës, 53, Gjermanisë 44, Mbretërisë së Bashkuar 44, Francës 26, Zvicrës 21, SH.B.A, Malit të Zi dhe Belgjikës 16 etj. Vlen të përmendim se, kërkesa për ndihmë juridike i janë dërguar edhe shteteve si, Kazakistan, Benin, Togo, Kamerun, Ganë, Indi etj.

Në tërësi rezulton që, gjatë vitit 2020 të jenë përfunduar/ekzekutuar gjithsej 157 kërkesa për ndihmë juridike përkatësisht nga shtete si, Austria, Greqia, Italia, Gjermania, Kroacia, Kosova, Franca, Spanja, Suedia, Polonia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, SH.B.A etj.

**iii. *Letërporositë sipas veprave penale në kompetencë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm***


Gjatë vitit 2020, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, të grupuara si më poshtë:

- **138 letërporosi për autoritetet e huaja (ose 22,2 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **trafiqeve të paligjshme**, përfshirë këtu trafikimin e personave të rritur, të të miturve, trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e mjeteve motorike;
- **132 letërporosi (ose 21,2 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprës penale të **pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**;
- **47 letërporosi (ose 7,5 % e totalit të letërporosive)** për kryerjen e veprave penale të **krimin kibernetik**, të cilat i janë drejtuar shteteve si, Kinë, Itali, Gjermani, SHBA, Britani e Madhe, Benin, Hollandë, Poloni etj;
- **121 letërporosi (ose 19,5 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **falsifikimit të dokumenteve**;
- **80 letërporosi (ose 12,9 % e totalit të letërporosive)** për veprat penale të **marshtrimit**;
- **18 letërporosi (ose 2,9 % e totalit të letërporosive)** në kuadër të procedimeve për kryerjen e **krimeve kundër jetës të kryera me dashje**;
- **2 letërporosi** për kryerjen e veprave penale të **dhunës në familje**.

### III. Njohjet e vendimeve penale

#### *i. Njohjet e vendimeve penale të huaja*


Referuar të dhënave statistikore rezulton se, për vitin 2020 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 58 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues ky i cili rezulton me rritje në masën 31,8 % krahasuar me vitin 2019, vit në të cilin është kërkuar njohja e vendimeve penale në 44 raste.

**Njohje Vendimesh Penale të Huaja**

Sikurse vërehet në tabelën e mëposhtme, Italia dhe Greqia kanë vijuar të zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje vendimi penal përkatësisht me 38 dhe 11 kërkesa, ndërsa Holanda 2 kërkesa dhe shtete si, Rumania e Gjermania, Belgjika dhe Mali i Zi kanë paraqitur sejcila nga 1 kërkesë për njohjen me qëllim ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal të dhënë prej tyre në ngarkim të shtetasve shqiptarë.


**Njohje vendimesh penale të huaja**

Shteti	Viti 2020
Gjermani	1
Rumani	1
Belgjikë	1
Mali I Zi	1
Hollande	2
Greqi	14
Itali	38



*ii. Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit*

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2020 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 12 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, tregues me ulje krahasuar me vitin 2019, në të cilin u paraqitën 20 kërkesa.



Në tabelën e mëposhtme, shihet qartë se numri më i lartë i kërkesave i është dërguar autoriteteve kosovare me 6 të tilla, duke vijuar më pas me nga 1 kërkesë drejtuar Greqisë, Italisë 3 kërkesa dhe Francës 2 të tilla.

### Kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit


VITI 2020

Kosovë	6
Greqi	1
Itali	3
Francë	2
<b>Totali</b>	<b>12</b>

#### IV. Transferimet e procedimeve penale

##### i. Transferimet e procedimeve penale

Gjatë vitit 2020, autoritetet e huaja gjyqësore kanë transferuar në Shqipëri 34 procedime penale me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale, ndërsa për periudhën raportuese prokuroritë shqiptare kanë transferuar jashtë vendit gjithsej 15 procedime penale (shih grafikun e mëposhtëm).



Sikurse vërehet nga të dhënat rezulton se, për periudhën raportuese është rritur numri i procedimeve penal të transferuara nga autoritetet e huaja në Shqipëri në raport me një vit më parë, ndërsa anasjelltas është ulur numri i procedimeve penale të transferuara nga Prokuroria shqiptare drejt autoriteteve gjyqësore të huaja.

Më konkretisht, autoritetet e huaja gjyqësore kanë paraqitur kërkesa për transferimin në Shqipëri të procedimeve penale të cilët në terma sasiorë paraqiten përkatësisht, Austria 1, Franca 1, Gjermania 1, Kosova 9, Mali i Zi 7, Maqedonia e Veriut 4 kërkesa, si dhe 11 kërkesa të ardhura nga shtete të tjera.

Ndërsa, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore shqiptare kanë vendosur transferimin e 15 procedimeve penale në total, përkatësisht 2 drejt Italisë, 9 drejt Kosovës, 2 Malit të Zi, 1 Spanjës dhe 1 Australisë.


Shtetet	Transferime procedimesh penale nga jashte	Transferime procedimesh penale per jashte
Austri	1	
France	1	
Gjermani	1	
Itali		2
Kosove	9	9
Mal i Zi	7	2
Maqedoni	4	
Spanje		1
Australi		1
Të tjera	11	
<b>Totali analitik</b>	<b>34</b>	<b>15</b>

## V. Transferimet e personave të dënuar

### i. Transferimet nga jashtë vendit të personave të dënuar


Gjatë vitit 2020 janë trajtuar 64 praktika për transferimin e subjekteve të dënuar nga jashtë ndër të cilat, 35 janë kërkesa të reja dhe për 29 kërkesa të regjistruara në muajin Dhjetor 2019, janë kryer veprimet procedurale në vitin 2020 .

Viti	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Transferimi i të dënuarve nga jashtë	9	4	34	35



*ii. Transferimet për jashtë vendit të personave të dënuar në Shqipëri*

Në vitin 2020 janë paraqitur 5 kërkesa për transferimin jashtë vendit të subjekteve të dënuar nga autoritetet shqiptare, duke konstatuar ulje krahasuar me vitin 2019, në të cilin është kërkuar transferimi nga 8 të dënuar.



**VI. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet shqiptare**

Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2020 Prokuroria Shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 150 shtetas (*shqiptarë apo të huaj*) të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë ose me vendim Gjykate është caktuar ndaj tyre masa e

sigurimit personal “Arrest në burg”. Krahasuar me vitin 2019, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 235 persona ky tregues ka pësuar ulje në masën 36,1 %.

Gjithashtu, prokuroria ka kërkuar që Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë me heqjen e 201 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar për shkaqe të ndryshme si, arrestimi i tyre në territorin shqiptar apo shuarja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit të dhënë me vendim të formës së prerë.



#### **VI. Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë**

Gjatë vitit 2020 janë trajtuar rreth **1106 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja. Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana ka njoftuar në **339 raste** (praktika) shpalljen e shtetasve shqiptarë në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e huaja, me të cilët Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje ekstradimi (*për ekstradimin e shtetasve shqiptarë*). Prokuroria e Përgjithshme për çdo rast i ka kërkuar ZQK Interpol Tiranës kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për identifikimin dhe lokalizimin në territorin shqiptar të këtyre subjekteve, në mënyrë që më pas të njoftohen autoritetet e huaja për të vlerësuar paraqitjen e kërkesës për transferimin e procedimeve penale apo njohjen e vendimeve penale të huaja në Shqipëri. Nga të dhënat statistikore rezulton se për periudhën raportuese janë përfunduar gjithsej 137 praktika. Sa i takon shteteve rezulton se, Greqia ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 51 shtetas shqiptarë, Belgjika 54, Gjermania 45, Franca 28, Holanda 8, Zvicra 10, Austria 9 etj.




#### IV. GARANTIMI INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka vijuar punën intensivisht dhe për vitin 2020, duke trajtuar çdo kërkesë të përcjellë nga institucionet përgjegjëse për verifikim të thelluar/plotë të të dhënave të pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit nga subjektet të këtij ligji.

**1.1** Për vitin 2020 janë regjistruar **109 procese** të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklarimit të subjekteve të këtij ligji. Këto, procese janë regjistruar në bazë të kërkesave të organeve kompetente për administrimin e formularëve të vetëdeklarimeve, si vijon:

- **44** (*dyzet e katër*) nga Departamenti Administratës Publike;
- **28** (*njëzet e tetë*) nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- **19** (nëntëmbëdhjetë) nga Këshilli i Emërimeve në Drejtesi;
- **8** (*tetë*) nga Këshilli i Lartë Gjyqesor;
- **4** (*katër*) nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;
- **2** (*dy*) nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- **4** (*katër*) nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- **1** (*një*) nga Lëvizja Qytetare Sopotit;
- **1** (*një*) nga Ministria e Punëve të Brendshme;
- **1** (*një*) nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.


*(Më poshtë gjeni grafikun ku pasqyrohen në përqindje kërkesat për verifikim sipas institucioneve përgjegjëse).*



Lidhur me këto kërkesa të regjistruara më vitin 2020:

- për 2 (dy) persona, kërkesat janë kthyer pasi nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në ligj;
- për 94 (nëntëdhjetë e katër) persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2020, duke miratuar rezultatet e verifikimit;
- për 13 (trembëdhjetë) persona, procesi i verifikimit ka vijuar për vitin 2021.

(Më poshtë grafiku)



Lidhur me nivelin hierarkik të funksionarëve publikë, të sjellë për verifikim të të dhënave në Formularët e Vetëdeklaruar, rezultojnë si më poshtë:

- **68** (gjashtëdhjetë e tetë) subjekte, “Zyrtar i Lartë” ;
- **19** (nëntëmbëdhjetë) subjekte, “Nivel Ekzekutiv”;

- 11 (katërbëdhjetë) subjekte, “Nivel Drejtues”;
- 11 (katërbëdhjetë) subjekte, “Nivel i Mesëm”;

(Më poshtë paraqitja grafike)



- Nga subjektet e ligjit, të cilëve iu ka mbaruar procesi i verifikimit të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, nga Departamenti Administratës Publike, rezultojnë të jenë në kushtet e ndalimit 4 subjekte, ndërsa për 2 subjekte ky institucion do të shprehet me vendimarrje pasi vendimet penale të marrin formën e prerë.
- Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë shqyrtuar 4 vendime verifikimi të thelluar dërguar në vitin 2020 nga Prokuroria e Përgjithshme (një prej të cilëve lidhur me verifikime të nisura në vitin 2019) dhe është vendosur si më poshtë:
  - Për 1 rast shpallja e pavlefshmërisë dhe përfundimi i parakohshëm i mandatit për anëtarë në këshillin bashkiak;
  - Për 1 rast është konstatuar se funksionari publik, anëtar në këshillin e bashkisë nuk përfshihet në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji nr.138/2015;
  - Për 2 raste KQZ ka deklaruar të përfunduar procedurën administrative për vendim përfundimtar për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur për shkak të dorëheqjes nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak.
- Për 5 (pesë) nga subjektet, gjatë verifikimit të të cilëve janë konstatuar elementë të veprave penale, materiali është **dërguar për kompetencë** në prokuroritë përkatëse.

**1.2** Gjatë vitit 2020, janë kryer edhe **55** (pesëdhjetë e pesë) procese të verifikimit të thelluar të të dhënave në formularët e vetëdeklaruar nga persona, subjekt të ligjit,

regjistruar në vitet 2016-2019 në bazë të kërkesave të bëra nga organet kompetente për administrimin e formularëve të vetëdeklarimeve, për të cilat rezultoi:

- për **43** (dyzet e tre) subjekte, procesi ka përfunduar dhe janë miratuar rezultatet e verifikimit, nga të cilat: 1 i vitit 2016, 5 të vitit 2018, dhe 37 të vitit 2019;
- për **12** (dymbëdhjetë) subjekte, procesi verifikimit ka vijuar për vitin 2021, nga të cilat: 3 nga viti 2017 dhe 9 nga viti 2019. (*Grafiku më poshtë në përqindje*).



Shkaku kryesor i vijimit të këtyre proceseve, është vonesa në kthimin e përgjigjeve, nga autoritetet e huaja policore dhe gjyqësore.

- Nga praktikat e viteve 2016-2019, të cilëve ju ka përfunduar procesi i verifikimit në vitin 2020, nga Departamenti Administratës Publike, rezultojnë të jenë në kushtet e ndalimit:
  - 1 subjekt ndjekur në bazë të kërkesës së vitit 2018;
  - 6 subjekte, ndjekur në bazë të kërkesave të vitit 2019, me vendimarrje të vitit 2020;
  - për 2 subjekte, DAP do të shprehet pasi vendimet penale për të cilët subjektet janë dënuar të marrin formën e prerë.
- Siç u paraqit edhe më lart, nga informacioni i KQZ, 1 subjekt ka dhënë dorëheqjen, pas vendimarrjes për miratimin e rezultateve të verifikimit.
- Për 8 nga personat, gjatë verifikimit të të cilëve janë konstatuar elementë të veprave penale, materiali **është dërguar për kompetencë** në prokuroritë përkatëse.

Pas disa vitesh veprimtari dhe problematikave të hasura, pavarësisht se ka qenë një vit i vështirë për shkak të pandemisë së krijuar nga Covid-19, është arritur të unifikohet praktika e punës, vendimarrja e Prokurorisë së Përgjithshme, marrëdhëniet me organet e tjera përgjegjëse për administrimin e formularëve të vetëdeklarimit si dhe të përfundohen shumë çështje në proces verifikimi të mbartura ndër vite.

## V. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORIVE PËR VITIN 2020

Ky raport është hartuar në përputhje me nenin 19 pika 1, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kanë sanksionuar se Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2020, numri i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve në juridiksionin e përgjithshëm është **321**<sup>40</sup>.

Shpërndarja e tyre në prokurori sipas niveleve ka qenë: 278 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 26 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 223 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 18 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 10 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që krahasuar me vitin 2019<sup>41</sup> përbëjnë ulje përkatësisht prej 18,77 % në numrin faktik total të prokurorëve.

Në vitin 2020 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për çdo prokurori paraqitet si vijon:

---

<sup>40</sup> 15 prokurorë u emëruan në Prokurorinë e Posaçme.

<sup>41</sup> Numri faktik i prokurorëve në janar 2019 ka qenë 309, përkatësisht 276 në shkallë të parë, 21 në prokuroritë e apeleve dhe 12 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë <sup>42</sup>	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	80	62	61.5	44	44	71	71	195	177
Berat	7	7	7	4	4	8	8	19	18
Dibër	6	4	4	2	2	7	7	15	13
Durrës	27	23	22.75	13	13	23	21	59	57
Elbasan	25	20	19.25	12	12	19	19	56	51
Gjirokastrë	7	4	4	3	3	11	11	21	18
Fier	14	13	13	8	8	17	17	39	38
Korçë	13	10	10	6	6	19	19	38	35
Krujë	7	5	5	4	4	6	6	17	15
Kukës	5	4	3.25	2	2	7	7	14	13
Lushnje	7	6	6	3	3	9	9	19	18
Lezhë	10	8	8	6	6	11	11	27	25
Mat	3	1	1	2	2	4	3	9	6
Përmet	2	2	2	1	1	4	3	7	6
Pukë	2	2	2	1	1	4	4	7	7
Pogradec	4	3	3.25	2	2	6	6	12	11

<sup>42</sup> Llogaritja e numrit efektiv është bërë sipas kohës reale të punës së prokurorit në prokurorinë përkatëse, ku:

Me pak se nje muaj (30 dite) =0 prokuror

Nga 1 në 3 muaj=0,25 prokuror

Nga 4 në 6 muaj=0,5 prokuror

Nga 7 në 9 muaj=0,75/prokuror

Nga 10 në 12 muaj=1 prokuror

Sarandë	7	6	6	4	3	7	7	18	16
Shkodër	19	15	14.50	11	10	21	21	51	46
Tropojë	3	3	3	1	1	4	4	8	8
Vlorë	19	16	16	11	9	17	17	47	42
Kavajë	7	6	6	3	2	7	7	17	15
Kurbin	4	3	3	2	2	7	7	13	12

Prokuroritë pranë gjykatave të apelit	Prokurorë			Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	9	6	5	8	8	17	13
Durrës	4	3	3	4	4	8	7
Gjirokastrë	2	1	1	2	2	4	3
Vlorë	5	4	4	4	4	9	8
Shkodër	4	2	1.5	4	4	8	6
Korçë	2	2	2	2	2	4	4

Prokuroria e Përgjithshme	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	17	10	10	70	31	79	62	166	103


Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa mesatare analizohet në vijim:

I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

### I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi

Gjatë vitit 2020, në organin e prokurorisë janë trajtuar 58466<sup>43</sup> materiale kallëzuese që përbën një ulje prej 2,37 % në krahasim me vitin 2019. Janë ndjekur gjithsej 44834 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 1,23 % në krahasim me vitin 2019, nga të cilat 27890 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 9,29 % në krahasim me vitin 2019 dhe 640 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 9,59 % në krahasim me vitin 2019. Janë mbartur, 16304 procedime penale me një rritje prej 25,83 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2019. Është vendosur mosfillimi për 13632 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 12,61 % në krahasim me vitin 2019.



**Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2020 sipas prokurorive është si më poshtë:**

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë ndjekur 2176 çështje;

Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë ndjekur 1178 çështje;


Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë ndjekur 5631 çështje;

<sup>43</sup> Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2020 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2020; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2020.




Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë ndjekur 4341 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë ndjekur 2705 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë ndjekur 1955 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë ndjekur 1050 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë ndjekur 2740 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë ndjekur 1777 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë ndjekur 808 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë ndjekur 811 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë ndjekur 1686 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë ndjekur 1620 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë ndjekur 287 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë ndjekur 301 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë ndjekur 937 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë ndjekur 178 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë ndjekur 2241 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë ndjekur 3611 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë ndjekur 17824 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë ndjekur 438 çështje;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë ndjekur 4171 çështje.

Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:





Në vitin 2020 raporti i numrit të çështjeve në hetim me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve, sipas prokurorive paraqitet në vijim:

**Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit organik**



**Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit faktik**






## I.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara<sup>44</sup> në vitin 2020 është si vijon:

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 816 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 539 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2511 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 2142 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 1446 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 776 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 495 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 1318 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 1003 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 455 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 478 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 892 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 719 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë regjistruar 162 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 161 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 504 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë regjistruar 83 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 808 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 1564 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 8862 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë regjistruar 167 procedime penale;  
 Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 1989 procedime penale.  
 Grafiku më poshtë paraqet të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2020:


<sup>44</sup> Përfshirë procedimet penale ushtarake

Procedime regjistruar 2020




Ndërkohë, numri i të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë, paraqitet në grafikun më poshtë:

Të pandehur regjistruar 2020




Raporti i numrit të çështjeve të regjistruara me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorive paraqitet në vijim:


Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit organik




Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit faktik




Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit efektiv





I.3 Në analizë të përqindjes që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës, të dhënat rezultojnë si më poshtë:





I.4 Në analizë të përqindjes që zënë raporti i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara dhe procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje, të dhënat rezultojnë si më poshtë:





## II. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka shqyrtuar 217 çështje themeli dhe 379 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar 73 çështje themeli dhe 138 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka shqyrtuar 71 çështje themeli dhe 289 çështje lidhur me masat e sigurimit;


Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar 198 çështje themeli dhe 272 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka shqyrtuar 279 çështje themeli dhe 1009 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shqyrtuar 232 çështje themeli dhe 434 çështje lidhur me masat e sigurimit.


Grafikisht të dhënat paraqiten si vijon, ku siç vërehet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe për vitin 2020 ka patur ngarkesën më të madhe:






Raporti i numrit të çështjeve me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorisë përkatëse paraqitet në vijim:


**Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit organik**



### Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit faktik



### Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit efektiv



## III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

### III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 4 çështje dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 1 çështje.

### III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Gjatë vitit 2020 janë marrë 90 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm gjatë hetimit paraprak.

### III.3 Akte nënligjore

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 janë nënshkruar këto Udhëzime të Përgjithshme:

- Udhëzim i Përgjithshëm nr.1, datë 31.01.2020, “Për një shtesë në udhëzimin nr.3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.2, datë 10.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.3, datë 19.03.2020 “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes COVID-19”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.4, datë 24.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.5, datë 08.04.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.6, datë 27.04.2020 “Mbi masat procedurale dhe administrative në veprimtarinë funksionale dhe mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së COVID-19”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.7, datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.8, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.10, datë 17.07.2020 “Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e asetëve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale” për krijimin e seksioneve të posaçme në prokurori dhe në strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese të tjera dhe rritjen/forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në procedurat standarde në veprimtarinë hetimore, polici/agjenci të tjera ligjzbatuese – prokurori;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.11, datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”;

- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.14 datë 21.09.2020 për “Ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.15, datë 30.10.2020 për “Trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.16, datë 14.12.2020, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.17, datë 23.12.2020, “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje”;
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.18, datë 31.12.2020, “Për masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit nga struktura e posaçme në zbatim të ligjit nr.138/2015 dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë”.

#### Akte të tjera normative të Prokurorit të Përgjithshëm:

- Urdhër nr.68, datë 04.05.2020 “Për përcaktimin e zonave të sigurisë në Prokurori”;
- Urdhër nr. 90, datë 19.06.2020 “Për krijimin e Komisionit për Shkatërrimin e Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” në Prokurorinë e Përgjithshme”;
- Urdhër nr.91, datë 19.06.2020 “Për kategoritë dhe llojet e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të cilat u nënshtrohen procedurave të asgjësimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe strukturat në varësi”;
- Urdhër nr.92, datë 19.06.2020 “Për krijimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Asgjësimin e Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në strukturat në varësi”;
- Udhëzim nr.9, datë 19.06.2020 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.81, datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në Prokurorinë e Përgjithshme dhe strukturat në varësi”;
- Urdhër nr.103, datë 17.07.2020, “Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019”;
- Urdhër nr.112, datë 27.07.2020, “Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”;
- Urdhër nr.118, datë 03.09.2020 “Për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në strukturat në varësi të saj”;

- Udhëzim nr.13 datë 18.09.2020 për “Kriteret për shpërblimin për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve”;
- Urdhër nr.124, datë 24.09.2020 për “Përcaktimin e formës së regjistrit dhe mënyrën e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore të çështjeve me të mitur, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”;
- Urdhër nr.164, datë 18.12.2020 “Për miratimin e rregulloreve standarde të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm;
- Urdhër nr.136, datë 28.10.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;
- Urdhër nr. 166, datë 22.12.2020 “Për krijimin e strukturës së sigurisë në zbatim të vkm nr. 542, datë 25.7.2019 “për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (ski)”;
- Urdhër nr.167, datë 22.12.2020 “Për krijimin e strukturës së sigurisë në zbatim të vkm nr. 542, datë 25.7.2019 “për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (ski)”.

#### Akte të përbashkëta:

- Marrëveshje Bashkëpunimi nr.2131 prot., datë 23.04.2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në sistemet elektronike të ISSH”;
- Memorandumi i Bashkëpunimit mes Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (përfshi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) dhe Ministrit të Brendshëm (përfshi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara) “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimit të aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF dhe planit të veprimit ICRG/FATF”;
- Memorandum Mirëkuptimi nr.1460 prot., datë 30.09.2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për zbatimin e nenit 59 të K.Pr.P. dhe referimeve që haptazi nuk përmbajnë elementë të veprave penale;
- Akt Koordinimi Ndërinstitucional nr.1813 prot. datë 15.12.2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;
- Marrëveshje Bashkëpunimi nr.1492 prot., datë 08.10.2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfiktit të Interesave;
- Marrëveshje Bashkëpunimi nr.584/1 prot., datë 24.09.2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

### III.4 Dekriminalizimi

Në Sektorin e Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2020 janë regjistruar 109 procese të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji.

Gjatë kësaj periudhe, për 163 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 41 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me këto kërkesa/procese të regjistruara më vitin 2020, për 2 persona, kërkesat janë kthyer pasi nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në ligj ndërsa për 94 persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2020, duke miratuar rezultatet e verifikimit.

### III.5 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2020, ka trajtuar:

- Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, në total 114 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 66 praktika;
- Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, në total 119 praktika, të përfunduara 50;
- Urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 339 praktika, të përfunduara 137;
- Letërporosi nga Jashtë, në total 550 praktika, 296 të përfunduara;
- Letërporosi për jashtë, 620 praktika, 153 të përfunduara;
- Shpallje e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar, 150 praktika;
- Heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar 201 praktika;
- Transferime të dënuesve nga jashtë, 35 praktika të reja dhe 64 praktika në total;
- Transferime të dënuesve për jashtë 5 praktika në total;
- Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 34 praktika;
- Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 15 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 58 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 12 praktika;
- Praktika të trajtuara në kuadër të strukturës policore Operacioni Forca e Ligjit (OFL), 308 praktika në total, nëpërmjet të cilave është kërkuar verifikimi dhe përcjellja e dokumentacionit për 951 shtetas shqiptarë dhe janë përfunduar gjithsej 96 praktika;
- Praktika të trajtuara në bashkëpunim me Eurojust, janë administruar në total 28 praktika (kërkesa për asistencë), nga të cilat 21 kërkesa janë dërguar nga prokurorët e vendeve të BE-së të atashuar në Eurojust, ndërsa 7 kërkesa janë

përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme në Eurojust, me qëllim lehtësimin e dhënies së ndihmës juridike në kohë reale;

- 1106 praktika të tjera si dhënie mendimi për projektligje të ndryshme, kontributet për raporte, kërkesa për informacion nga subjekte etj.

### III.6 Përgjimet

Gjatë vitit 2020 është përdorur përgjimi i komunikimeve elektronike nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake si mjet për sigurimin e provës në 630 procedime penale. Është realizuar përgjimi për 3816 paisje fundore në përdorim të 3535 subjekteve ndaj të cilëve ishte lejuar përgjimi.


Në 730 raste përgjimi është urdhëruar nga vetë prokurori, bazuar në nenin 222, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

Në total janë ekzekutuar nga Bërthama Komanduese Elektronike 1577 vendime të Gjykatës nga të cilat 563 janë vendime lejimi përgjimi marrë mbi kërkesën e prokurorit; 533 raste janë vendime të gjykatës e cila ka vleftësuar kërkesën e prokurorit për rastet kur është aplikuar neni 222, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, në 474 raste është miratuar nga gjykata zgjatja e afatit të lejimit të përgjimit dhe vetëm në 7 raste gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurorit për lejimin e përgjimit. Në 58 raste të lejimit të përgjimit, vetë prokurori ka urdhëruar ndërprerjen e tij me akt të motivuar.

Në përballje me volumin më sipër, oficerët e policisë gjyqësore të sektorit kanë mundësuar përgjimin dhe në përfundim rezulton të jenë prodhuar 14.733 procesverbale transkriptimi të shoqëruara nga 3601 CD/DVD.

#### IV. Ngarkesa në pesë vitet e fundit

Volumi në hetim në shkallë vendi në pesë vitet e fundit, paraqitet grafiksht në vijim:



Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2016	2017	2018	2019	2020
<b>Berat</b>	Volumi në hetim	1962	2122	1898	2212	2176
	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	7
	Mesatarja për prokuror	<b>327</b>	<b>354</b>	<b>316</b>	<b>369</b>	<b>311</b>
<b>Dibër</b>	Volumi në hetim	798	1228	987	943	1178
	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	<b>133</b>	<b>205</b>	<b>165</b>	<b>157</b>	<b>196</b>
<b>Durrës</b>	Volumi në hetim	4104	4678	5152	5812	5631
	Numri i prokurorëve	26	26	26	26	27
	Mesatarja për prokuror	<b>158</b>	<b>180</b>	<b>198</b>	<b>224</b>	<b>209</b>
<b>Elbasan</b>	Volumi në hetim	4023	3815	3788	4294	4341



	Numri i prokurorëve	25	25	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	<b>161</b>	<b>153</b>	<b>152</b>	<b>172</b>	<b>174</b>
<b>Fier</b>	Volumi në hetim	2688	2621	2871	2864	2705
	Numri i prokurorëve	14	14	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	<b>192</b>	<b>187</b>	<b>205</b>	<b>205</b>	<b>193</b>
<b>Gjirokastrë</b>	Volumi në hetim	1442	1577	1483	1786	1955
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	7
	Mesatarja për prokuror	<b>288</b>	<b>315</b>	<b>297</b>	<b>357</b>	<b>279</b>
<b>Kavajë</b>	Volumi në hetim	1203	1171	1047	1101	1050
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	<b>172</b>	<b>167</b>	<b>150</b>	<b>157</b>	<b>150</b>
<b>Korçë</b>	Volumi në hetim	2346	2465	2791	2864	2740
	Numri i prokurorëve	13	13	13	13	13
	Mesatarja për prokuror	<b>180</b>	<b>190</b>	<b>215</b>	<b>220</b>	<b>211</b>
<b>Krujë</b>	Volumi në hetim	1229	1051	1172	1335	1777
	Numri i prokurorëve	7	6	6	6	7
	Mesatarja për prokuror	<b>176</b>	<b>175</b>	<b>195</b>	<b>223</b>	<b>254</b>
<b>Kukës</b>	Volumi në hetim	912	781	699	666	808
	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	5
	Mesatarja për prokuror	<b>228</b>	<b>195</b>	<b>175</b>	<b>167</b>	<b>162</b>
<b>Kurbin</b>	Volumi në hetim	874	919	899	898	811
	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	<b>219</b>	<b>230</b>	<b>225</b>	<b>225</b>	<b>203</b>
<b>Lezhë</b>	Volumi në hetim	1894	1868	2127	1723	1686
	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	10
	Mesatarja për prokuror	<b>189</b>	<b>187</b>	<b>213</b>	<b>172</b>	<b>169</b>
<b>Lushnje</b>	Volumi në hetim	1702	1791	1617	1791	1620
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	<b>243</b>	<b>256</b>	<b>231</b>	<b>256</b>	<b>231</b>
<b>Mat</b>	Volumi në hetim	522	445	360	340	287
	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	<b>174</b>	<b>148</b>	<b>120</b>	<b>113</b>	<b>96</b>
<b>Përmet</b>	Volumi në hetim	279	240	214	224	301
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	<b>140</b>	<b>120</b>	<b>107</b>	<b>112</b>	<b>151</b>
<b>Pogradec</b>	Volumi në hetim	924	947	1034	1012	937
	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	<b>231</b>	<b>237</b>	<b>259</b>	<b>253</b>	<b>234</b>
<b>Pukë</b>	Volumi në hetim	322	280	230	299	178
	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	2
	Mesatarja për prokuror	<b>107</b>	<b>93</b>	<b>77</b>	<b>100</b>	<b>89</b>
<b>Sarandë</b>	Volumi në hetim	1605	1761	1849	2276	2241

	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	7
	Mesatarja për prokuror	<b>321</b>	<b>352</b>	<b>370</b>	<b>455</b>	<b>320</b>
<b>Shkodër</b>	Volumi në hetim	4526	3654	3357	3004	3611
	Numri i prokurorëve	19	19	19	19	19
	Mesatarja për prokuror	<b>238</b>	<b>192</b>	<b>177</b>	<b>158</b>	<b>190</b>
<b>Tiranë</b>	Volumi në hetim	18452	19541	18924	19168	17824
	Numri i prokurorëve	78	77	77	77	80
	Mesatarja për prokuror	<b>237</b>	<b>254</b>	<b>246</b>	<b>249</b>	<b>223</b>
<b>Tropojë</b>	Volumi në hetim	415	431	447	390	438
	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	<b>138</b>	<b>144</b>	<b>149</b>	<b>130</b>	<b>146</b>
<b>Vlorë</b>	Volumi në hetim	4458	4183	4121	4091	4171
	Numri i prokurorëve	20	20	20	20	19
	Mesatarja për prokuror	<b>223</b>	<b>209</b>	<b>206</b>	<b>205</b>	<b>220</b>

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

<b>Prokuroria e Apelit</b>	<b>Ngarkesa</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
<b>Durrës</b>	Volumi	1143	1182	761	761	596
	Numri i prokurorëve	5	5	5	4	4
	Mesatarja për prokuror	<b>229</b>	<b>236</b>	<b>152</b>	<b>190</b>	<b>149</b>
<b>Gjirokastrë</b>	Volumi	389	318	238	193	211
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	<b>195</b>	<b>159</b>	<b>119</b>	<b>97</b>	<b>106</b>
<b>Korçë</b>	Volumi	355	469	405	274	360
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	<b>178</b>	<b>235</b>	<b>203</b>	<b>137</b>	<b>180</b>
<b>Shkodër</b>	Volumi	1279	1110	1279	670	470

	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	<b>320</b>	<b>278</b>	<b>320</b>	<b>168</b>	<b>118</b>
Tiranë	Volumi	3919	3200	3113	2085	1288
	Numri i prokurorëve	9	9	9	9	9
	Mesatarja për prokuror	<b>435</b>	<b>356</b>	<b>346</b>	<b>232</b>	<b>143</b>
Vlorë	Volumi	1436	1261	1001	821	666
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	<b>287</b>	<b>252</b>	<b>200</b>	<b>164</b>	<b>133</b>

Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2016	2017	2018	2019	2020
Berat	Volumi në hetim	1962	2122	1898	2212	2176
	Numri i prokurorëve	6	6	6	5	7
	Mesatarja për prokuror	<b>327</b>	<b>354</b>	<b>316</b>	<b>442</b>	<b>311</b>
Dibër	Volumi në hetim	798	1228	987	943	1178
	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	4
	Mesatarja për prokuror	<b>133</b>	<b>205</b>	<b>165</b>	<b>157</b>	<b>295</b>
Durrës	Volumi në hetim	4104	4678	5152	5812	5631
	Numri i prokurorëve	25	25	25	26	23
	Mesatarja për prokuror	<b>164</b>	<b>187</b>	<b>206</b>	<b>224</b>	<b>245</b>
Elbasan	Volumi në hetim	4023	3815	3788	4294	4341
	Numri i prokurorëve	25	25	25	25	20
	Mesatarja për prokuror	<b>161</b>	<b>153</b>	<b>152</b>	<b>172</b>	<b>217</b>
Fier	Volumi në hetim	2688	2621	2871	2864	2705
	Numri i prokurorëve	14	14	14	14	13
	Mesatarja për prokuror	<b>192</b>	<b>187</b>	<b>205</b>	<b>205</b>	<b>208</b>
Gjirokastrë	Volumi në hetim	1442	1577	1483	1786	1955
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	4
	Mesatarja për prokuror	<b>288</b>	<b>315</b>	<b>297</b>	<b>357</b>	<b>489</b>

<b>Kavajë</b>	Volumi në hetim	1203	1171	1047	1101	1050
	Numri i prokurorëve	7	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	<b>172</b>	<b>195</b>	<b>175</b>	<b>184</b>	<b>175</b>
<b>Korçë</b>	Volumi në hetim	2346	2465	2791	2864	2740
	Numri i prokurorëve	12	11	11	11	10
	Mesatarja për prokuror	<b>196</b>	<b>224</b>	<b>254</b>	<b>260</b>	<b>274</b>
<b>Krujë</b>	Volumi në hetim	1229	1051	1172	1335	1777
	Numri i prokurorëve	7	5	5	4	5
	Mesatarja për prokuror	<b>176</b>	<b>210</b>	<b>234</b>	<b>334</b>	<b>355</b>
<b>Kukës</b>	Volumi në hetim	912	781	699	666	808
	Numri i prokurorëve	4	3	3	4	4
	Mesatarja për prokuror	<b>228</b>	<b>260</b>	<b>233</b>	<b>167</b>	<b>202</b>
<b>Kurbin</b>	Volumi në hetim	874	919	899	898	811
	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	3
	Mesatarja për prokuror	<b>219</b>	<b>230</b>	<b>225</b>	<b>225</b>	<b>270</b>
<b>Lezhë</b>	Volumi në hetim	1894	1868	2127	1723	1686
	Numri i prokurorëve	10	10	10	9	8
	Mesatarja për prokuror	<b>189</b>	<b>187</b>	<b>213</b>	<b>191</b>	<b>211</b>
<b>Lushnje</b>	Volumi në hetim	1702	1791	1617	1791	1620
	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	6
	Mesatarja për prokuror	<b>243</b>	<b>256</b>	<b>231</b>	<b>256</b>	<b>270</b>
<b>Mat</b>	Volumi në hetim	522	445	360	340	287
	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	1
	Mesatarja për prokuror	<b>174</b>	<b>148</b>	<b>120</b>	<b>113</b>	<b>287</b>
<b>Përmet</b>	Volumi në hetim	279	240	214	224	301
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	<b>140</b>	<b>120</b>	<b>107</b>	<b>112</b>	<b>151</b>
<b>Pogradec</b>	Volumi në hetim	924	947	1034	1012	937
	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	3
	Mesatarja për prokuror	<b>231</b>	<b>237</b>	<b>259</b>	<b>253</b>	<b>312</b>
<b>Pukë</b>	Volumi në hetim	322	280	230	299	178
	Numri i prokurorëve	2	2	2	3	2
	Mesatarja për prokuror	<b>161</b>	<b>140</b>	<b>115</b>	<b>100</b>	<b>89</b>
<b>Sarandë</b>	Volumi në hetim	1605	1761	1849	2276	2241
	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	6
	Mesatarja për prokuror	<b>321</b>	<b>352</b>	<b>370</b>	<b>455</b>	<b>374</b>
<b>Shkodër</b>	Volumi në hetim	4526	3654	3357	3004	3611
	Numri i prokurorëve	19	19	19	18	15
	Mesatarja për prokuror	<b>238</b>	<b>192</b>	<b>177</b>	<b>167</b>	<b>241</b>
<b>Tiranë</b>	Volumi në hetim	18452	19541	18924	19168	17824
	Numri i prokurorëve	77	76	76	77	62
	Mesatarja për prokuror	<b>240</b>	<b>257</b>	<b>249</b>	<b>249</b>	<b>287</b>

<b>Tropojë</b>	Volumi në hetim	415	431	447	390	438
	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	<b>138</b>	<b>144</b>	<b>149</b>	<b>130</b>	<b>146</b>
<b>Vlorë</b>	Volumi në hetim	4458	4183	4121	4091	4171
	Numri i prokurorëve	20	18	18	18	16
	Mesatarja për prokuror	<b>223</b>	<b>232</b>	<b>229</b>	<b>227</b>	<b>261</b>

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

<b>Prokuroria e Apelit</b>	<b>Ngarkesa</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
<b>Durrës</b>	Volumi	1143	1182	761	761	596
	Numri i prokurorëve	5	5	5	3	3
	Mesatarja për prokuror	<b>229</b>	<b>236</b>	<b>152</b>	<b>254</b>	<b>199</b>
<b>Gjirokastrë</b>	Volumi	389	318	238	193	211
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	1
	Mesatarja për prokuror	<b>195</b>	<b>159</b>	<b>119</b>	<b>97</b>	<b>211</b>
<b>Korçë</b>	Volumi	355	469	405	274	360
	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	<b>178</b>	<b>235</b>	<b>203</b>	<b>137</b>	<b>180</b>
<b>Shkodër</b>	Volumi	1279	1110	1279	670	470
	Numri i prokurorëve	4	4	4	2	2
	Mesatarja për prokuror	<b>320</b>	<b>278</b>	<b>320</b>	<b>335</b>	<b>235</b>
<b>Tiranë</b>	Volumi	3919	3200	3113	2085	1288
	Numri i prokurorëve	8	9	9	7	6

	Mesatarja për prokuror	<b>490</b>	<b>356</b>	<b>346</b>	<b>298</b>	<b>215</b>
<b>Vlorë</b>	Volumi	1436	1261	1001	281	666
	Numri i prokurorëve	5	5	5	4	4
	Mesatarja për prokuror	<b>287</b>	<b>252</b>	<b>200</b>	<b>70</b>	<b>167</b>

**VI. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS FINANCIARE DHE****ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL PËR VITIN 2020*****Të dhëna të përgjithshme mbi buxhetin e miratuar dhe realizuar për Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2020***

Me ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020”, u miratua buxheti për Prokurorinë e Përgjithshme, në vlerë 2.308.800 mijë lekë. Realizimi i buxhetit për vitin 2020, sipas artikujve kryesorë, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

(Në buxhetin e rishikuar për vitin 2020 janë përfshirë të gjitha rialokimet e kryera gjatë vitit)

në 000/lekë

Emertimi	Buxheti i miratuar për vitin 2020	Buxheti i Rishikuar për vitin 2020	Realizimi i buxhetit për vitin 2020	Raporti (në %) Realizim/Buxh et për vitin 2020
Paga	1.679.055	1.651.055	1.568.253	94.98%
Sigurime Shoqërore	229.595	189.595	162.584	85.75%
Shpenzime operative	270.000	328.000	320.330	97.66%
Transferta korentë të huaja	150	150	141	94.00%
Transferime tek individit	0	2.800	1.855	66.25%
Investime	130.000	130.000	127.208	97.85%
<b>TOTALI</b>	<b>2.308.800</b>	<b>2.301.600</b>	<b>2.180.371</b>	<b>94.73%</b>

***Shpenzime personeli***

Buxheti i miratuar për shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore) në fillim të vitit 2020 ishte 1.908.650 mijë lekë. Ky buxhet mbulon nevojat për paga dhe sigurime shoqërore për numrin e punonjësve të miratuar me ligj prej (928 punonjës). Buxheti i rishikuar (arsyet janë shpjeguar më lart) është 1.840.650 mijë lekë dhe është realizuar 94.98 %. Ky mos realizim vjen nga mungesa në plotësimin e strukturave (32 prokurorë, 44 oficerë të policisë gjyqësore, 44 administratë) si dhe për faktin që 22 prokurorë janë të pezulluar nga KPK-ja e që paguhen me 75 % të pagës.

### *Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative, përfshijnë shpenzime që kryhen nga prokuroritë në mbështetje të realizimit të detyrave të tyre funksionale si: letër, tonera, shtypshkrime, kancelari, udhëtime e dieta, energji, shpenzime postare, telefon, shpenzime transporti, shpenzime për mirëmbajtje të ndryshme (sidomos sistemet e IT dhe paisjet e Interceptimit), shpenzime për ruajtjen e godinave, avokatë ,përkthyes ekspertë të ndryshëm, shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, etj.

Edhe pse, ky zë i shpenzimeve, ka një peshë të ulët specifike, në buxhetin total të prokurorisë 14.25%, impakti i tij në aktivitetin e përditshëm të prokurorive dhe aparatit të Prokurorisë së Përgjithshme është i drejtpërdrejtë dhe shumë i rëndësishëm.

Për vitin 2020, buxheti i miratuar me ligj për shpenzime operative prej 270.000 mijë lekë ishte i pamjaftueshëm për të plotësuar gjithë nevojat e parashikuara për këtë zë të shpenzimeve të kërkuara edhe në Projektbuxhetin 2020-2022. Përdorimi me efikasitet të lartë i këtyre fondeve bëri që gjatë vitit 2020 të likujdojmë 84.1 milionë lekë fatura për grupin (avokatë, ekspertë, MKZ dhe fatura e kadastrës) të cilat pothuajse çdo vit rriten me rreth 100 milionë lekë.

Buxheti për shpenzime operative për vitin 2020 u realizua në masën 320.330 mijë lekë ose 97.66% e buxhetit të rishikuar.

### *Investime*

Përsa i përket investimeve, fondi i miratuar për investime për vitin 2020, ishte 130,000 mijë lekë. Në detajimin e fondit të investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë kërkesat buxhetore për vitin 2020, programi afatmesëm i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme për investimet në infrastrukturën ndërtimore të prokurorive, infrastrukturën elektronike etj., si dhe kërkesat që lindin gjatë vitit buxhetor.

Fondi i investimeve është realizuar në masën 127,208 mijë lekë ose 97.85% e buxhetit të rishikuar për vitin 2020.

### *Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm*

Për vitin 2020, sipas kalendarit vjetor të auditimeve, janë miratuar nga ana e titullarit, 13 angazhime auditimi gjithsej, nga të cilat 12 të kombinuara dhe 1 auditim tematik (pajtuueshmërie e të tjera), ndërkohë që janë kryer gjithsej 4 misione auditimi nga të cilat 4 misione të kombinuara.



Subjektet që u audituan janë prokuroritë e shkallës së parë Tiranë, Mat, Fier, Vlorë. Në fazën e planifikimit të angazhimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të mesëm, dhe aty është fokusuar auditimi. Fokusi i fushave prioritare, mbi të cilat janë fokusuar e materializuar programet e auditimit, kanë qenë si më poshtë:

- Prokurimet e fondeve publike dhe zbatimi i kuadrit rregullator për investimet;
- Në fushën e investimeve publike me financim të brendshëm;
- Administrimi i vlerave materiale e monetare;
- Shkelje, shpërdorime dhe mungesë dokumentacioni justifikues për shpenzimet e kryera për udhëtime e dieta;
- Zbatimi i rregullave të kontabilitetit publik, ruajtja dhe administrimi i pronës;
- Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimi i aseteve dhe burimeve nga subjektet e audituara etj.

Nga misionet e ushtruara në subjekte janë përcaktuar risqet kryesore të identifikuara dhe janë marrë masa për analizimin dhe trajtimin e këtyre risqeve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e komponentëve të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar Publik.

Nga misionet e auditimit për vitin 2020 në subjektet e audituara, janë dhënë 17 rekomandime, të strukturuar sipas kësaj tipologjie:

- a) 3 rekomandime për arkëtim të shumave që janë përfituar padrejtësisht;
- b) 14 rekomandime për masa të karakterit të ndryshëm.

### ***Shërbimi civil***

Gjatë vitit 2020 në Prokurorinë e Përgjithshme janë rekrutuar:

- 1 drejtor me status civil;
- 3 përgjegjës sektori;
- 6 specialistë;
- 4 sekretare.

Në drejtim të zbatimit të politikave ekzistuese për rritjen e kapaciteteve profesionale, është bashkëpunuar me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim. Punonjësit civilë kanë dërguar nevojat e tyre në fushat ku kanë të nevojshëm trajnimin si dhe është ndjekur procesi i trajnimit detyrues nga ata që kanë hyrë në shërbimin civil të prokurorisë.

Sa i përket disiplinës në shërbimin e prokurorisë, gjatë vitit 2020, janë zhvilluar procedurat disiplinore për 2 punonjës (nivel specialist dhe punonjës i shërbimeve mbështetëse) të cilëve u është dhënë masë disiplinore.

## VII. OBJKTIVA PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021

Me synim përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, si për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e mëtejshme të efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e çështjeve/akuzave në gjyq, për krime të rënda e sensitive, me shtrirje të gjerë dhe me tendenca në rritje dhe marrjen e masave për vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe respektimin e të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit në procesin penal, ashtu dhe në funksion të rritjes së kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, për përmirësimin e koordinimit dhe monitorimit të veprimtarisë së prokurorisë për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme e akteve të tjera normative, planeve të veprimit dhe/ose strategjive institucionale apo ndërinstitucionale të bazuar në rezoluta apo rekomandime të institucioneve kushtetuese sipas ligjit, si dhe përmirësimin e mbarëvajtjes së punës në administratën e prokurorisë, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, objektivat prioritare, masat dhe aktivitetet e prokurorisë për vitin 2021, janë si më poshtë:

**1. Përmirësimi i kuadrit ligjor, si për përqasjen e ligjit për prokurorinë me dispozitat kushtetuese lidhur me kompetencat e mbarëvajtjes së punës administrative të prokurorisë, ashtu dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së prokurorisë në ushtrimin e kompetencave kushtetuese e ligjore në hetimin, ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e çështjeve/akuzave në gjykatë, si dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:**

1.1 Inicimi i ndryshimeve në ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...” dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit...”, dhe jo vetëm, në bashkërendim dhe me asistencën e misioneve ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë (Projekti EURALIUS V, Projekti OPDAT, OSBE) lidhur me:

i) Përmirësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore dhe përfshirjen e Prokurorit të Përgjithshëm në procesin e caktimit, pezullimit apo shkarkimit të drejtuesve të prokurorisë, si dhe pajisjen e tij me instrumenta ligjorë të nevojshme për të ndërhyrë në mënyrë efikase, në veprimtarinë organizative të zyrave të prokurorisë, në raste të ngutshme, për të siguruar koordinimin dhe kohezionin institucional në mënyrë efektive, për përqasjen e ligjit nr.97/2016 dhe nr.96/2016 me nenin 148/b të Kushtetutës, dhe jo vetëm, dhe për të shmangur problematikat e evidentuara në ushtrimin e kompetencave ligjore të tyre të trajtuara në Raport;

ii) Emërimin apo shkarkimin e kancelarëve dhe këshilltarëve ligjor jomagjistrat (miratuar me ligjin 42/2021), si dhe përgjegjësitë në veprimtarinë dhe mbarëvajtjen e punës administrative të prokurorisë, për përjasjen e ligjit nr.97/2016 dhe ligjit nr.96/2016 me Kushtetutën, dhe për të shmangur problematikat e evidentuara në mbarëvajtjen e punës administrative në veprimtarinë e prokurorisë të trajtuar në Raport.

1.2 Inicimi i ndryshimeve në ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë...”, lidhur me:

i) Plotësimin e boshllëkut ligjor që evidentohet në nenin 103 pika 1 të ligjit nr.97/2016, i ndryshim, me synim përcilljen nga Ministri i Drejtësisë, drejtpërsëdrejti Prokurorisë së Posaçme, të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar, sipas kompetencës lëndore të tyre, plotësim i cili i është sugjeruar dhe Ministrisë së Drejtësisë, të trajtuar në Raport.

1.3 Inicimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Penal, lidhur me:

i) Shtimin e një neni “Pasurimi i paligjshëm”<sup>45</sup> si vepër penale në përjasje me nenin 20 të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit, e ratifikuar me ligjin nr.9492/2006, me synim për të ulur korrupsionin e nëpunësve publik dhe për të luftuar informalitetin.

ii) Plotësimin e nenin 287 të K.Penal me një paragraf shtesë, për të parashikuar në mënyrë të qartë një nocion të dyshimit (dyshonte se pasuria ishte e ardhur) dhe/ose neglizhencës (duhej të supozonte/mendonte se pasuria ishte e ardhur) nga krimi, në kontekstin e kësaj vepre penale, në përjasje me nenin 9 (3) të Konventës së KiE-së “Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit” e ratifikuar me ligjin nr.9646/2006, dhe sipas rekomandimit për Shqipërinë nga Konferenca e Palëve të kësaj Konvente të KiE-së në Tetor 2019, ashtu dhe në kuadrin e përafrimit të këtij neni të K.Penal me Direktivën (BE) 1673/201 të Parlamentit European dhe Këshillit datë 23 Tetor 2018 “Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit”, inicim i cili i është kërkuar dhe Ministrisë së Drejtësisë.

-Nisur nga fakti se, në zbatimin e masave prioritare më sipër për inicimin e ndryshimeve ligjore përfshihen edhe aktorë të tjerë të institucioneve të pavarura dhe ekzekutivit, kërkojmë vijimin e mbështetjes tuaj, me anë të mekanizmave kushtetues e ligjor që dispononi, për të mundësuar inicimin dhe/ose miratimin për zbatimin e tyre.

**2. Intensifikimi i koordinimit dhe monitorimit në ecurinë e zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020, për rritjen më tej, të efikasitetit të veprimtarisë ndërinstitucionale, dhe të efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale të**

<sup>45</sup> Shih, ligjin nr. 9492, datë 13.3.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Kombëve të Bashkuara kundër Korrupsionit”, e cila në nenin 20 “Pasurimi i paligjshëm” parashikon:

“Në përputhje me Kushtetutën dhe principet themelore të sistemit të tij ligjor, secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim pasurimin e paligjshëm, që është një rritje e madhe e pasurisë së një nëpunësi publik që ai ose ajo nuk mund ta justifikojë me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme.”

pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të ICRG/FATF, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:

2.1 Përmirësimi më tej i kapaciteteve profesionale ndërinstitucionale, në institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese të përfshira, nëpërmjet masave:

i) Përditësimi i manualit të Projektit të Binjakëzimit të BE “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri” me standartet dhe praktikatat e mira europiane, praktikën shqiptare dhe ide novative mbi tipologjitë dhe metodikën e hetimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në kuadrin e projektit FIIAPP spanjoll në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar të tjerë që asistojnë prokurorinë.

ii) Të vijojë puna e nisur për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese të përfshira, në bashkëpunim me misionet dhe projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

2.2 Rritja më tej e efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, nëpërmjet masave:

i) Rritja më tej e numrit të procedimeve të regjistruara për pastrim të parave dhe hetimeve financiare, si dhe përmirësimi i cilësisë dhe plotshmërisë së hetimeve dhe ndjekjes penale në funksion të rritjes së efektivitetit nëpërmjet rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë, në raport me çështjet e pushuara për këto vepra penale;

ii) Rritja më tej të hetimeve paralele, krahas hetimeve për veprën penale kryesore që gjeneron të ardhura nga veprimtaria kriminale ose veprimtaria terroriste, sipas rastit edhe për veprat penale pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit;

iii) Rritja më tej e hetimeve pasurore, krahas hetimeve për veprën penale që gjeneron të ardhura nga veprimtaria kriminale, dhe rritja e cilësisë dhe plotshmërisë së kërkesave, sipas rastit, për sekuestrim preventiv të pasurive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale dhe/ose sekuestrim në zbatim të ligjit nr.10192/2009 “antimafia”, lidhur me pasuritë e ardhura nga veprimtaria kriminale, si dhe rritja e kërkesave për konfiskimin e tyre.

**3. Forcimi i kapaciteteve institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe i kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorëve dhe policisë gjyqësore në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:**

3.1 Të vijojë puna e nisur për të shmangur efektet negative të vakancave nga ulja e numrit të prokurorëve në procesin e rivlerësimit kalimtar, nëpërmjet aktiviteteve:

i) Vijimi i bashkërendimit dhe koordinimit me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit

organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

ii) Të vijojë puna e nisur për shtimin në organikë të numrit të oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në prokuroritë përkatëse, bazuar në studimin e gjendjes dhe nevojave;

3.2 Përmirësimi i masave drejt standartizimit të procedurave të operimit në pikëpamje administrative për unifikimin e volumit të punës dhe normalizimin e veprimtarisë në prokurori, nëpërmjet aktiviteteve:

i) Përgatitja e një udhëzimi të përgjithshëm, “Për përcaktimin e normës/volumit orjentues të punës në prokurori”, me synim si për të përcaktuar normën e volumit të punës orientuese për prokurorët në sistemin e juridiksionit të përgjithshëm në përjasje me standartet europiane, ashtu dhe për të unifikuar volumnin e punës së pritshme për çdo prokuror dhe ndikuar në rishikimin e strukturtave organike dhe faktike të standardizuara në sistemin e prokurorisë.

3.3 Të evidentojmë shqetësimet dhe vështirësitë që ndeshin prokurorët dhe/ose oficerët e policisë gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve, si për kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, ashtu dhe për metodikat/protokollet e hetimit për vepra apo grupvepra penale, me synim për të bërë kërkimet e nevojshme, përfshi metodikat/protokollet e hetimit dhe praktikatat e mira në vende të BE-së, dhe në bashkëpunim e me mbështetjen e misionëve dhe projekteve ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë, organizimin e trajnimeve të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, krahas trajnimeve vazhduese të prokurorëve sipas programit në Shkollën e Magjistraturës.

i) Në kuadrin e Memorandumit të Bashkëpunimit me OSBE-në, përgatitja e një manuali për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore, dhe organizimi i trajnimeve për këtë grup veprash, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të prokurorisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit dhe përmirësimin e reagimit ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, me synim mbrojtjen e viktimave dhe në veçanti fëmijët dhe të miturit.

4. Përmirësimi dhe intensifikimi i veprimtarisë bashkërenduese, koordinuese dhe monitoruese të Prokurorisë së Përgjithshme në funksion të rritjes së kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë në përputhje me parashikimet ligjore, duke e vënë theksin tek masat dhe aktivitetet:

4.1 Rritja e veprimtarisë monitoruese dhe e bashkëpunimit me ILD dhe KLP në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore apo etike dhe problemeve të performancës së zyrave të prokurorive, nëpërmjet aktiviteteve;

i) Qasja proaktive nga strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, me prioritet mbledhjen dhe analizën e informacionit të përfutur për problematikat e evidentuara, në funksion të rritjes së bashkërendimit, koordinimit dhe bashkëpunimit institucional dhe ndërinstytucional, si dhe sigurimin e funksionalitetit normal të sistemit të prokurorisë;

ii) Rritja e kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorive nëpërmjet kërkimit dhe vlerësimit të informacioneve periodike nga drejtuesit e prokurorive;

iii) Përmirësimi i koordinimit dhe monitorimit të veprimtarisë së strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme apo akteve të tjera normative, planeve të veprimit dhe/ose strategjive institucionale apo ndërinstytucionale, të fokusura për zbatimin e rezolutave apo rekomandimeve të institucioneve kushtetuese sipas ligjit.

4.2 Të vijojë puna e nisur në bashkëpunim me Projektin EURALIUS V për përfundimin e projektudhëzimeve të përgjithshme në proces, përfshi dhe dy projektudhëzimet:

i) “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese përkatëse”;

ii) “Për krijimin dhe funksionimin e grupeve të hetimit për çështje të veçanta në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

**5. Intensifikimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstytucional me të gjithë aktorët e përfshirë në ndërveprim me sistemin e prokurorisë në të gjitha fazat e procedimit penal, për rritjen e efektivitetit në hetimin, ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzës në gjykatë dhe ekzekutimin e vendimeve penale ndaj autorëve të veprave penale me tendencë në rritje, veprave penale sensitive, dhe jo vetëm, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:**

5.1 Të vijojë përmirësimi më tej i efikasitetit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshjet dy ose shumë palëshe, nëpërmjet aktiviteteve:

i) Zgjerimi i thellimi i hetimeve dhe rritja e efikasitetit në ushtrimin e ndjekjes penale ndaj veprave penale në kompetencë të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm që do të ndihmojë e lehtësojë koordinimin e veprimtarisë hetimore me Prokurorinë e Posaçme dhe që do të jetë bazë e furnizimit të kësaj prokurorie me çështjet që lidhen me grupveprat penale të krimit të organizuar dhe/ose korrupsionit.

ii) Rritja e mëtejshme e bashkëpunimit në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë me autoritetet gjyqësore të huaja, si për të shkëmbyer informacion lidhur me veprimtaritë e grupeve kriminale që shtrijnë aktivitetin me lidhjet e tyre jashtë vendit, ashtu dhe rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin dhe goditjen e veprimtarisë së tyre brenda dhe jashtë vendit, me mbështetjen e Prokurorit Ndërlidhës Shqiptar të komanduar nga KLP-ja në selinë e Eurojust-it.

5.2 Puna e nisur për rritjen e aksesit të drejtpërdrejtë teknik të përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore dhe kompanive private, të vijojë, si në zbatim të kuadrit të ri ligjor në cilësinë e autoritetet të caktuar me ligj, për të kërkuar dhe mundësuar të drejtën e aksesit

në databazë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në regjistrin e pronarëve përfitues dhe në regjistrin qendror të llogarive bankare, etj, ashtu dhe për ato kërkesa që janë në proces për përgjigje në drejtim të realizimit të aksesit të drejtpërdrejtë në Regjistrin Noterial Shqiptar, dhe në Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbartimit Gjyqësor.

5.3 Të vijojë puna në grupet e punës institucionale dhe ndër-institucionale, ku përfshihen dhe përfaqësues të misioneve ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë (EURALIUS, OBDAT, PAMECA, OSBE, SIDA, etj) për realizimin e objektivave të përcaktuara në urdhërat përkatës, ashtu dhe të ngrihen e grupeve pune të reja për realizimin e masave të përcaktuara në këto objektivave prioritare.

**6.** Garantimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe viktimave të dhunës në familje, me bazë gjinore dhe të miturve, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të ligjshme të tyre, nëpërmjet aktiviteteve:

i) Nisja e një serie trajnimesh për prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe koordinatorë të viktimave për veprat penale dhuna në familje dhe me bazë gjinore në kuadrin e zbatimit të unifikuar të udhëzimit të përgjithshëm nr.18/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”, për rritjen e efikasitetit të kërkesave për masa dënimi më efektive, proporcionale e frenuese në këtë fushë, me synim që të kontribuojmë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të këtyre formave sensitive të kriminalitetit ndaj viktimave gra dhe të mitur.

ii) Përgatitja e një udhëzimi të përgjithshëm për të unifikuar praktikën në kryerjen e hetimeve dhe ndjekjen e çështjeve me të mitur, si dhe përdorimin e informacionit të Sistemit të Integruar të Çështjeve me të Mitur sipas ligjit, në dobi të shkurtimeve të afateve procedurale, zbatimit të masave të shmangies, marrjes së informacionit në shërbim të hetimit, ndjekjes dhe ekzekutimit/zbatimit të vendimmarrjes, me qëllim përmirësimin e saj në të ardhmen, si dhe mbledhjen e të dhënave të sakta që nevojiten për monitorimin, vlerësimin, raportimin dhe hartimin e politikave institucionale.

**7.** Të vijojë puna e nisur në grupin e punës me mbështetjen e Projektit EURALIUS V për identifikimin e problemeve në “sistemin e menaxhimit të çështjeve” (CAMS), dhe i masave konkrete të propozuara për përshtatjen e këtij sistemi sipas nevojave të organit të prokurorisë, për të mundësuar digjitalizimin, me prioritet:

7.1 Sigurimin e funksionalitetit të sistemit CAMS/modernizimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve me teknologji të avancuara.

i) Integrimi i rrjeteve;

ii) Vlerësimi i kapaciteteve humane dhe teknologjike, përlllogaritja e kostove dhe gjetja e financimeve, për vënien në funksionim të këtij sistemi apo në pamundësi, të një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve në prokurori.

7.2 Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit dhe përfundimit të të dhënave statistikore nëpërmjet një sistemi të automatizuar dhe funksional në sistemin e prokurorisë me

juridiksion të përgjithshëm në kuadrin e grupit të punës në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Projektit EURALIUS V.

**8.** Krijimi i sistemeve të vlerësimit të performancës dhe efikasitetit për administratën e prokurorisë dhe aplikimi i tyre në funksion të optimizimit të organizimit të punës administrative në prokurori për mbështetjen dhe lehtësimin e veprimtarisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore të tyre.

**9.** Të vijojë bashkërendimi dhe koordinimi me Komisionin e Policisë Gjyqësore, për hartimin e programeve të veçanta të trajnimit të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, bazuar në prioritetet dhe/ose shqetësimet lidhur me efektivitetin e hetimeve në zbatim të Kodit të Procedurës Penale dhe hetimeve pasurore në zbatim të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

**10.** Rritja e kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, dhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori, forcimin e kapaciteteve institucionale e profesionale dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në prokurori.

**Ju faleminderit!**

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**



**ANEKSI NR.1**  
**TABELA ME TË DHËNA E TREGUES STATISTIKORE SIPAS KRERËVE,**  
**SEKSIONEVE OSE GRUPVEPRAVE TË KODIT PENAL**

Tabela 1

Veprat penale të cilat parashikohen në Kreun II, Seksioni I, “Krime kundër jetës të kryera me dashje”:

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj. <sup>46</sup>	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 76 Vrasja <sup>47</sup>	33	11	23	18	7	32	7	25	12	15
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	49	21	50	31	9	47	7	39	9	11
Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje	0	0	0	0	0	7	1	2	1	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	36	17	34	26	14	27	11	29	14	6
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë	1	0	1	0	0	2	1	0	1	0
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	1	1	1	1	0	2	2	2	2	1
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	17	10	14	12	13	11	13	9	13	7
Neni 80	3	0	2	0	0	7	3	8	6	1
Neni 81 Vrasja e foshnjës	0	0	0	0		0	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	0	2	0	2	2	0	0	0	0	0
Neni 83 Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	0	0	0	1	1	3	1	5	3	4
Neni 83/a Kanosja për hakmarrje/gjakmarrje	3	1	0	1	0	4	1	3	1	1
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	263	44	97	50	37	338	54	142	61	25
<b>Totali</b>	<b>406</b>	<b>107</b>	<b>222</b>	<b>142</b>	<b>83</b>	<b>480</b>	<b>101</b>	<b>264</b>	<b>123</b>	<b>71</b>

<sup>46</sup> Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

<sup>47</sup> Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë 35 procedime regjistruar dhe 47 të pandehur regjistruar.

Tabela 2

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni II “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”:

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. në Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	7	5	7	12	2	8	5	8	12	5
<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>5</b>	<b>7</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>12</b>	<b>5</b>

Tabela 3

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i III “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit”:

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc . Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 86 Tortura	1	1	2	1	0	1	0	0	0	0
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje	103	59	107	72	42	114	53	106	63	41
Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë 266 psikike	0	0	0	0	2	0	2	0	2	2
Neni 88/b Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	1	1	1	1	2	2	1	1	1	0
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	771	255	462	330	198	716	244	460	316	191
Neni 89/b Përhapja e sëmundjeve infektive						1	0	0	0	0
Neni 89/a Shitblerja e paligjshme e organeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 90 Dëmtime të tjera	27	3	12	3	3	27	2	15	3	4
<b>Totali</b>	<b>903</b>	<b>319</b>	<b>584</b>	<b>407</b>	<b>247</b>	<b>861</b>	<b>302</b>	<b>582</b>	<b>385</b>	<b>238</b>

Tabela 4

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e II-të, Seksioni i IV “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia”:

2019	2020

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
	Neni 91 Plagosja e rëndë nga pakujdesia	4	1	2	1	0	16	1	2	1
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	7	0	0	0	0	1	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>

Tabela 5

Vepra penale të cilat parashikohen në seksionin V të kreut të dytë të Kodit Penal “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës”:

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZËNISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paaautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Neglizhenca në trajtimin mjekësor <sup>48</sup>	58	12	13	16	6	49	8	6	13	4
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	339	1	3	2	1	377	5	12	1	1
<b>Totali</b>	<b>399</b>	<b>13</b>	<b>16</b>	<b>18</b>	<b>7</b>	<b>426</b>	<b>13</b>	<b>18</b>	<b>14</b>	<b>5</b>

Tabela 6

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e VI të Kodit Penal “Krime Seksuale”:

KRIME SEKSUALE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. Në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur	28	13	26	23	9	22	9	17	9	18

<sup>48</sup> Dispozita është ndryshuar me ligjin 44/2019

Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	14	10	12	10	3	12	6	12	10	9
Neni 102 Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura	16	6	15	7	1	16	4	16	4	3
Neni 102/a Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 103 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	11	2	4	2	2	9	5	7	6	1
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 105 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari	3	0	4	0	0	2	2	0	2	2
Neni 107 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale ne vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 107/a Dhuna seksuale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	27	13	19	13	11	16	7	8	7	9
Neni 108/a Ngacnimi seksual	57	34	34	34	23	58	23	43	23	18
<b>Totali</b>	<b>158</b>	<b>78</b>	<b>115</b>	<b>89</b>	<b>49</b>	<b>136</b>	<b>56</b>	<b>104</b>	<b>61</b>	<b>60</b>

Tabela 7

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII “Vepra penale kundër lirisë së personit”:

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand . Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand . Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pan d dën uar
Neni 109 Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	7	0	4	0	0	14	3	15	5	0
Neni 109/a Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese	1	0	2	0	0	1	0	0	0	0
Neni 109/b Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë	68	6	37	9	6	56	22	34	33	8
Neni 109/c Zhdukja me forcë	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	20	10	15	27	9	27	12	18	20	12
Neni 111 Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 112 Dhunimi i banesës	13	3	3	4	4	17	3	5	3	3
<b>Totali</b>	<b>109</b>	<b>19</b>	<b>61</b>	<b>40</b>	<b>19</b>	<b>116</b>	<b>40</b>	<b>72</b>	<b>61</b>	<b>23</b>

Tabela 8

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e VIII të Kodit Penal “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”:

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjyka të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 113 Prostitucioni	12	4	13	23	28	11	4	10	14	6
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit	28	8	15	9	12	32	7	21	10	9
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion	3	0	4	0	0	3	2	3	2	0
Neni 117 Pornografia	8	2	0	3	1	11	2	2	2	1
Neni 118 Dhunimi i varreve	19	3	3	3	0	19	1	2	1	1
Neni 119 Fyerja	2	0	1	0	1	4	0	0	0	0
Neni 120 Shpifja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	14	3	7	3	0	13	3	4	3	0
Neni 121/a Përndjekja	188	91	123	92	85	130	80	81	82	57
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	1	0	0	0	1	2	0	1	0	0
<b>Totali</b>	<b>276</b>	<b>111</b>	<b>166</b>	<b>133</b>	<b>128</b>	<b>225</b>	<b>99</b>	<b>124</b>	<b>114</b>	<b>74</b>

Tabela 9

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e IX-të të Kreut të Dytë të Kodit Penal “Vepra Penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”:

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES <sup>49</sup>	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pan d. Dër g. Gjy k.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënu ar
Neni 124 Braktisja e fëmijëve të mitur	43	16	22	16	14	24	8	7	9	5
Neni 124/b Keqtrajtimi i të miturit	27	22	20	24	11	48	25	38	24	18

<sup>49</sup> Veçuar nga ky grup kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit dhe trajtuar te grupveprat penale të korrupsionit, si dhe trafikimi i të miturve i cili është trajtuar në grupveprat penale lidhur me trafiket.

Neni 125 Mosdhënia e mjeteve për jetesë	2	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit	4	3	2	3	3	3	0	0	0	0
Neni 127 Marrja e padrejtë e fëmijës	15	1	4	1	0	9	0	1	0	0
Neni 128 Ndërrimi i fëmijëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 128/a Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 129 Shtytja e të miturve në krim	2	1	0	1	0	1	1	1	1	0
Neni 130 Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë 130/a Dhuna në familje	6	1	3	1	0	15	5	11	5	0
	1140	834	1024	888	793	1251	914	1114	979	711
<b>Totali</b>	<b>1239</b>	<b>878</b>	<b>1075</b>	<b>934</b>	<b>821</b>	<b>1352</b>	<b>953</b>	<b>1173</b>	<b>1018</b>	<b>734</b>

Tabela 10

Vepra penale të parashikuara në seksionin e X-të të Kreut të dytë të Kodit Penal, veprat penale kundër lirisë së besimit.

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive të organizatave fetare	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 132 Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit	1	0	1	0	0	4	0	1	0	0
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Tabela 11

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e parë të Kreut të tretë të Kodit Penal, “Vjedhja e Pasurisë”:

VJEDHJA E PASURISË <sup>50</sup>	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar

<sup>50</sup> Veçuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiket

Neni 134 Vjedhja	8682	759	1028	950	758	7812	679	945	816	584
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	85	45	49	69	37	68	31	20	41	38
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit	16	0	2	0	2	6	1	2	2	0
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike	575	390	589	393	312	523	358	560	364	271
Neni 137 /a Vjedhja e rrjetit të komunikimeve elektronike	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	1	0	0	0	0	2	0	3	0	0
Neni 139 Vjedhja me dhunë	117	34	69	51	33	123	26	74	42	38
Neni 140 Vjedhja me armë	15	6	11	8	7	15	4	22	13	9
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	1	1	0	3	4	2	0	0	0	3
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	4	1	4	4	3	0	1	0	2	2
<b>Totali</b>	<b>9497</b>	<b>1236</b>	<b>1752</b>	<b>1478</b>	<b>1156</b>	<b>8551</b>	<b>1100</b>	<b>1626</b>	<b>1280</b>	<b>945</b>

Tabela 12

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e II, të Kreut të Tretë të Kodit Penal “Mashtrimet”:

MASHTRIMET	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. Pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënu ar
Neni 143 Mashtrimi	613	231	234	310	152	454	178	119	189	153
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale	0	0	0	0	0	2	0	0	1	0
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut	3	2	2	2	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/2 Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/3 Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/4 Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/6 Fshehja e pronësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshëm i titujve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 144 Mashtrimi në subvencione	2	0	0	0	0	1	0	0	2	0
Neni 144/a Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar	4	5	0	44	20	15	5	13	48	0
Neni 145 Mashtrimi në	32	23	27	23	40	31	23	26	24	17

sigurime										
Neni 146 Mashtrimi në kredi	16	5	7	9	15	37	6	2	6	4
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 149 Shkelja e të dejtave të autorit <sup>51</sup>	3	0	0	0	0	6	0	3	0	0
Neni 149/a Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale	15	4	6	4	3	17	11	6	13	4
Neni 149/b Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>690</b>	<b>270</b>	<b>276</b>	<b>392</b>	<b>230</b>	<b>564</b>	<b>223</b>	<b>169</b>	<b>283</b>	<b>178</b>

Tabela 13

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e III, të Kreut të III të Kodit Penal:

SHKATËRRIMI I PRONËS	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	543	32	129	44	32	506	47	58	45	21
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	509	21	47	23	19	471	28	38	23	15
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	56	5	10	8	0	33	2	6	2	1
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbytje	1	0	3	0	0	1	0	2	0	0
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera	8	1	4	2	2	7	0	1	0	0
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	3	2	7	6	3	15	1	2	1	5
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	24	0	2	0	1	15	1	0	1	0
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes	1	1	0	1	0	2	1	0	1	0
Neni 158	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësllësit	35	16	11	24	23	24	9	5	11	6
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore	0	0	0	0	0	4	0	0	0	0
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakuqdesia	78	8	17	8	3	62	10	15	10	6
Neni 162 Përplasia e mjeteve të transportit masiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>1258</b>	<b>86</b>	<b>230</b>	<b>116</b>	<b>83</b>	<b>1142</b>	<b>99</b>	<b>127</b>	<b>94</b>	<b>54</b>

Tabela 14

<sup>51</sup> Dispozita është ndryshuar me ligjin 44/2019



Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e IV të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare”:

VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
	Neni 163 Përpilimi i deklaratave të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164 Shpërdorimi i kompetencave	12	4	1	4	2	7	2	1	3	2
Neni 165 Falsifikimi i nënshkrimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 166 Emetimi i parregullt i aksioneve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 167 Mbajtja e padrejtë e dy cilësive	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Neni 168 Dhënia e informacioneve të rreme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 169 Zbulimi i sekreteve të shoqërisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 170 Mosbërja e shënimeve të detyrueshme	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 170/a Punësimi i paligjshëm	63	40	36	41	39	31	21	14	23	22
Neni 170/b Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës	1	1	1	1	0	3	2	8	4	0
<b>Totali</b>	<b>77</b>	<b>45</b>	<b>38</b>	<b>47</b>	<b>41</b>	<b>43</b>	<b>25</b>	<b>23</b>	<b>30</b>	<b>24</b>

Tabela 15

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE E FINANCIARE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
	Neni 170/c Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare	5	1	2	1	2	5	2	13	7
Neni 170/ç Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare	13	14	15	18	9	11	5	9	5	12
<b>Totali</b>	<b>18</b>	<b>15</b>	<b>17</b>	<b>19</b>	<b>11</b>	<b>16</b>	<b>7</b>	<b>22</b>	<b>12</b>	<b>19</b>

Tabela 16

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin V të Kreut të II të Kodit Penal:

KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar

Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	2	0	1	0	0	3	2	3	3	7
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	20	15	22	18	9	29	13	26	19	10
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licencuar	2	3	1	4	3	8	2	6	2	1
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	43	28	41	36	21	35	20	19	25	18
Neni 175 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore	4	0	0	3	0	4	1	0	1	2
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	12	3	11	3	2	4	4	4	3	3
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	40	27	33	41	26	35	21	38	45	16
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	12	8	9	8	5	5	5	4	5	6
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	22	18	22	18	18	40	27	33	32	14
Neni 179/b Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore	0	0	0	0	0	1	1	2	2	2
Neni 179/c Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet	3	0	2	0	0	0	1	0	1	0
Neni 179/ç Kontrabanda e kapitenit, pilotit ose ekuipazhit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>160</b>	<b>102</b>	<b>142</b>	<b>131</b>	<b>84</b>	<b>164</b>	<b>97</b>	<b>136</b>	<b>138</b>	<b>79</b>

Tabela 17

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun III, Seksionin e VI “Veprat penale në lidhje me taksat e tatimet” i Kodit Penal:

VEPRA PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT E TATIMET	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	273	61	120	74	55	168	46	60	57	35
Neni 180/a	17	3	7	3	5	30	6	4	6	3
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	102	34	42	48	29	90	43	34	61	34
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	2	0	1	0	0	1	0	0	0	1
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	4	0	2	0	1	1	0	0	0	1
Neni 182/a	17	5	4	5	6	10	12	8	12	7
<b>Totali</b>	<b>415</b>	<b>103</b>	<b>176</b>	<b>130</b>	<b>96</b>	<b>300</b>	<b>107</b>	<b>106</b>	<b>136</b>	<b>81</b>

Tabela 18

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreu III, Seksioni VII “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” i Kodit Penal:

FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pan d. Regj	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënu ar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand Regj	Nr. Pand në gjyk.	Nr. Pand dënu ar
Neni 183 Falsifikimi i monedhave	82	24	37	25	21	75	21	22	23	20
Neni 184 Falsifikimi i letrave me vlerë	3	0	0	0	2	3	0	1	0	0
Neni 185 Prodhimi i mjeteve për falsifikim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>85</b>	<b>24</b>	<b>37</b>	<b>25</b>	<b>23</b>	<b>78</b>	<b>21</b>	<b>23</b>	<b>23</b>	<b>20</b>

Tabela 19

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin e VII të Kreut të III të Kodit Penal “Falsifikimi i dokumenteve”:

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	648	197	179	221	108	397	83	92	127	118
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	25	7	10	10	31	25	10	14	11	7
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	25	14	13	14	12	9	3	4	3	6
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	323	196	220	199	122	156	101	120	115	118
Neni 190 Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	125	53	44	58	40	119	59	40	71	46
Neni 191 Falsifikimi i akteve të gjendjes civile	14	3	2	3	2	6	2	1	3	1
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	3	0	0	0	0	2	0	0	0	2
<b>Totali</b>	<b>1163</b>	<b>470</b>	<b>468</b>	<b>505</b>	<b>315</b>	<b>714</b>	<b>258</b>	<b>271</b>	<b>330</b>	<b>298</b>

Tabela 20

Vepra penale të parashikuara në seksionin e IX-të të Kreut të tretë të Kodit Penal, veprat penale në fushën e falimentimit.

VEPRA PENALE NË	2019	2020
-----------------	------	------

FUSHËN E FALIMENTIMIT	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
	Neni 193 Falimentimi i provokuar	0	0	0	0	0	1	0	3	0
Neni 194 Fshehja e gjendjes së falimentimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 195 Fshehja e pasurisë pas falimentimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 196 Shkelja e detyrimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Tabela 21

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e III, seksioni X i Kodit Penal “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit”:

ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 197 Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin <sup>52</sup>	133	55	56	59	64	122	54	137	64	45
Neni 197/a Paracaktimi i rezultatit në garat sportive	1	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 197/b Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 198 Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara	10	3	2	4	4	5	3	3	4	4
<b>Totali</b>	<b>144</b>	<b>58</b>	<b>58</b>	<b>63</b>	<b>68</b>	<b>128</b>	<b>58</b>	<b>141</b>	<b>69</b>	<b>49</b>

Tabela 22

Vepra penale të cilat parashikohen në Seksionin XI, të Kreut të III të Kodit Penal “Vepra Penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës”:

RREGJIMI JURIDIK I TOKËS	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	44	2	1	2	3	52	5	26	5	1
Neni 199/a Ndërtimi i paligjshëm	1743	935	1043	953	648	1586	919	967	931	730
Neni 199/b Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm	3	0	5	4	9	2	1	3	6	7

<sup>52</sup> Dispozita është ndryshuar me ligjin 44/2019

Neni 200 Pushtimi i tokës	119	49	40	58	37	109	21	37	25	14
<b>Totali</b>	<b>1909</b>	<b>986</b>	<b>1089</b>	<b>1017</b>	<b>697</b>	<b>1749</b>	<b>946</b>	<b>1033</b>	<b>967</b>	<b>752</b>

Tabela 23

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”:

VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT <sup>53</sup>	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 201 Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës	36	20	29	24	10	41	25	36	26	13
Neni 201/a Menaxhimi i mbetjeve	0	0	0	0	0	5	0	1	0	0
Neni 201/b Transportimi i mbetjeve						1	0	2	0	0
Neni 201/c Aktivitetet e rrezikshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 201/ç materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme						0	0	0	0	0
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	0	0	0	0	0	3	0	2	0	0
Neni 202/a Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 202/b Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore	0	0	0	0	0	24	2	18	3	0
Neni 203 Substancat ozonholluese	8	0	1	0	1	6	0	0	0	0
Neni 204 Peshkim i ndaluar	5	3	5	3	4	9	4	14	5	3
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	163	40	74	43	30	185	30	64	33	28
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	20	0	5	0	2	16	1	2	1	1
Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	14	0	1	0	0	20	0	2	0	0
Neni 206/b Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	13	2	5	2	1	4	0	0	0	0
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	5	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 207/a Braktisja e kafshës së shoqërimit	1	1	1	1	0	9	1	2	1	2
Neni 207/b Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit						1	0	0	0	0
Neni 207/c Keqtrajtimi i kafshës	1	0	0	0	0	3	1	1	1	0
Neni 207/ç Ndeshjet ndërmjet kafshëve						0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>266</b>	<b>66</b>	<b>121</b>	<b>73</b>	<b>48</b>	<b>331</b>	<b>64</b>	<b>144</b>	<b>70</b>	<b>47</b>

<sup>53</sup> Në këtë kre, me ligjin 44/2019, është ndryshuar neni 201, janë shtuar nenet 201/a deri 201/ç, është ndryshuar neni 202, janë shtuar nenet 202/a dhe 202/b, është ndryshuar neni 203, janë shtuar nenet 207/a deri 207/ç

	2019	2020
<b>VEPRA PENALE</b>		

Tabela 24

	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
<b>KREU V - KREU VI</b>										
Krime kundër Pavarësisë e Rendit Kushtetues	4	2	2	2	0	7	1	1	1	1
Krime që cenojnë Marrëdhëniet me Shtetet e tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

Tabela 25

	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 230 Vepra me qëllime terroriste	3	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 230/a Financimi i terrorizmit	3	0	4	0	0	2	0	1	0	0
Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 231 Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232 Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	6	2	3	2	1
Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/a Organizata terroriste	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/b Banda e armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>1</b>

Tabela 26

	2019					2020				
KRIMI I ORGANIZUAR	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. Pand. Regj	Nr. Pand. për gjykim	Nr. Pand. dënuar
Neni 333 Organizata kriminale	0	0	0	0	0					
Neni 333/a Grupi i strukturuar kriminal	51	13	111	126	13	1				
Neni 334 Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	0	0	0	0	0					
<b>Totali</b>	<b>51</b>	<b>13</b>	<b>111</b>	<b>126</b>	<b>13</b>					

Tabela 27

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e VIII, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit”:

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	38	19	26	22	21	36	21	27	27	16
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	181	124	379	237	108	197	166	251	304	166
Neni 237 Goditjet për shkak të detyrës	94	66	90	89	57	100	68	84	78	66
Neni 238 Kanosja për shkak të detyrës	48	3	16	5	2	41	15	29	18	10
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik	210	145	164	159	137	276	179	217	189	150
Neni 242/a						20	2	12	2	0
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore	3	0	0	0	0	4	3	2	3	1
Neni 246/a Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	7	3	3	3	2	7	4	5	4	4
<b>Totali</b>	<b>581</b>	<b>360</b>	<b>678</b>	<b>515</b>	<b>327</b>	<b>681</b>	<b>458</b>	<b>627</b>	<b>625</b>	<b>413</b>

Tabela 28

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreu VIII, Seksioni II, “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetërorë ose në Shërbim Publik”:

VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pan. d. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 248 Shpërdorim detyre	881	82	234	186	92	606	78	110	161	78
Neni 248/a Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij	4	1	2	1	0	2	0	1	0	0
Neni 250 Kryerja e Veprimeve arbitrare	36	5	10	8	6	36	6	9	7	1



Neni 251 Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 252 Mbajtja në burg pa vendim	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazisë së shtetasve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 254 Shkelja e paprekshmërisë së banesës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 256 Shpërdorim i kontributeve të dhëna nga shteti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 257 Përfitim i paligjshëm i interesave	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 257/a Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë	11	6	2	6	6	4	1	0	1	2
Neni 258 Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike	8	1	0	6	0	3	1	0	10	0
<b>TOTALI</b>	<b>941</b>	<b>95</b>	<b>248</b>	<b>207</b>	<b>104</b>	<b>652</b>	<b>86</b>	<b>120</b>	<b>179</b>	<b>81</b>

Tabela 29

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun VIII, Seksioni III, “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”:

VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	51	4	95	9	0	20	1	105	11	2
Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0
Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve	4	0	0	0	0	6	1	5	4	1
Neni 265/a Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 265/b Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 265/c Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	4	0	1	0	0	7	1	1	1	0
Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	2	2	24	24	7	1	1	1	1	18
Neni 271 Disinformimi i ekipeve të urgjencës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	19	3	4	3	5	18	8	7	8	1
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	268	81	75	87	58	300	78	76	83	56
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	93	41	68	52	38	70	25	37	32	27
Neni 274/a Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv	1	0	0	0	0	4	4	6	7	1
Neni 274/b Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive						7	4	8	6	4
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrjeve telefonike	384	27	55	29	23	345	34	55	36	16
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 277 Vetëgjyqësia	228	86	97	101	64	230	91	87	102	58
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	361	183	259	216	183	313	160	250	181	163
Neni 278/b Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore ose kimike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	90	71	93	79	59	106	55	91	58	44
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive	50	21	36	23	26	52	29	39	30	15
Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lëndët helmuese	3	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 282 Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese	5	1	3	1	1	3	2	2	2	0
Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të tjera të rrezik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
282/c	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës	0	0	0	0	0	1	0	0	0	
Neni 284/ç Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/d Prodhimi dhe tregtimi i barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin	3	0	12	0	0	0	3	0	5	3
Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge	5	3	6	4	0	0	3	2	3	4
Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave	0	1	0	2	0	0	0	0	0	0
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Importimi, prodhimi, shitja dhe ruajtja e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve	5	0	2	0	2	10	3	2	3	2

Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrial dhe ushqimorë	22	20	16	21	17	7	3	6	3	3
Neni 288/b Tregtimi dhe hedhja për konsum e lëndëve djegëse në kundërshtim me standardet ligjore të cilësisë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288/c mashtrimi me produktet ushqimore						2	0	3	0	0
Neni 288/ç Prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore						0	0	0	0	0
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	104	14	34	18	12	101	10	40	16	6
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	929	296	665	311	272	796	317	540	325	214
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	2841	2467	2948	2490	2002	2815	2565	2953	2574	2008
Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport	3	0	1	0	0	1	0	1	0	0
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	14	0	4	1	0	9	3	6	3	2
Neni 293/d Shitja e paautorizuar e kartave SIM	1	0	0	0	0	0	2	0	2	1
<b>Totali</b>	<b>5491</b>	<b>3322</b>	<b>4499</b>	<b>3472</b>	<b>2769</b>	<b>5227</b>	<b>3403</b>	<b>4325</b>	<b>3496</b>	<b>2649</b>

Tabela 30

Vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale:

PASTRIMI I PARAVE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pan. d. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. pand. Regj	Nr. Pan. d. në gjyk.	Nr. Pan. d. dënuar
Neni 287 Produktet e veprës penale ose veprimtarisë kriminale	232	19	32	31	9	279	17	65	30	10
Neni 287/a Llogari anonime	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1
Neni 287/b Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale	4	5	9	16	13	6	6	17	16	6
<b>Totali</b>	<b>236</b>	<b>24</b>	<b>41</b>	<b>47</b>	<b>22</b>	<b>286</b>	<b>23</b>	<b>82</b>	<b>46</b>	<b>17</b>

Tabela 31

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me “Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë”:

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE	2019	2020
--	------	------

SHTETËRORE	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.	Nr.
	Proc. Regj	Proc. Dërg. Gjyk.	Pand. Regj.	Pand. Dërg. Gjyk.	Pand dënuar	Proc. Regj	proc. në gjykatë	pand. Regj	Pand. në gjyk.	Pand dënuar
Neni 294 Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete	6	0	0	0	0	3	1	0	1	0
Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	1325	623	1364	642	456	633	458	645	475	321
Neni 298 Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit	124	36	139	56	23	239	97	395	153	60
Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>1457</b>	<b>660</b>	<b>1504</b>	<b>699</b>	<b>479</b>	<b>876</b>	<b>556</b>	<b>1040</b>	<b>629</b>	<b>381</b>

Tabela 32

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e IX “Vepra penale kundër drejtësisë”:

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykata të	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand. dënua r
Neni 300 Moskallëzimi i krimi	19	20	62	79	67	17	15	73	84	45
Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	8	10	15	20	12	9	2	17	13	17
Neni 302 Përkrahja e autorit të krimi	7	5	16	7	3	6	2	9	3	1
Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 304 Detyrimi për të kallëzuar provën	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 305 Kallëzimi i rremë	46	42	40	47	35	37	32	23	40	27
Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq.	19	13	13	21	11	11	13	13	26	11
Neni 306 Dëshmia e rreme	7	7	4	8	8	5	5	5	6	5
Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar	1	0	1	0	0	0	1	0	1	0
Neni 308 Përkthimi i rremë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 309 Ekspertimi i rremë	26	2	2	2	3	15	3	0	3	3
Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit	0	0	0	0	0	2	2	2	2	0
Neni 311 Kanosja për të mos kallëzuar	6	3	4	4	2	8	0	3	1	1
Neni 312/a Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë	1	1	1	1	0	1	2	1	3	0
Neni 313 Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikullit	3	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 313/b Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit	2	3	0	4	2	4	1	2	1	0
Neni 317 Kanosja e gjyqtarit	10	3	5	3	2	6	1	2	1	1
Neni 318 Fyerja e gjyqtarit	15	7	7	7	4	16	5	6	5	0
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës	102	29	25	30	19	70	28	21	28	20
Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës	3	1	0	1	0	4	1	1	2	0
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	123	65	79	66	46	101	53	65	55	28
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	55	44	47	45	30	112	69	120	73	38
Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim	2	0	1	0	0	3	2	2	2	0

Neni 324/a Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim	190	74	101	86	86	73	92	30	103	65
<b>Totali</b>	<b>648</b>	<b>329</b>	<b>423</b>	<b>431</b>	<b>330</b>	<b>504</b>	<b>329</b>	<b>395</b>	<b>452</b>	<b>262</b>

Tabela 33

Vepra penale të cilat parashikohen në Kreun e X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve<sup>54</sup>”.

VEPRAT PENALE PËR ZGJEDHJET E LIRA	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhore	7	0	8	0	0	1	0	1	0	0
Neni 326 Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve	5	1	1	4	4	2	0	0	0	1
326/a Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor	9	7	57	40	1					10
Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 328/a Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 330 Pengimi i zgjedhësit	5	1	6	1	0	0	0	0	0	0
Neni 330/a Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 331/a Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 332/a Shpërdorimi i autoritetit policor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali<sup>55</sup></b>	<b>32</b>	<b>9</b>	<b>72</b>	<b>45</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>11</b>

Tabela 34

Vepra penale të korrupsionit:

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2019	2020
----------------------------------	------	------

<sup>54</sup> Veçuar nga ky grup veprat penale të korrupsionit në zgjedhje dhe trajtuar në grup veprat penale të korrupsionit

<sup>55</sup> Korrigjuar shumat e vitit 2019 për shkak se neni 326/a nuk ishte përfshirë në tabelë.

	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënua r	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjyk atë	Nr. pan d. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënua r
Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit	2	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat	1	0	0	0	2	1	0	0	0	0
Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat	4	2	2	2	0	1	1	0	1	1
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	30	22	27	23	20	9	0	13	0	7
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë	3	0	4	4	1	3	0	2	0	0
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	23	19	27	35	27	2	0	0	0	4
Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike	52	12	32	22	12	8	2	2	2	8
Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë	4	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	2	0	7	2	2	0	0	0	0	0
Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatës ndërkombëtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	31	2	7	2	4	0	0	0	0	0
Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatës ndërkombëtare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 328 Korrupsioni aktiv në zgjedhje	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 328/b Korrupsioni pasiv në zgjedhje	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>155</b>	<b>58</b>	<b>109</b>	<b>91</b>	<b>68</b>	<b>25</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>3</b>	<b>20</b>

Tabela 35

Vepra penale kundër krimit kompjuterik për vitet 2019-2020:

KRIMI KIBERNETIK	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. komp.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik	55	1	4	2	5	63	4	0	6	3
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik	17	3	3	3	10	33	2	0	2	2
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik	8	1	2	1	0	6	0	0	0	1
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik	1	0	0	0	0	1	0	1	0	0
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike	31	4	3	4	3	51	0	2	0	0
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike	3	1	1	1	0	2	0	0	0	0
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>115</b>	<b>10</b>	<b>13</b>	<b>11</b>	<b>18</b>	<b>156</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>6</b>

Tabela 36

Vepra penale kundër trafikëve të paligjshme:

TRAFIKIMI	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 110/a Trafikim i Personave të rritur	19	2	8	4	2	23	1	8	1	2
Neni 128/b Trafikimi i të miturve	6	1	0	2	4	5	1	2	11	0
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës	1	2	0	2	0	1	0	0	0	0
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	170	10	14	12	2	148	4	11	4	1
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit	10	3	7	3	4	7	6	6	9	1
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse,	2	2	1	3	0	0	1	0	1	1



helmuese dhe radioaktive										
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	87	36	65	74	52	74	27	58	54	24
<b>Totali</b>	<b>295</b>	<b>56</b>	<b>95</b>	<b>100</b>	<b>64</b>	<b>258</b>	<b>40</b>	<b>85</b>	<b>80</b>	<b>29</b>

Tabela 37

Vepra penale në lidhje me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve:

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2019					2020				
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand. Regj.	Nr. Pand. Dërg. Gjyk.	Nr. Pand dënuar	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. në gjykatë	Nr. pand. Regj	Nr. Pand. në gjyk.	Nr. Pand dënuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	833	383	843	517	401	834	328	875	473	280
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	628	66	238	104	72	885	145	357	262	104
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>1461</b>	<b>449</b>	<b>1081</b>	<b>621</b>	<b>473</b>	<b>1721</b>	<b>473</b>	<b>1232</b>	<b>735</b>	<b>384</b>

## ANEKSI NR.2

**TË DHËNA PËR PASURITË E SEKSUESTRUARA DHE TË KËRKESAVE PËR  
KONFISKIM NË ZBATIM TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE DHE LIGJIT  
NR.10192/2009**

**I. Pasuri të seksuestruara në zbatim të K.Pr.Penale, janë:**

1. Procedimi penal nr.4999 te vitit 2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve” neni 287 i K.Penal, jane seksuestruar shtetasve të huaj H.L dhe R.S:

-lloj i pasurise “peme”, me siperfaqe prej 1.500 metra katrore, ndodhur ne ZK 3140, Radhime, Orikum, Vlore, sipas kontratës per shumen 51.150 euro, ne emer te shtetasve H.L dhe R.S.

-pasurine me numer nr.381/8, vol 7, faq 14, lloj i pasurise “ullinje”, me siperfaqe prej 1480 metra katrore, ndodhur ne ZK 3140, Radhime, Orikum, Vlore, sipas kontratës per shumen 50.650 euro, ne emer te shtetasve H.L dhe R.S.

-pasurine me numer nr.381/6/1, vol 7, faq 13, lloj i pasurise “ullinje”, me siperfaqe prej 2.000 metra katrore, ndodhur ne ZK 3140, Radhime, Orikum, Vlore, sipas kontratës per shumen 68.200 euro, ne emer te shtetasve H.L dhe R.S.

-pasurine me numer nr.6/264+2-1, ZK 8220, vol 30, fq 192, lloj i pasurise “apartament” me siperfaqe prej 112.50 metra katrore, ndodhur ne Rrugen e Kavajes, Tirane, sipas kontratës në vleren 52.300 euro, ne emer te shtetasit H.L.

- pasurine me numer nr.6/264+2-3, ZK 8220, vol 30, fq 194, lloj i pasurise “apartament” me siperfaqe prej 186.50 metra katrore, ndodhur ne Rrugen e Kavajes, Tirane, sipas kontratës per vleren 86.700 euro, ne emer te shtetasit H.L.

- pasurine me numer nr.6/264-G8, ZK 8220, vol 30, fq 116, lloj i pasurise “garazh” me siperfaqe prej 41.70 metra katrore, ndodhur ne Rrugen e Kavajes, Tirane, sipas kontratës ne vleren 5.000 euro, ne emer te shtetasit H.L.

- subjekti “Top Consulting” shoqeri aksionare dhe subjekti “Attract Trade”, me emer tregtar “Globalnet”.

- automjet me targa AA 777 NP, marka: “Daimler Chrysler” modeli “G400”, ne emer te subjektit “Attract Trade”.

- automjet me targa AA 724 OC, marka: “Audi”, modeli “A8”, ne emer te subjektit “Attract Trade”.

- automjet me targa AA 785 SL, marka: “Mercedes Benz”, modeli “E 200 CDI”, ne emer te subjektit “Attract Trade”.

- automjet me targa AA 455 SS, marka: “Cadillac”, modeli “Escalade”, ne emer te subjektit “Attract Trade”.

- automjet me targa AA 762 UB, marka: “BMV”, modeli “X5”, ne emer te subjektit “Attract Trade”.

- automjet me targa AA040GK, marka “Mercedes Benz”, modeli S350, ne emer te subjektit “Attract Trade”.

- llogari bankare, ne emer te shtetasit H.L, ne banken “X”, ne monedhen euro, me numer nr.vvv... gjendja, vlere 234,044.97 euro.

- llogari bankare, ne emer te shtetasit H.L, ne banken “X”, ne monedhen franga zviceriane, me numer nr. fff, gjendja ne shumen prej 127,424.48 franga zviceriane.

- llogari bankare, ne emer te shtetasit H.L, ne banken “S”, ne monedhen euro, me numer nr.sss. kredituar shuma prej 1,464,870.67 euro dhe jane debituar shuma prej 1,463,445.19 euro, ku gjendja ne shumen prej 1,425.48 Euro.

- llogari bankare, ne emer te shtetasit H.L, ne banken “S” ne monedhen franga zviceriane, me numer nr.fff, kredituar shuma prej 62,500.00 franga zviceriane dhe jane debituar shuma prej 145.50 CHF, ku gjendja ka qene ne shumen prej 62,354.50 franga zviceriane.

2. Procedimit penal nr.1603/2017, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal...sekuestruar me vendimin e dates 04.06.2020:

- Pasuria nr.58/596, ZK 8518, truall + ndërtesë, Vol.116, fq 99, Sip.1465 m2, hotel tek Shkëmbi I Kavajës, në pronësi të H.H ;
- Pasuria nr.29/40, ZK 8512, Sip.279 m2, Vol.61, fq.220, local në Lagjen nr.1 Currila Durrës (me leje legalizimi në emër të Stiven H.H) ;
- Pasuria nr.23/260-nd, ZK 8512, Sip.99 m2, Vol.40, fq.205, ndërtesë në Lagjen nr.1 Rruga “Nako Spiro” Durrës, në pronësi të H.H ;
- Pasuria nr.2/1029+1-2, ZK 8513, Sip.86 m2, Vol.63, fq.137, apartament në Lagjen nr.17 Rruga “Pjetër Hanxhari” Durrës, në pronësi të H.H ;

3. Per llogari te procedimit penal Nr 970/2020, per vepren penale te parashikuar nga nenet 287 dhe 180/3 i K.Penal. jane sekuestruar shuma te kredituar nga nje shoqeri tregtare ne fushen e ndertimeve ka kredituar ne favor te dy OJF shuma te medha te hollash.

4. Per llogari te procedimit Nr 4565 të vitit 2019, regjistruar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve”, parashikuar nga neni 287 I K.Penal, me vendime te prokurorit te ceshtjes, jene sekuestruar, 4 apartamente, 1 njesi, 1 garazhd, 4 autovetura, 1 motorciklete, shoqeri tregtare ne emer te shtetasit E.H, llogari bankare ne emer te shtetasit E.H . Këto pasuri janë të regjistruar në emrin e shtetasit E.H dhe familjarëve të tij. Ndërkoh që rezultojn se ky shtetas ka aktivitet criminal jashtë teritorit të Shqipërisë.

5. Procedimi Penal Nr 1042/2017, Regjistruar për veprën penale të “Pastrimit të Produkteve”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në ngarkim të shtetasit K.Xh. Ky shtetas rezultojn se është dënuar në shtetin Grek, për vepra penale në fushën e narkotikëve. Gjykata Vlorë, me vendimin Nr 1473 datë 24.10.2020, ka vendosur sekuestroja konservative per:3 apartamente, 2 njësi shërbimi dyqane, një ndërtim sipërfaqje ndertimore 175 m2, automjet, llogari bankare në shumën 1.783.070 lek.

## **II. Pasuri të seksuestruara në zbatim të ligjit 10192/2009, janë:**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shallës së Parë Elbasan, ka kërkuar me vendimin 12.02.2020, Gjykatës Elbasan, për llogari të procedimit pasuror në zbatim të ligjit 10192/2009 ka vendosur sekuestrimin, Tokë arë 1153 m2; trual objekt shërbimësh 3 katësh 3800m 2; 100% kuotave të shoqërisë K.; ndertëse në process legalimi.

2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin pasuror nr 01 2020, në ngarkim të shtetasit L.L dhe në zbatim të ligjit Nr. 10 192/2009, me vendimin datë

30.06.2020, ka sekuestruar pasurite e shtetasit L.L dhe konkretisht. LLogari bankare 557.246 all; llogari bankare 67 832 all; llogari bankare 6.200.000 all; llogari bankare 7.054.812 all.

3. Procedimi pasuror Nr 5 date i Prokurorisë së Rrethit Kukës, në ngarkim të shtetasit F.D , mbi bazën e ligjit Ligjit nr. 10 192/2009 është urdhëruar sekuestroja pasurise me vendimin datë të gjykatës, njësi shërbimi 100 m; truall 64 m; 4 Automjete të ndryshme ;Aksione Piano Bar Tirane.

4. Procedimi pasuror nr 2 date 28.05.2020 Prokuroria Durres, ndaj shtetasit P.T. mbi bazën e ligjit 10192/2009 mbi vendimin e gjykatës datë 09.06.2020, i janë sekuestruar 1-Sekuestruar : pallat 2-4-5-kateshe nje nen toke ne Durrës dhe 2-pallat me destinacion Hotel Bar plazh Durrës.